



Kingdom of the Netherlands


Performanca e institucioneve të posaçme në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

Midis progresit institucional dhe sfidave në trajtimin e fenomeneve

2025



Raport Vlerësimi 6





Performanca e institucioneve të posaçme në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (2025)

Midis progresit institucional dhe sfidave në trajtimin e fenomeneve

Autor:

Mirsada Hallunaj
Arjan Dyrmishi

Dizajni Grafik
Ergys Temali

Imazhet
freepik.com

Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG)
Tiranë, Qershor 2026



Kingdom of the Netherlands

Parakusht

Ky raport është përgatitur nga Qendra për Studimin e Demokracisë edhe Qeverisjes në kuadër të projektit: “Përmirësimi i Debatit të Politikave dhe Llogaridhënies në Përbushjen e Grupit të Parë të Kapitujve Negociues (Cluster 1), përmes Krijimit të Platformës së Negociatave BE-Shqipëri për Cluster 1 (C1-EU-NPA)” mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Tiranë. Opinionet, gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e shprehura në këtë dokument janë të autori/ve dhe nuk reflektojnë opinionet apo pikëpamjet e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Tiranë.

Tabela e përmbajtjes

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
ÇËSHTJET E KORRUPSIONIT	8
ÇËSHTJET E KRIMIT TË ORGANIZUAR	13
HETIMI FINANCIAR DHE PASUROR	18
METRIKA E GJETJEVE TË VLERËSIMIT	24
ÇËSHTJET E KORRUPSIONIT	24
ÇËSHTJET E KRIMIT TË ORGANIZUAR	29
HYRJE	37
METODOLOGJIA	40
METRIKA E VLERËSIMIT: ÇËSHTJET E KORRUPSIONIT	44
METRIKA E VLERËSIMIT: ÇËSHTJET E KRIMIT TË ORGANIZUAR	46
ANALIZA E GJETJEVE TË VLERËSIMIT	48
1. ANALIZA E RASTEVE TË KORRUPSIONIT	49
1.1. KORRUPSIONI I ZYRTARËVE TË NIVELIT TË LARTË	55
1.2. KOMPLEKSITETI I SKEMAVE KORRUPTIVE	61
1.3. VOLUMI I FLUKSEVE/TRANSAKSIONEVE FINANCIARE	64
1.4. KOHËZGJATJA DHE VAZHDIMËSIA E AKTIVITETIT KORRUPTIV	67
1.5. ROLI I AKTORËVE PRIVATË DHE NDËRMJETËSVE NË SKEMËN KORRUPTIVE	70
1.6. VLERA E HUMBJES/DËMIT EKONOMIK	73
2. ANALIZA E RASTEVE TË KRIMIT TË ORGANIZUAR	76
2.1. SHTRIRJA GJEOGRAFIKE E GRUPEVE DHE AKTIVITETIT KRIMINAL	83
2.2. NUMRI I PERSONAVE TË PËRFSHIRË	88
2.3. IDENTIFIKIMI I AKTIVITETEVE KRYESORE KRIMINALE	91
2.4. KOMPLEKSITETI I OPERACIONEVE (MODUS OPERANDI)	94
2.5. PËRFSHIRJA NË VEPRIMTARI TË SHUMTA KRIMINALE	97
2.6. VLERA E MALLRAVE TË LIGJSHME/PALIGJSHME	100
3. ANALIZA E DIMENSIONIT FINANCIAR DHE PASUROR: HETIMET FINANCIARE, SEKUESTRIMI DHE KONFISKIMI	102
ANEKSE	114
ANEKS I: VENDIMET E GJYKATËS SË POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR (2025)	114
ANEKS II: NIVELI I PËRGATITJES DHE PROGRESIT PËR ZBATIMIN E GRUP KAPITULLIT TË PARË "THEMELORET" - CLUSTER 1 (2020-2025)	119

Mirënjohje dhe vlerësime

Në përgatitjen e raporteve vjetore të Qendrës mbi analizën e çështjeve të korrupsionit dhe krimit të organizuar, bashkëpunimi me Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka përbërë një element me rëndësi të veçantë për sigurimin e cilësisë, saktësisë dhe seriozitetit të analizës së kryer. Ky bashkëpunim institucional është ndërtuar dhe konsoliduar ndër vite mbi baza profesionalizmi, korrektesie dhe gatishmërie për të mbështetur aksesin në informacion, në funksion të transparencës dhe analizës së zhvillimeve në fushën e drejtësisë penale.

Përgjatë këtij ndërveprimi, Gjykata ka treguar një qasje bashkëpunuese dhe konstruktive në raport me kërkesat e Qendrës për akses në vendimet gjyqësore, duke mundësuar krijimin e një baze të rëndësishme dokumentare për analizën e praktikës gjyqësore. Ky bashkëpunim ka qenë veçanërisht i vlefshëm për ndërtimin e një analize më të thelluar dhe më substanciale mbi mënyrën e trajtimit të çështjeve komplekse të korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe për evidentimin e zhvillimeve dhe dinamikave të sistemit të drejtësisë në këtë fushë.

Në mënyrë të veçantë, kemi vlerësuar faktin që, nga viti në vit, është vërejtur një përkushtim në rritje i Gjykatës ndaj transparencës institucionale dhe komunikimit publik. Kjo reflektohet jo vetëm në bashkëpunimin me aktorë të jashtëm që kontribuojnë në analizën dhe monitorimin e sektorit të drejtësisë, por edhe në mënyrën se si është zhvilluar dhe konsoliduar gradualisht raportimi institucional i Gjykatës. Si një praktikë pozitive nevojitet të theksohet pasurimi i qasjes së prezantimit të informacionit, zgjerimi i treguesve statistikorë si dhe një dimension më i strukturuar analitik, elemente të cilat kontribuojnë në forcimin e transparencës publike dhe kuptueshmërisë së veprimtarisë institucionale.

Po ashtu, vlerësojmë pozitivisht zhvillimet që lidhen me përmirësimin e aksesit publik në informacion gjyqësor dhe rritjen e komunikimit institucional me publikun dhe median, përfshirë publikimin e vendimeve dhe integrimin e mekanizmave digjitalë të transparencës. Këto zhvillime kontribuojnë jo vetëm në forcimin e besimit publik tek institucionet e drejtësisë, por edhe në krijimin e një kulture më të avancuar të llogaridhënies dhe profesionalizmit institucional.

Aksesi në vendimet gjyqësore dhe në të dhënat institucionale ka kontribuar në zhvillimin e raporteve më të strukturuar, më të argumentuara dhe më të dobishme për publikun, institucionet dhe partnerët ndërkombëtarë që monitorojnë zhvillimet në fushën e shtetit të së drejtës dhe reformës në drejtësi. Megjithatë analiza jonë është fokusuar kryesisht në praktikën e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, natyra e çështjeve të trajtuara dhe dinamika procedurale e tyre reflektojnë në mënyrë të tërthortë edhe zhvillime më të gjera që lidhen me funksionimin e strukturave të posaçme të drejtësisë, përfshirë rolin e SPAK-ut, Gjykatës së Posaçme të Apelit dhe, në raste të caktuara, edhe praktikën e Gjykatës së Lartë.

Në këtë kuadër, dëshirojmë të shprehim mirënjohjen dhe vlerësimin tonë për gatishmërinë, korrektesinë dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm të Gjykatës së

Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Besojmë se ky bashkëpunim përfaqëson një praktikë pozitive të ndërveprimit institucional, që kontribuon në forcimin e transparencës, cilësisë së debatit publik dhe analizës profesionale mbi funksionimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

Përmbledhje ekzekutive

ÇËSHTJE KRYESORE NGA ANALIZA E GJETJEVE

- Raporti evidenton hendek ndërmjet dimensionit formal dhe atij substancial në trajtimin e korrupsionit të zyrtarëve të nivelit të lartë, ku shumica e rasteve të identifikuar nuk përkthehet në ndikim të gjerë ekonomik apo sistemik, ndërsa një numër më i kufizuar përbën peshën reale të rrezikut.
- Kompleksiteti i fenomeneve nuk qëndron gjithmonë në sofistikim financiar apo struktura të avancuara, por në mënyrën se si instrumentalizohen proceset ligjore dhe institucionale, duke krijuar forma korrupsioni dhe kriminaliteti më pak të dukshme, por më të qëndrueshme.
- Korrupsioni dhe krimi i organizuar shfaqen si pjesë e një ekosistemi të ndërlidhur, ku korrupsioni vepron si mekanizëm lehtësues dhe ndërmjetësues, ndërsa krimi i organizuar gjeneron dhe ushqen kërkesën për devijim institucional dhe ekonomik.
- Pastrimi i parave paraqitet si një komponent strukturor i ekonomisë kriminale, megjithatë trajtimi i tij mbetet ende i fragmentuar dhe jo plotësisht i konsoliduar si fenomen autonom në praktikë.
- Dimensioni ekonomik rezulton të jetë elementi kyç për të kuptuar funksionimin real të këtyre fenomeneve, por në praktikë ai mbetet vetëm pjesërisht i reflektuar, veçanërisht për shkak të kufizimeve në ndjekjen, dokumentimin dhe rikuperimin e plotë të pasurive.
- Efektiviteti i ndërhyrjes në dimensionin financiar mbetet i kufizuar, për shkak të një hendeku të theksuar ndërmjet sekuestrimit dhe konfiskimit përfundimtar, i cili redukton ndjeshëm ndikimin real në rikuperimin e aseteve me origjinë kriminale.
- Ndërhyrja penale ka fituar në kapacitet dhe strukturim, por mbetet e përqendruar kryesisht në trajtimin e rasteve individuale, pa u përkthyer ende në një ndikim të qëndrueshëm në strukturat që gjenerojnë dhe riprodhojnë fenomenin.
- Në mungesë të një pragu financiar të përcaktuar, hetimet financiare dhe pasurore mbështeten në një qasje të orientuar nga risku, duke zhvendosur fokusin nga volumi i procedimeve drejt cilësisë së përzgjedhjes së rasteve. Megjithatë, niveli i integritit të tyre në procesin hetimor mbetet relativisht i kufizuar, çka ngre diskutim mbi shkallën në të cilën rastet e trajtuara pasqyrojnë burimet kryesore të impaktit ekonomik të fenomenit.

- Krimi i organizuar paraqet një nivel të lartë adaptimi dhe fleksibiliteti, duke operuar përmes strukturave që balancojnë specializimin me diversifikimin dhe duke shfrytëzuar hapësirat ndërmjet sektorit formal dhe atij informal për të ruajtur qëndrueshmërinë.
- Një nga sfidat më të rëndësishme që del nga analiza është kalimi nga trajtimi i rasteve drejt adresimit të strukturave, pasi shumë nga dinamikat e identifikuar lidhen me mënyrën e funksionimit të sistemeve dhe jo vetëm me sjelljen individuale.
- Në tërësi, raporti sugjeron se progresi i arritur reflekton më shumë forcimin e kapaciteteve sesa një ndryshim të qëndrueshëm të vetë fenomeneve, duke e vendosur debatin në pyetjen nëse ndërhyrjet dhe trajtimi aktual arrijnë të ndikojë në bazën ekonomike dhe funksionale që e riprodhon atë.

Korrupsioni në Shqipëri vijon të paraqitet si një fenomen me karakter të theksuar strukturor, i cili tejkalon dimensionin penal dhe ndikon drejtpërdrejt në funksionimin e institucioneve, klimën e biznesit dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Pavarësisht përparimeve në forcimin e mekanizmave të ndjekjes penale, fenomeni mbetet i ndërthurur me dobësi të qëndrueshme në administrimin publik, veçanërisht në fusha me ekspozim të lartë si prokurimet publike, menaxhimi i kontratave dhe ndërveprimi publik-privat. Në këtë kuptim, korrupsioni nuk shfaqet si episod i izoluar, por si pjesë e një dinamike më të gjerë që reflekton cilësinë e qeverisjes dhe nivelin e integritetit institucional.

Nga pikëpamja ekonomike, ndikimi i korrupsionit mbetet i konsiderueshëm dhe i vazhdueshëm, duke u materializuar jo vetëm në humbje të drejtpërdrejta financiare, por edhe në deformime të funksionimit të tregut dhe të eficiencës së përdorimit të burimeve publike. Të dhënat mbi dëmin ekonomik tregojnë për një fenomen të përsëritur, i cili lidhet me modele të konsoliduara keqadministrimi dhe me mangësi në mekanizmat e kontrollit dhe mbikëqyrjes. Në këtë kontekst, dimensioni ekonomik i korrupsionit shfaqet si indikator kyç për të kuptuar jo vetëm peshën e tij financiare, por edhe ndikimin afatgjatë në performancën e financave publike dhe në konkurrencën në treg.

Zhvillimet e viteve të fundit tregojnë një intensifikim të dukshëm të ndërhyrjes penale, veçanërisht në raport me rastet që përfshijnë skema më komplekse dhe zyrtarë me funksione të rëndësishme. Ky aktivizim reflekton një qasje më të avancuar drejt trajtimit të korrupsionit si fenomen me ndikim të gjerë ekonomik dhe institucional, si dhe një orientim më të theksuar drejt hetimeve financiare dhe ndjekjes së përfitimeve të paligjshme. Megjithatë, ky progres nuk është shoqëruar ende me një ulje të ndjeshme të cenueshmërisë strukturore, pasi korrupsioni vijon të perceptohet si i përhapur dhe mekanizmat parandalues mbeten me ndikim të kufizuar.

Në këtë kuadër, situata paraqitet ende komplekse ku nga njëra anë evidentohen përpjekje në drejtim të forcimit të kapaciteteve për hetimin dhe ndjekjen e rasteve

më të rënda dhe një konsolidim gradual i një praktike më të qëndrueshme penale; nga ana tjetër, një vazhdimësi e faktorëve që e mundësojnë dhe e riprodhojnë fenomenin, përfshirë dobësitë në kontrollin institucional, presionin mbi burimet dhe koordinimin e kufizuar ndërinstytucional. Kjo dinamikë sugjeron se sfida kryesore nuk qëndron më vetëm në identifikimin dhe ndëshkimin e rasteve, por në aftësinë për të transformuar këtë progres në ndryshime të qëndrueshme në funksionimin e institucioneve dhe në reduktimin e hapësirave që mundësojnë korrupsionin në afatgjatë.

Çështjet e korrupsionit

Korrupsioni i zyrtarëve të nivelit të lartë

- Evidentohet se, edhe për shkak të mungesës së një përkufizimi të plotë, klasifikimi i rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë bazohet kryesisht në statusin formal të subjektit, pa reflektuar në shumë raste një kombinim faktorësh substancialë, si pësia e veprës penale, ndikimi ekonomik dhe efektet potenciale sistematike, si elementë përcaktues në vlerësimin e tyre.
- Evidentohet një dominim i rasteve “korrupsion i nivelit të mesëm me subjekte të nivelit të lartë”, ku funksionarët kanë pozicion të rëndësishëm institucional, por veprimtaria korruptive mbetet e kufizuar në ndikim, shpesh lokale, episodike dhe me kompleksitet të ulët ose mesatar.
- Një trend i dallueshëm është se një pjesë e konsiderueshme e devijimeve në nivele të larta nuk manifestojnë formën klasike të korrupsionit financiar, por shfaqen si abuzim me funksionin publik apo ndërhyrje procedurale, duke mbetur jashtë pragut substancial të korrupsionit të nivelit të lartë.
- Analiza nxjerr në pah gjithashtu praninë e formave të korrupsionit me ndikim institucional jo-ekonomik, të cilat, megjithëse nuk shoqërohen me përfitime të mëdha financiare, kanë potencial për të cenuar procese kyçe si drejtësia apo funksionimi demokratik.
- Identifikohet një kategori specifike e korrupsionit të integritetit, ku shkeljet lidhen me fshehjen e pasurisë dhe mungesën e transparencës financiare, duke krijuar një formë të vazhdueshme cenimi të mekanizmave të kontrollit dhe të besimit publik.
- Në kontrast, rastet që përbëjnë plotësisht kriteret e korrupsionit të nivelit të lartë janë më të kufizuara në numër, dhe karakterizohen nga kompleksitet i lartë, ndërthurje publik-privat dhe ndikim të qëndrueshëm në treg dhe vendimmarrje, duke përfaqësuar formën më të rrezikshme të fenomenit.
- Në tërësi, evidentohet një hendek i qartë ndërmjet dimensionit formal dhe atij substancial të korrupsionit, ku shumica e rasteve nuk arrijnë pragun e ndikimit sistematik, ndërsa një numër i vogël rastesh përqendrojnë rrezikun më të madh për integritetin institucional dhe funksionimin e ekonomisë.

Kompleksiteti i skemave korruptive

- Evidentohet një dominim i skemave me kompleksitet të ulët dhe mesatar, ku korrupsioni zhvillohet kryesisht përmes marrëdhënieve direkte ose gjysmë-direkte dhe nuk kërkon ndërtimin e strukturave të qëndrueshme apo rrjeteve të mirëorganizuara.
- Në këto raste korrupsioni mbështetet më shumë në aksesin individual dhe marrëdhëniet personale sesa në mekanizma të strukturuar institucionale, duke reflektuar një logjikë më personale dhe jo një organizim të konsoliduar.
- Në shumicën e rasteve, konstatohet mungesë e theksuar e sofistikimit financiar, çka tregon se kompleksiteti i këtyre çështjeve mbetet kryesisht organizativ dhe administrativ, dhe jo i ndërtuar mbi mekanizma të avancuar të fshehjes së përfitimeve.
- Megjithatë, vihet re një shtresë ndërmjetëse ku kompleksiteti rritet përmes ndërmjetësimit dhe krijimit të "zinxhirëve të ndikimit", duke përfshirë disa aktorë, ndarje rolesh dhe koordinim në disa faza, pa arritur ende në struktura të mirëfillta kriminale.
- Një zhvillim i rëndësishëm është se kompleksiteti shpesh buron nga instrumentalizimi i procedurave formalisht të ligjshme, ku mekanizmat institucionale përdoren për të legjitimuar rezultate të paravendosura, duke e bërë korrupsionin më pak të dukshëm dhe më të vështirë për t'u provuar.
- Rastet me kompleksitet të lartë janë relativisht të kufizuara, por ato karakterizohen nga ndërveprim ndërinstitutional, shumëfaza dhe prodhim i drejtpërdrejtë i pasojave ekonomike, duke e shndërruar korrupsionin nga ndërhyrje administrative në mekanizëm përfitimi të integruar në ekonomi.
- Në këto raste, evidentohet një zhvillim i kompleksitetit nga ndikimi i pretenduar drejt integritetit real në vendimmarrje, ku korrupsioni kalon nga ndërveprim individual në përdorim funksional të institucioneve dhe, në rastet më të avancuara, në deformim të proceseve të plota administrative dhe ekonomike.

Volumi i flukseve/transaksioneve financiare

- Evidentohet një dominim i rasteve me volum të ulët dhe mesatar financiar, ku korrupsioni funksionon përmes transaksioneve të drejtpërdrejta dhe nuk kërkon ndërtimin e strukturave të ndërlikuara financiare.
- Një trend i rëndësishëm është se flukset financiare nuk janë gjithmonë të reduktuara në pagesa të vetme, por shpesh shfaqen si transfertat të përsëritura dhe ndërveprime të shumëfishta, duke reflektuar një organizim funksional edhe në rastet me volum të kufizuar.

- Në një pjesë të rasteve, dimensioni financiar mbetet implicit dhe jo plotësisht i dokumentuar, çka tregon se korrupsioni mund të zhvillohet edhe në forma më pak të gjurmueshme financiarisht dhe me vështirësi më të lartë provueshmërie.
- Evidentohet një zgjerim i konceptit të përfitimit financiar përmes strukturave hibride, ku korrupsioni materializohet jo vetëm në pagesa monetare, por edhe në avantazhe procedurale dhe përfitime ekonomike të tërthorta.
- Një kategori e veçantë rastesh karakterizohet nga volum shumë i lartë financiar i lidhur me projekte publike dhe kontrata afatgjata, ku korrupsioni nuk konsiston në një pagesë të vetme, por në kontrollin e flukseve të mëdha dhe të vazhdueshme në kohë.
- Në këto raste më të avancuara, vihet re se kompleksiteti financiar nuk qëndron në teknikat e fshehjes, por në manipulimin e proceseve që gjenerojnë flukset, duke krijuar një formë “sofistikimi procedural” brenda mekanizmave ligjorë.
- Një trend thelbësor është se përfitimi korruptiv shpesh tejkalon shumën e drejtpërdrejtë, duke marrë formën e aksesit në burime shumë më të mëdha ekonomike, ku pagesa (kur ekziston) funksionon si një “kosto hyrjeje” për përfitime të vazhdueshme.
- Në tërësi, evidentohet se volumi financiar duhet kuptuar si strukturë dhe jo thjesht si madhësi, ku rëndësi merr mënyra se si përfitimi krijohet, kanalizohet dhe integrohet në procese institucionale dhe ekonomike.

Kohëzgjatja dhe vazhdimësia e aktivitetit korruptiv

- Evidentohet se korupsioni nuk paraqitet kryesisht si akt i izoluar, por si proces që zhvillohet në kohë, duke përfshirë një sekuencë veprimesh të ndërlidhura që shtrihen përtej momentit të realizimit të përfitimit.
- Identifikohet një dominim i rasteve episodike me kohëzgjatje të shkurtër, të cilat, megjithëse të kufizuara në kohë, përmbajnë një cikël të plotë organizimi dhe mund të prodhojnë ndikim të konsiderueshëm institucional.
- Një trend i rëndësishëm është prania e rasteve me vazhdimësi funksionale, ku korrupsioni zhvillohet përmes një serie veprimesh të përsëritura dhe të koordinuara, duke krijuar një strukturë më të qëndrueshme dhe më të vështirë për t’u identifikuar.
- Evidentohet se kohëzgjatja shpesh lidhet jo me ekzistencën e një skeme të strukturuar, por me zhvillimin e proceseve vendimmarrëse që krijojnë hapësira për devijim, duke e zhvendosur korrupsionin nga individi tek funksionimi i sistemit.

- Rastet me kohëzgjatje të gjatë nxjerrin në pah mungesën e ndërhyrjes së hershme dhe fragmentimin e kontrollit institucional, duke lejuar zhvillimin e aktivitetit korruptiv në mënyrë të vazhdueshme dhe reaktive nga ana e institucioneve.
- Një gjetje kyçe është fenomeni i “normalizimit të devijimit”, ku praktikatat korruptive, kur zhvillohen përmes procedurave formalisht të ligjshme në kohë, rrezikojnë të perceptohen si pjesë e funksionimit normal të sistemit.
- Në tërësi, evidentohet një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet vazhdimësisë së korrupsionit dhe dobësive në mekanizmat e monitorimit dhe mbikëqyrjes, duke reflektuar ekzistencën e një “hapësire funksionale” që lejon konsolidimin gradual të fenomenit.

Roli i aktorëve privatë dhe ndërmjetësve në skemën korruptive

- Evidentohet se korruptsioni rrallëherë zhvillohet si marrëdhënie e thjeshtë dypalëshe, por si një proces që përfshin ndërveprim të gjerë ndërmjet sektorit publik, aktorëve privatë dhe ndërmjetësve.
- Një trend i rëndësishëm është se aktorët privatë nuk shfaqen vetëm si përfitues, por si pjesëmarrës aktivë në ndërtimin dhe funksionimin e skemave korruptive, duke kontribuar në strukturimin e përfitimit dhe shmangien e kontrolleve.
- Evidentohet një rol i shtuar i ndërmjetësve si hallkë kyçe në realizimin e korruptsionit, të cilët lehtësojnë komunikimin, negocimin dhe shpërndarjen e përfitimeve, duke rritur kompleksitetin dhe duke krijuar distancë midis palëve kryesore.
- Një zhvillim domethënës është se ndërmjetësimi nuk mbetet gjithmonë në rol pasiv, por në disa raste merr formë aktive dhe organizuese, duke u shndërruar në element qendror të funksionimit të skemës.
- Evidentohet se ndërthurja publik-privat prodhon deformim të drejtpërdrejtë të proceseve ekonomike dhe administrative, duke krijuar avantazhe konkurruese të padrejta dhe duke ndikuar në përzgjedhje të paracaktuara në treg.
- Një trend i rëndësishëm është se korruptsioni zhvillohet shpesh përmes rrjeteve informale dhe marrëdhënieve personale, pa përdorur struktura të sofistikuara korporative apo mekanizma të avancuar financiarë.
- Megjithatë, pavarësisht këtij kompleksiteti të kufizuar formal, ndërmjetësimi krijon një “zonë gri” që e bën korrupsionin më të qëndrueshëm dhe më të vështirë për t’u zbuluar, duke reduktuar ekspozimin e drejtpërdrejtë të palëve kryesore.

- Në tërësi, evidentohet se përfshirja aktive e sektorit privat rrit rrezikun e infiltrimit të korrupsionit në ekonomi, duke e shndërruar atë nga një fenomen individual në një mekanizëm që ndikon në funksionimin e tregut dhe konkurrencës.

Vlera e humbjes/dëmit ekonomik

- Evidentohet se dëmi ekonomik nga korrupsioni paraqitet në forma të shumëfishta dhe jo lineare, duke përfshirë jo vetëm humbje të drejtpërdrejta monetare, por edhe pasoja funksionale dhe strukturore në ekonomi dhe institucione.
- Një trend i rëndësishëm është dominimi i dëmit të drejtpërdrejtë financiar të lidhur me pagesa korruptive, shpesh të fragmentuara dhe të shpërndara në kohë, duke krijuar marrëdhënie të vazhdueshme përfitimi.
- Evidentohet një kategori e zgjeruar rastesh ku dëmi ekonomik nuk materializohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, por shfaqet përmes deformimit të proceseve publike, veçanërisht në prokurime, koncesione dhe vendimmarrje administrative.
- Në këto raste, mungesa e një vlere të kuantifikuar nuk përjashton impaktin e lartë ekonomik, i cili duhet të lexohet përmes pasojave në konkurrencë, eficiencë dhe përdorim të burimeve publike.
- Një gjetje domethënëse është prania e rasteve me dëm potencial shumë të lartë, ku korrupsioni krijon mundësi për përfitime të mëdha dhe të vazhdueshme, pa u reflektuar domosdoshmërisht në një pagesë të menjëhershme.
- Evidentohet gjithashtu fenomeni i “dëmit të dyfishtë”, ku individët përballen njëkohësisht me një dëm administrativ dhe me një kërkesë korruptive për ta korrigjuar atë, duke rritur ndjeshëm barrën ekonomike.
- Në disa raste, korrupsioni çon në transferim të drejtpërdrejtë të pasurisë, duke krijuar forma të qarta dhe të menjëhershme të dëmit ekonomik me vlerë të konsiderueshme.
- Një trend kritik është ekzistenca e rasteve ku dëmi ekonomik mbetet i fshehur ose i vështirë për t’u kuantifikuar, veçanërisht në kontekstin e mungesës së transparencës dhe kontrolleve të dobëta institucionale.
- Në tërësi, evidentohet një disproporcion i qartë midis kostos së korrupsionit dhe përfitimit të tij, ku pagesat korruptive shpesh janë të ulëta në raport me përfitimet ekonomike që mundësojnë.
- Kjo sugjeron se dëmi ekonomik duhet kuptuar si një fenomen shumëdimensional dhe sistematik, që shkon përtej humbjeve individuale dhe ndikon drejtpërdrejt në funksionimin e tregut, konkurrencën dhe besimin në institucionet publike.

Çështjet e krimit të organizuar

Krimi i organizuar paraqitet si një fenomen i konsoliduar, dinamik dhe gjithnjë e më i integruar në rrjete ndërkufitare, ku zhvillimet në kapacitetet e ndjekjes penale bashkëekzistojnë me qëndrueshmërinë e tregjeve kriminale dhe me aftësinë e strukturave kriminale për t'u përshtatur ndaj presionit institucional. Në këtë kuptim, tabloja nuk reflekton vetëm praninë e aktiviteteve të rënda kriminale, por ekzistencën e një ekosistemi të ndërthurur veprimtarish, që përfshin trafikimin e narkotikëve, krimin financiar, trafikimin e qenieve njerëzore dhe integrimin e të ardhurave kriminale në ekonomi.

Në planin ekonomik dhe funksional, krimi i organizuar nuk shfaqet vetëm si aktivitet i paligjshëm, por si një mekanizëm që gjeneron, qarkullon dhe reintebron kapital në ekonomi, duke krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet tregjeve kriminale dhe atyre formale. Treguesit ndërkombëtarë konfirmojnë se Shqipëria mbetet e ekspozuar ndaj tregjeve kriminale me fitim të lartë, veçanërisht në trafikun e narkotikëve dhe në krimet financiare, ndërkohë që pastrimi i produkteve të veprës penale dhe përdorimi i strukturave ekonomike për maskim përbëjnë dimensione gjithnjë e më të rëndësishme të fenomenit. Në këtë kontekst, krimi i organizuar duhet kuptuar jo vetëm si kërcënim për sigurinë, por edhe si faktor që ndikon në konkurrencën, integritetin e tregut dhe stabilitetin ekonomik.

Një nga tiparet më domethënëse të zhvillimit të tij është karakteri i theksuar transnacional, ku grupet kriminale shqiptare operojnë si pjesë funksionale e rrjeteve më të gjera europiane dhe ndërkombëtare. Shqipëria shfaqet në këtë dinamikë si pikë origjine, tranziti dhe riinvestimi, ndërsa vetë aktorët kriminalë operojnë në disa juridiksione dhe ndërveprojnë me struktura të tjera kriminale, duke rritur kompleksitetin dhe reziliencën e tyre. Ky dimension kërkon jo vetëm reagim penal në nivel kombëtar, por edhe një arkitekturë të integruar bashkëpunimi ndërkombëtar, inteligjence financiare dhe hetimesh të koordinuara.

Zhvillimet e fundit tregojnë një rritje të presionit institucional dhe një intensifikim të operacioneve kundër rrjeteve kriminale, veçanërisht përmes bashkëpunimit ndërkombëtar dhe fokusit më të madh në hetimet financiare. Megjithatë, këto përparime bashkëjetojnë me një nivel të lartë qëndrueshmërie të strukturave kriminale dhe me një reziliencë të kufizuar institucionale për të kufizuar në mënyrë të qëndrueshme hapësirën e veprimit të tyre. Në këtë kuptim, sfida nuk qëndron vetëm në goditjen e aktiviteteve kriminale, por në dobësimin e bazës ekonomike, organizative dhe ndërkufitare që i mbështet ato në mënyrë të vazhdueshme.

Në tërësi, situata paraqitet si një ekuilibër i brishtë ndërmjet progresit dhe qëndrueshmërisë së rrezikut ku nga njëra anë evidentohen përpjekje në reagimin institucional dhe në bashkëpunimin ndërkombëtar; nga ana tjetër, një vazhdimësi e kapacitetit të krimit të organizuar për t'u riorganizuar, për të shfrytëzuar dobësitë e sistemit dhe për të ruajtur ndikimin e tij në ekonomi dhe në rrjete më të gjera kriminale. Kjo sugjeron se lufta kundër krimit të organizuar ka hyrë në një fazë më të sofistikuar, por ende jo në një stad ku mund të konsiderohet se është arritur një epërsi e qëndrueshme institucionale ndaj tij.

Shtrirja gjeografike e grupeve dhe aktivitetit kriminal

- Evidentohet se krimi i organizuar nuk kufizohet më në hapësira të vetme territoriale, por funksionon si rrjet me funksione të shpërndara, ku aktivitetet ndahen sipas logjikës së zinxhirit kriminal dhe jo kufijve administrativë.
- Një trend i rëndësishëm është se territori përdoret në mënyrë funksionale dhe strategjike, duke u segmentuar në zona organizimi, prodhimi, transporti, shpërndarjeje dhe investimi, çka tregon një nivel të konsoliduar të planifikimit hapësinor kriminal.
- Evidentohet një ndërthurje e modeleve lokale dhe transnacionale, ku disa aktivitete mbështeten në kontroll territorial të segmentuar brenda vendit, ndërsa të tjera zhvillohen në koridore ndërkufitare dhe rrjete shumëjuridiksionale.
- Një zhvillim domethënës është roli i Shqipërisë si nyje funksionale në koridore rajonale dhe evropiane, ku territori përdoret si pikë nisjeje, tranziti, koordinimi ose riinvestimi të të ardhurave kriminale.
- Evidentohet një diversifikim i përdorimit të territorit, nga zona periferike dhe të izoluara për aktivitete si kultivimi, deri te mjedise urbane që shfrytëzohen për kamuflim, koordinim dhe ndërveprim ekonomik.
- Një trend i rëndësishëm është kalimi nga territori statik drejt territorit dinamik, ku aktiviteti kriminal mbështetet në mobilitet të lartë dhe në rrjete pikash të ndërlidhura, duke rritur fleksibilitetin dhe reziliencën operative të grupeve.
- Evidentohet gjithashtu një rritje e dimensionit ekonomik të shtrirjes gjeografike, ku territori përdoret jo vetëm për operim kriminal, por edhe për integrim të të ardhurave në ekonomi dhe për vendosje të kapitalit kriminal.
- Në tërësi, shtrirja gjeografike del si tregues i drejtpërdrejtë i nivelit të organizimit dhe kapacitetit operativ, ku zgjerimi hapësinor shoqërohet me rritje të kompleksitetit dhe me nevojë për koordinim ndërinstitutional dhe ndërkombëtar.

Numri i personave të përfshirë (madhësia e grupit kriminal)

- Evidentohet se numri i personave nuk është thjesht tregues sasior, por reflektues i nivelit të organizimit dhe strukturimit të brendshëm të grupit kriminal, duke u lidhur drejtpërdrejt me ndarjen e roleve dhe koordinimin.
- Një trend i rëndësishëm është prania e grupeve të zgjeruara me numër të lartë pjesëmarrësish, të cilat karakterizohen nga ndarje e avancuar funksionesh, kapacitet për aktivitete paralele dhe qëndrueshmëri më e lartë ndaj ndërhyrjeve ligjzbatuese.

- Evidentohet gjithashtu një dominim i strukturave me përbërje mesatare, të cilat arrijnë të balancojnë fleksibilitetin me organizimin, duke funksionuar si njësi të koordinuara dhe të qëndrueshme në kohë.
- Një pjesë e konsiderueshme e rasteve përfshin grupe të vogla dhe kompakte, të cilat, pavarësisht numrit të kufizuar, shfaqin efikasitet të lartë operacional dhe fleksibilitet në realizimin e aktiviteteve të targetuara.
- Evidentohet një diskrepancë ndërmjet numrit formal të personave të identifikuar dhe përmasës reale të rrjetit kriminal, duke treguar praninë e bashkëpunëtorëve periferikë dhe strukturave të pjesshme të padukshme.
- Një trend i rëndësishëm është se shumica e grupeve, pavarësisht madhësisë, shfaqin strukturë shumë-shtresore, me nivele operative, koordinuese dhe mbështetëse, duke reflektuar specializim funksional.
- Në tërësi, evidentohet se rritja e numrit të pjesëmarrësve shoqërohet me rritje të kompleksitetit dhe kapacitetit operacional, ndërsa grupet më të vogla mbeten më fleksibile, por me shtrirje dhe ndikim më të kufizuar.

Aktivitetet kryesore kriminale

- Evidentohet se krimi i organizuar karakterizohet nga një diversitet i gjerë aktiviteteve, të cilat, megjithëse të ndryshme në natyrë, janë të orientuara drejt përfitimit ekonomik dhe funksionojnë në mënyrë të ndërlidhur.
- Një trend dominues është qendërimi i aktivitetit kriminal rreth narkotikëve, të cilët shfaqen si boshti kryesor i shumë çështjeve dhe zhvillohen në formën e një zinxhiri të plotë nga prodhimi deri te shpërndarja.
- Evidentohet një ndarje funksionale e qartë brenda aktiviteteve kriminale, ku faza të ndryshme si kultivimi, transporti dhe shpërndarja realizohen nga aktorë të specializuar, duke reflektuar nivel organizimi dhe koordinimi.
- Një dimension i rëndësishëm është prania e kriminalitetit financiar, i cili shfaqet si aktivitet paralel ose mbështetës, duke përfshirë qarkullimin e kapitalit informal dhe pastrimin e produkteve të veprës penale.
- Evidentohet gjithashtu një segment i krimit të organizuar të dhunshëm, ku aktiviteti kriminal nuk kufizohet në përfitim ekonomik, por lidhet me kontroll territorial dhe përdorim të forcës si instrument dominimi.
- Një trend thelbësor është ndërthurja e disa aktiviteteve brenda së njëjtës strukturë kriminale, duke krijuar modele të integruara ku aktivitetet mbështesin dhe fuqizojnë njëri-tjetrin.
- Evidentohet një balancë midis specializimit dhe diversifikimit, ku disa struktura fokusohen në një aktivitet të vetëm, ndërsa të tjera operojnë në disa fusha njëkohësisht, në varësi të mundësive të tregut kriminal.

- Në tërësi, aktivitetet kriminale paraqiten si sistem i strukturuar dhe i integruar veprimtarish, që tejkalon format sporadike dhe reflekton modele të konsoliduara funksionimi dhe adaptimi.

Kompleksiteti i operacioneve (Modus Operandi)

- Evidentohet se modus operandi i krimit të organizuar nuk është spontan, por rezultat i planifikimit të qëllimshëm dhe adaptimit të vazhdueshëm, duke reflektuar evoluimin drejt formave më të sofistikuara të operimit.
- Një trend i rëndësishëm është prania e strukturave funksionalisht të diferencuara, ku ndarja e roleve ndërmjet niveleve drejtuese, operative dhe mbështetëse rrit efikasitetin dhe redukton ekspozimin penal.
- Evidentohet një model i qartë i planifikimit në faza të aktivitetit kriminal, ku veprimtaria zhvillohet në disa etapa të ndërlidhura, nga përgatitja dhe organizimi deri te ekzekutimi dhe menaxhimi pasues.
- Një element thelbësor është përdorimi sistematik i mekanizmave të fshehjes dhe shmangies, duke përfshirë fragmentimin e aktivitetit, kufizimin e informacionit dhe përdorimin e teknikave për të evituar gjurmimin.
- Evidentohet një diversitet i lartë i teknikave operative sipas llojit të aktivitetit kriminal, duke reflektuar përshtatje të modus operandi ndaj objektivit dhe kontekstit specifik të veprimtarisë.
- Një trend i rëndësishëm është variacioni i nivelit të sofistikimit, nga metoda bazike dhe të drejtpërdrejta deri te forma më të avancuara që integrojnë elementë financiarë, ndërkufitarë dhe ligjorë.
- Evidentohet gjithashtu ndërthurja e komponentëve ligjorë dhe të paligjshëm, ku struktura kriminale përdor mekanizma formale si mbulesë për aktivitetin e paligjshëm.
- Një element i qëndrueshëm është mbështetja në rrjete besimi dhe lidhje personale, që forcojnë qëndrueshmërinë e strukturave dhe vështirësojnë depërtimin nga autoritetet.
- Në tërësi, modus operandi paraqitet si sistem i koordinuar, fleksibël dhe në zhvillim të vazhdueshëm, ku krimi i organizuar kombinon organizimin tradicional me teknika moderne për të ruajtur funksionimin dhe për të minimizuar rrezikun.

Polikriminaliteti (përfshirja në veprimtari të shumta kriminale)

- Evidentohet se polikriminaliteti paraqitet në nivele të ndryshme zhvillimi, duke variojnë nga modele të kufizuara të fokusit në një aktivitet të vetëm, deri te forma më të avancuara të diversifikimit kriminal.
- Një trend dominues është përqendrimi i grupeve kriminale në një aktivitet kryesor, veçanërisht në fushën e narkotikëve, ku aktivitetet e tjera shfaqen kryesisht si elementë mbështetës dhe jo si fusha të pavarura kriminale.
- Evidentohet një dominim i integritit vertikal, ku grupet kontrollojnë disa faza të të njëjtit aktivitet (prodhim, transport, shpërndarje), pa kaluar domosdoshmërisht në diversifikim horizontal në aktivitete të tjera.
- Megjithatë, identifikohen edhe raste ku polikriminaliteti merr formë të konsoliduar, me përfshirje në disa aktivitete autonome si pastrimi i parave dhe ndërveprimi me struktura ekonomike apo institucionale.
- Një gjetje e rëndësishme është se shumë struktura kriminale, edhe kur janë të fokusuara, shfaqin potencial të lartë për diversifikim, për shkak të organizimit, ndarjes së roleve dhe kapaciteteve të ndërtuara.
- Në rastet më të avancuara, evidentohet një ndërthurje ciklike e aktiviteteve kriminale, ku të ardhurat nga një aktivitet përdoren për të financuar dhe fuqizuar aktivitete të tjera, duke krijuar një ekonomi kriminale të integruar.
- Evidentohet gjithashtu një ndarje e qartë ndërmjet specializimit dhe diversifikimit, ku disa grupe mbeten shumë efikase në një aktivitet të vetëm, ndërsa të tjera operojnë si struktura shumëfunksionale me rrezik më të lartë.
- Një trend kritik është se polikriminaliteti i avancuar shpesh lidhet me elementë të ndikimit institucional, duke rritur ndjeshëm rrezikshmërinë dhe potencialin për depërtim në ekonomi dhe struktura publike.
- Në tërësi, evidentohet një fazë ndërmjetme e zhvillimit të krimit të organizuar, ku dominon fokusimi në aktivitete të vetme, por me prirje të qartë drejt diversifikimit dhe integritit më të gjerë kriminal.

Vlera e mallrave të ligjshme/paligjshme

- Evidentohet se dimensioni pasuror përbën një element thelbësor të veprimtarisë kriminale, duke reflektuar jo vetëm nivelin e fitimit, por edhe shkallën e organizimit dhe qëndrueshmërisë së strukturave kriminale.
- Një trend i rëndësishëm është se dimensionin pasuror i çështjeve paraqitet në nivele të moderuara, pa arritur në vlera të larta, duke sugjeruar një fokus më të kufizuar në aspektin financiar dhe në akumulimin e pasurive në shkallë të gjerë.

- Evidentohet një variacion i nivelit të impaktit ekonomik, nga raste me vlera të kufizuara dhe aktivitet në faza fillestare, deri te raste me një dimension pasuror më të zhvilluar.
- Një zhvillim domethënës është kalimi nga përfitimi i thjeshtë kriminal drejt akumulimit dhe menaxhimit të pasurive, duke përfshirë investime në sektorë të ligjshëm dhe krijimin e një baze ekonomike të konsoliduar.
- Evidentohet një ndërthurje e qartë ndërmjet mallrave të ligjshme dhe atyre të paligjshme, ku asetet legale përdoren si instrument për mbështetje, maskim dhe integrim të aktivitetit kriminal në ekonomi.
- Një trend thelbësor është se asetet nuk janë vetëm rezultat i aktivitetit kriminal, por edhe mjet për fuqizimin dhe zgjerimin e tij, duke krijuar një cikël vetëpërforsues ekonomik.
- Një gjetje e rëndësishme është lidhja ndërmjet vlerës së aseteve dhe nivelit të organizimit kriminal, ku strukturat më të avancuara shoqërohen zakonisht me akumulim më të madh pasurie.
- Në tërësi, evidentohet një tendencë drejt konsolidimit të dimensionit ekonomik të krimit të organizuar, ku pasuria dhe asetet bëhen komponent kyç i funksionimit dhe ndikimit të tij në treg.

Hetimi financiar dhe pasuror

Përdorimi i hetimeve financiare dhe pasurore

- Evidentohet një ritje graduale e përdorimit të hetimeve financiare si instrument i integruar në ndjekjen penale, duke reflektuar një orientim më të qartë drejt adresimit të dimensionit ekonomik të kriminalitetit.
- Një trend i rëndësishëm është kalimi nga një përdorim sporadik drejt një qasjeje më sistematike dhe proaktive, ku ndjekja e rrjedhës së parave po konsiderohet gjithnjë e më shumë si pjesë përbërëse e hetimit.
- Megjithatë, evidentohet se hetimet financiare nuk shoqërojnë në mënyrë të qëndrueshme procedimet penale që nga fazat e hershme, duke kufizuar potencialin për identifikimin e plotë të pasurive të paligjshme.
- Një gjetje thelbësore është se dimensioni financiar shpesh mbetet dytësor ndaj veprës penale kryesore, veçanërisht në rastet e pastrimit të parave, duke reduktuar autonominë e këtij fenomeni në analizë dhe ndjekje.
- Në tërësi, evidentohet një fazë tranzitore drejt institucionalizimit të plotë të hetimeve financiare, ku progresi është i dukshëm, por ende jo i konsoliduar në mënyrë të qëndrueshme.

Kuadri metodologjik dhe institucional

- Evidentohet një forcim i kuadrit metodologjik përmes standardizimit të hetimeve financiare, duke reflektuar një përpjekje për institucionalizim dhe koordinim më të mirë ndërmjet strukturave.
- Një zhvillim i rëndësishëm është konsolidimi i njësive të specializuara dhe rritja e aksesit në databaza shtetërore, duke përmirësuar kapacitetin për analizë dhe gjurmim të pasurive.
- Megjithatë, evidentohet një mungesë e një qasjeje strategjike të integruar në nivel sistemi, veçanërisht në lidhje me identifikimin e aseteve ndërkufitare dhe koordinimin ndërinstytucional.
- Një trend kritik është fragmentimi i kapaciteteve ndërmjet institucioneve, ku prokuroritë jashtë strukturave të specializuara mbeten me burime dhe ekspertizë të kufizuar.
- Në tërësi, kuadri institucional paraqitet si në zhvillim dhe në konsolidim, por ende me boshllëqe në koordinim dhe strategji afatgjatë.

Kapacitetet teknike dhe profesionale

- Evidentohet një ritje e kapaciteteve profesionale dhe teknologjike, përfshirë përdorimin e analizës së të dhënave, OSINT dhe instrumenteve të avancuara për gjurmimin e aseteve.
- Një zhvillim i rëndësishëm është orientimi drejt trajnimit në fusha të reja si kriptovalutat dhe asetet digjitale, duke reflektuar përshtatje ndaj formave moderne të kriminalitetit financiar.
- Megjithatë, evidentohet se kapacitetet analitike mbeten të kufizuara për çështje komplekse dhe për analizë në shkallë të gjerë, duke krijuar një hendek ndërmjet nevojës dhe mundësive aktuale.
- Një gjetje kritike është mungesa e infrastrukturës së plotë për administrimin e aseteve moderne (p.sh. kriptomonedhat), çka kufizon efektivitetin e ndërhyrjes.
- Në tërësi, evidentohet një proces modernizimi në zhvillim, por ende i paplotë në raport me kompleksitetin e fenomenit financiar kriminal.

Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive (impakti financiar)

- Evidentohet një rritje e rolit të sekuestrimit si instrument i ndërhyrjes së hershme, duke reflektuar një intensifikim të reagimit ndaj pasurive me origjinë kriminale.
- Një trend i rëndësishëm është zhvendosja e theksuar drejt sekuestrimeve në raport me konfiskimet përfundimtare, duke krijuar një disproportcion të dukshëm ndërmjet dy fazave.
- Evidentohet një hendek në rritje ndërmjet identifikimit dhe rikuperimit real të aseteve, që përbën një nga kufizimet kryesore të efektivitetit të sistemit.
- Një gjetje domethënëse është variacioni i ndjeshëm ndër vite në rezultatet financiare, duke sugjeruar mungesë konsistence në impaktin ekonomik të ndërhyrjes.
- Në tërësi, evidentohet se ndërhyrja në pasuri është aktive në fazën fillestare, por më pak efektive në finalizimin e saj përmes konfiskimit.

Pastrimi i parave dhe ndjekja e tij

- Evidentohet se pastrimi i parave mbetet një komponent strukturor i ekonomisë kriminale, i lidhur ngushtë me krimin e organizuar dhe korrupsionin.
- Një trend i rëndësishëm është rënia e procedimeve për pastrim parash pas një rritjeje të mëparshme, duke sugjeruar luhatje në fokusin dhe intensitetin e ndjekjes.
- Evidentohet një diversifikim i tipologjive të pastrimit të parave, duke reflektuar një zgjerim të formave të kriminalitetit financiar përtej krimit të organizuar klasik.
- Një gjetje kryesore është se pastrimi i parave shpesh nuk trajtohet si vepër autonome me peshë të plotë, duke kufizuar efektivitetin e ndërhyrjes në këtë dimension.
- Në tërësi, evidentohet një nivel i lartë rrezikshmërie i fenomenit, i shoqëruar me një ndjekje ende të fragmentuar dhe jo plotësisht të konsoliduar.

Menaxhimi dhe efektiviteti i aseteve të sekuestruara/konfiskuara

- Evidentohet se menaxhimi i pasurive përbën një hallkë kritike në efektivitetin e përgjithshëm të sistemit, duke ndikuar drejtpërdrejt në vlerën reale të konfiskimit.

- Një trend i rëndësishëm është se vonesat procedurale shpesh çojnë në zhvlerësim të pasurive, duke dobësuar logjikën ekonomike të ndërhyrjes.
- Evidentohet një mungesë e një strategjie të strukturuar për përdorimin e pasurive të konfiskuara, duke kufizuar potencialin e tyre për ndikim social dhe ekonomik.
- Një zhvillim pozitiv është rritja graduale e transparencës përmes publikimit të katalogëve dhe inventarëve të pasurive, megjithëse raportet e tjera (p.sh. ato vjetore) mbeten ende të kufizuar për sa i përket nivelit të detajimit dhe informacionit të ofruar.
- Evidentohet gjithashtu një rol i rëndësishëm i aktorëve të jashtëm (media dhe shoqëria civile) në monitorim, duke reflektuar boshllëqe në mbikëqyrjen institucionale.
- Në tërësi, sistemi i menaxhimit të aseteve paraqitet si funksional, por jo plotësisht efektiv në ruajtjen dhe shfrytëzimin e vlerës së tyre ekonomike.

Konkluzione kryesore nga analiza e gjetjeve

Në vlerësimin e përgjithshëm të korrupsionit dhe krimit të organizuar në Shqipëri, një nga çështjet më thelbësore që del në pah lidhet me raportin ndërmjet shkallës së kompleksitetit të këtyre fenomeneve dhe efektivitetit të reagimit institucional ndaj tyre. Të dy fenomenet paraqiten si struktura të ndërthurura, me dimension të theksuar ekonomik, me aftësi të lartë adaptimi dhe me potencial për të ndikuar drejtpërdrejt në funksionimin e institucioneve dhe në integritetin e tregut. Në këtë kuptim, sfida nuk qëndron vetëm në identifikimin dhe ndëshkimin e veprave penale, por në aftësinë për të adresuar strukturat ekonomike dhe organizative që i mbështesin dhe i riprodhojnë ato në mënyrë të vazhdueshme.

Analiza e çështjeve të trajtuara tregon se ndërhyrja penale ka hyrë në një fazë më të avancuar, duke reflektuar një ritje të dukshme të kapaciteteve për të hetuar dhe ndjekur raste me kompleksitet më të lartë, për të përfshirë më shumë aktore dhe për të trajtuar në mënyrë më të qëndrueshme dimensionin financiar të aktivitetit kriminal. Në korrupsion evidentohet një zhvendosje drejt rasteve me impakt më të gjerë institucional dhe ekonomik, ndërsa në krimin e organizuar vihet re një fokus më i theksuar në struktura me shtrirje ndërkufitare, në ndarjen funksionale të roleve dhe në bashkëpunimin ndërkombëtar. Paralelisht, forcimi gradual i hetimeve financiare dhe pasurore, si dhe përdorimi më sistematik i mekanizmave të sekuestrimit dhe konfiskimit, tregojnë një orientim më të qartë drejt goditjes së dimensionit ekonomik të këtyre fenomeneve.

Megjithatë, gjetjet e analizës sipas komponentëve nxjerrin në pah një realitet më të kompleks. Në të dy fenomenet evidentohet një dominim i strukturave me kompleksitet të ndërmjetëm, një fokus i konsiderueshëm në aktivitete specifike (si në rastin e narkotikëve në krimin e organizuar apo skemave procedurale në korrupsion), si dhe një prani relativisht e kufizuar e formave më të avancuara dhe plotësisht sistemike. Kjo sugjeron se ndërhyrja penale po arrin të identifikojë dhe të godasë segmente të rëndësishme të fenomenit, por jo domosdoshmërisht të ndikojë në mënyrë të qëndrueshme në bazën strukturore që e mundëson atë.

Kjo dinamikë bëhet edhe më e qartë kur analizohet dimensioni financiar. Pavarësisht rritjes së përdorimit të hetimeve financiare dhe intensifikimit të sekuestrimeve, evidentohet një hendek i dukshëm ndërmjet fazës së identifikimit të pasurive dhe rikuperimit real të tyre përmes konfiskimit përfundimtar. Në këtë kuptim, ndërhyrja mbi pasurinë mbetet më e fortë në fazën fillestare, ndërsa më pak efektive në konsolidimin e rezultateve financiare. Njëkohësisht, fakti që pastrimi i parave vijon të trajtohet shpesh si element dytësor ndaj veprës penale kryesore, si dhe mungesa e një qasjeje plotësisht të integruar dhe strategjike në ndjekjen e aseteve, kufizon potencialin e plotë të këtij instrumenti për të goditur bazën ekonomike të kriminalitetit.

Në këtë kontekst, një nga konstatimet më të rëndësishme është se progresi i arritur duhet lexuar si pjesë e një procesi në zhvillim dhe jo si një rezultat i përfunduar. Ndërkohë që institucionet e specializuara kanë rritur ndjeshëm aftësinë për të trajtuar raste më të ndërlikuara dhe për të prodhuar një praktikë më të qëndrueshme ndjekjeje, fenomenet që adresohen mbeten të rrënjosura në faktorë

më të gjerë ekonomike, institucionale dhe shoqërore. Kjo krijon një disbalancë të dukshme ndërmjet përmirësimit të reagimit penal dhe qëndrueshmërisë së rrezikut, e cila reflektohet si në vazhdimësinë e problematikave në sektorë të caktuar, ashtu edhe në kufizimet për të prodhuar një ndikim të qëndrueshëm në ekonomi dhe në treg.

Në tërësi, analiza sugjeron se lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në Shqipëri ka kaluar nga një fazë kryesisht reaktive drejt një qasjeje më të strukturuar, më analitike dhe më të orientuar drejt rezultateve, por ende nuk ka arritur një stad ku mund të konsiderohet se ekziston një epërsi e qëndrueshme institucionale ndaj këtyre fenomeneve. Sfida kryesore mbetet transformimi i rezultateve të arritura në nivel çështjesh individuale në ndryshime më të gjera dhe të qëndrueshme në funksionimin e institucioneve, në reduktimin e hapësirave për abuzim dhe, mbi të gjitha, në dobësimin e bazës ekonomike që i ushqen dhe i fuqizon këto fenomene.

Në këtë kuptim, vlerësimi i situatës nuk duhet të reduktohet në një interpretim të thjeshtuar të suksesit apo dështimit, por të kuptohet si një proces i vazhdueshëm balancimi ndërmjet progresit institucional dhe rezistencës së fenomenit. Pikërisht kjo dinamikë e bën të domosdoshme një qasje të integruar, ku ndërhyrja penale të shoqërohet me forcimin e hetimeve financiare, rritjen e efektivitetit të konfiskimit, përmirësimin e koordinimit ndërinstucional dhe adresimin e faktorëve ekonomikë dhe strukturorë që mundësojnë dhe riprodhojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar në afatgjatë.

Metrika e gjetjeve të vlerësimit

Çështjet e korrupsionit

Komponenti	Kategoria e vlerësimit	Përshkrim i kategorisë së vlerësimit	Vlerësimi sipas rasteve/çështjeve të analizuarra për vitin 2025
Korrupsioni i zyrtarëve të nivelit të lartë	I lartë	Përfshin raste me zyrtarë të nivelit të lartë vendimmarrës të përfshirë në sektorë strategjikë, përmes skemave komplekse me shumë aktorë dhe ndërthurje publik-privat, që gjenerojnë përfitime të konsiderueshme ekonomike dhe prodhojnë ndikim të gjerë sistemik në treg, politika publike ose funksionimin e institucioneve.	18%
	Mesatar	Përfshin raste ku subjekti i nivelit të lartë është i pranishëm në procese vendimmarrëse, por skema zhvillohet me kompleksitet të moderuar dhe ndërthurje të pjesshme të aktorëve, duke gjeneruar përfitime ekonomike të kufizuara ose të paqarta dhe ndikim kryesisht sektorial, pa arritur të prodhojë efekte të plota sistemike në treg apo institucione.	23%
	I ulët	Përfshin raste ku subjekti ka status të lartë vetëm në aspekt formal dhe përfshihet në skema të thjeshta e lineare pa ndërthurje të gjerë aktorësh, duke gjeneruar përfitime të kufizuara ekonomike dhe ndikim të ngushtë lokal ose individual, pa deformim të ndjeshëm të tregut apo proceseve vendimmarrëse publike.	59%

Kompleksiteti i skemave korruptive	I lartë	Karakterizohet nga skema të ndërlikuara që përdorin mekanizma të avancuar të fshehjes dhe manipulimit si kompani guaskë, struktura offshore dhe ndërhyrje në procese ligjore, ku përfshihen shumë aktorë dhe ndërmjetës, duke e bërë identifikimin dhe hetimin e tyre të vështirë dhe duke rritur ndikimin e tyre në sistem.	14%
	Mesatar	Përfshin skema ku përdoren elementë të pjesshëm fshehjeje përmes bizneseve, pronave apo rrjeteve të lidhura dhe manipulim të proceseve si tenderat publikë, me përfshirje të disa aktorëve dhe shpërndarje të roleve ndërmjet tyre, duke gjeneruar përfitime të konsiderueshme, por pa arritur nivele të avancuara organizimi apo struktura të sofistikuara ndërkombëtare.	70%
	I ulët	Përfshin skema të drejtpërdrejta dhe lineare ku mungojnë mekanizmat e mirëfilltë të fshehjes dhe ndërthurja e aktorëve, si ryshfeti i hapur apo përdorimi i drejtpërdrejtë i pozitës publike për përfitime personale, duke gjeneruar përfitime të menjëhershme dhe me ndikim të kufizuar, si dhe me lehtësi të lartë në identifikim dhe ndjekje.	16%
Volumi i flukseve financiare	I lartë	Përfshin transaksione financiare mbi €1,000,000 të lidhura me skema korrupsioni në sektorë strategjikë, ku përfshihen aktorë të fuqishëm publikë dhe privatë dhe përdoren mekanizma të sofistikuara si kompani guaskë dhe transfertat ndërkombëtare për gjenerimin dhe fshehjen e përfitimeve me ndikim të gjerë ekonomik.	11%

	Mesatar	Përfshin transaksione në intervalin €400,000–€1,000,000 që lidhen me korrupsion në nivel administrativ ose sektorial, ku përdoren struktura më pak të sofistikuara si kompani të lidhura dhe mekanizma financiarë vendas, duke gjeneruar përfitime me ndikim të konsiderueshëm por jo të shtrirë gjerësisht.	49%
	I ulët	Përfshin transaksione €100,000–€400,000 që lidhen me korrupsion lokal dhe administrativ, të realizuara kryesisht përmes pagesave direkte ose informale, shpesh jashtë kanaleve të formalizuara financiare, me gjurmë të kufizuara dokumentare dhe ndikim të reduktuar ekonomik dhe institucional.	40%
Kohëzgjatja dhe vazhdimësia	I lartë	Përfshin aktivitete korruptive të zgjatura dhe të strukturuar në kohë, me rrjete të qëndrueshme aktorësh dhe ndërmjetësish të lidhur me vendimmarrje publike dhe interesa ekonomike afatgjata, duke krijuar rrezik të lartë për kapje institucionale dhe deformim të tregut, si dhe ndikim të vazhdueshëm në funksionimin e proceseve publike.	13%
	Mesatar	Përfshin aktivitete korruptive me vazhdimësi funksionale dhe përsëritje në kohë, ku aktorët dhe ndërmjetësit bashkëpunojnë në mënyrë të organizuar dhe me ndarje të pjesshme rolesh, duke krijuar përfitime të qëndrueshme dhe ndërveprime të konsoliduara, por pa arritur nivel të plotë strukturor apo ndikim të gjerë sistemik.	49%

	I ulët	Përfshin aktivitete episodike dhe afatshkurtra, të bazuara në marrëdhënie direkte mes palëve dhe përfitime individuale, pa strukturë të qëndrueshme organizative dhe me mungesë të ndërmjetësve apo rrjeteve të konsoliduara, duke u zhvilluar në mënyrë të izoluar dhe pa ndikim të zgjatur në treg apo në funksionimin e institucioneve publike.	38%
Roli i aktorëve privatë dhe ndërmjetësve	I lartë	Karakterizohet nga ndërthurje e avancuar publik-privat ku aktorët privatë dhe ndërmjetësit kanë rol qendror në konceptimin dhe funksionimin e skemës, duke ndikuar vendimmarrjen publike dhe krijuar struktura të qëndrueshme me rrezik të lartë për kapje institucionale dhe deformim tregu.	16%
	Mesatar	Përfshin ndërthurje funksionale ku aktorët privatë dhe ndërmjetësit luajnë rol aktiv në realizimin e marrëdhënieve korruptive, në një strukturë të organizuar por jo plotësisht të konsoliduar, me ndarje të pjesshme rolesh dhe bashkëpunim të qëndrueshëm ndërmjet palëve, duke gjeneruar ndikim të moderuar në procese dhe vendimmarrje.	54%
	I ulët	Përfshin ndërthurje të kufizuar ose marrëdhënie direkte mes aktorëve privatë dhe zyrtarëve publikë, me mungesë ose rol minimal të ndërmjetësve dhe me ndërveprim të thjeshtë e të drejtpërdrejtë mes palëve, duke gjeneruar ndikim të kufizuar në strukturat institucionale apo në funksionimin e tregut.	30%

Vlera e humbjes/dëmit ekonomik	I lartë	Përfshin raste me humbje ekonomike mbi €1,000,000 që prekin ndjeshëm financat publike dhe sektorët ekonomikë, zakonisht të lidhura me skema të mëdha dhe aktorë të nivelit të lartë, duke prodhuar ndikim të gjerë dhe pasoja të rëndësishme në ekonomi, funksionimin e tregut dhe besimin institucional.	8%
	Mesatar	Përfshin raste me humbje €400,000–€1,000,000 që reflektojnë modele të përsëritura abuzimi dhe keqmenaxhimi në administratë dhe sektorë specifikë, duke gjeneruar ndikim të konsiderueshëm ekonomik dhe pasoja të ndjeshme në funksionimin e sektorëve përkatës, por pa u shtrirë në nivel të plotë sistemik.	38%
	I ulët	Përfshin raste me humbje €100,000–€400,000 që lidhen me korrupsion administrativ lokal dhe përfitime individuale, me ndikim të kufizuar ekonomik dhe shtrirje të ngushtë institucionale, por me efekt të ndjeshëm në perceptimin publik dhe në nivelin e besimit ndaj institucioneve, veçanërisht në kontekstin lokal.	54%

Çështjet e krimit të organizuar

Komponenti	Kategoria e vlerësimit	Përshkrim i kategorisë së vlerësimit	Vlerësimi sipas rasteve/çështjeve të analizuarra për vitin 2025
Shtrirja gjeografike e veprimitarisë kriminale	I lartë	Përfshin veprimtari kriminale me shtrirje ndërkombëtare, përfshirë Shqipërinë dhe disa vende të tjera, mbështetur në rrjete të sofistikuara me partnerë ndërkombëtarë, përdorim të juridiksioneve offshore, duke mundësuar zhvillimin e aktiviteteve si trafik droge, armësh dhe pastrim parash, me logjistikë të avancuar dhe ndikim të gjerë ndërkufitar.	15%
	Mesatar	Përfshin veprimtari kriminale ndërkufitare mes Shqipërisë dhe një vendi tjetër, me bashkëpunim të drejtpërdrejtë por të kufizuar me rrjete të huaja, duke operuar kryesisht në trafik droge, kontrabandë dhe pastrim parash, me përdorim të rrugëve tokësore, detare ose ajrore dhe me ndikim të moderuar në nivel rajonal.	11%
	I ulët	Përfshin veprimtari kriminale të kufizuara brenda territorit të Shqipërisë, të bazuara shpesh në lidhje lokale ose familjare dhe në aktivitete si gjobëvënie, trafik i vogël dhe krime të dhunshme, duke gjeneruar ndikim të kufizuar dhe duke vepruar në disa raste si mbështetje apo furnizim për rrjete më të mëdha kriminale.	74%

Madhësia e grupit kriminal	I lartë	Përfshin grupe të mëdha me mbi 10 anëtarë, të organizuara në struktura të qëndrueshme me hierarki të qarta dhe ndarje rolesh si liderë, ekzekutues dhe ndërmjetës, duke pasur kapacitet për operacione të gjera dhe shpesh ndërkombëtare, si dhe aftësi për diversifikim dhe mbrojtje të qëndrueshme të aktivitetit kriminal.	19%
	Mesatar	Përfshin grupe me 5-10 anëtarë me organizim funksional dhe fleksibël, që operojnë kryesisht në nivel rajonal ose kombëtar, me ndarje bazike rolesh dhe përdorim të kufizuar të teknologjisë, duke ruajtur kapacitet për zhvillim, koordinim të veprimtarisë dhe zgjerim gradual të aktivitetit kriminal në kohë.	44%
	I ulët	Përfshin grupe të vogla me 3-5 anëtarë, të bazuara në lidhje personale dhe struktura të thjeshta, me mungesë të ndarjes së qartë të roleve, fokus në aktivitete të kufizuara kriminale, duke qenë më të ekspozuara ndaj ndjekjes penale dhe me ndikim të reduktuar në tregjet kriminale, si dhe me kapacitet të kufizuar për zgjerim apo diversifikim të veprimtarisë.	37%
Aktivitetet kryesore kriminale	I lartë	Përfshin aktivitete kriminale me përhapje të gjerë dhe dominim në tregjet e paligjshme, të mbështetura në modele të qëndrueshme dhe të strukturuar, duke gjeneruar ndikim të madh ekonomik dhe shoqëror, si dhe duke u shoqëruar shpesh me korrupsion dhe përdorim të dhunës për ruajtjen dhe zgjerimin e kontrollit.	22%

	Mesatar	Përfshin aktivitete kriminale me përhapje të konsiderueshme dhe prani të qëndrueshme, por jo dominante, ku grupet operojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe krijojnë ndikim të moderuar në tregje dhe institucione, duke mbetur një kërcënim serioz dhe i qëndrueshëm, por pa shkaktuar destabilizim të gjerë.	52%
	I ulët	Përfshin aktivitete kriminale me ndikim të kufizuar dhe prani sporadike, të realizuara nga grupe të vogla ose të specializuara në fusha të caktuara, me shtrirje të ngushtë dhe frekuencë të ulët veprimi, pa ndikim të rëndësishëm në tregjet kriminale apo në funksionimin e institucioneve publike.	26%
Kompleksiteti i modus operandi	I lartë	Karakterizohet nga përdorimi i metodave shumë të sofistikuara, përfshirë komunikim të koduar dhe platforma të avancuara teknologjike, pastrim parash përmes juridiksioneve offshore dhe kompani guaskë, si dhe infiltrim në institucione, duke mundur shmangie të avancuar të drejtësisë dhe operacione të koordinuara ndërkombëtare.	26%
	Mesatar	Përfshin metoda me nivel mesatar sofistikimi, si përdorimi i aplikacioneve të koduara dhe bizneseve fantazmë për pastrim parash, me ndikim të kufizuar në institucione, operacione të koordinuara në disa juridiksione, kryesisht në trafik droge dhe mashtrime financiare, duke treguar nivel të moderuar organizimi dhe përshtatjeje ndaj rrethanave.	48%

	I ulët	Përfshin metoda tradicionale dhe të drejtpërdrejta kriminale, pa përdorim të teknologjisë së avancuar, si gjobëvënie, shantazh dhe kontrabandë, me operacione të kufizuara dhe ndikim të ulët në ekonominë formale dhe në strukturat institucionale, duke reflektuar një nivel të ulët organizimi dhe sofistikimi.	26%
Polikriminaliteti (diversifikimi)	I lartë	Përfshin grupe shumësektoriale të angazhuara në një gamë të gjerë aktiviteteve kriminale si trafik droge, pastrim parash, mashtrime financiare, trafik armësh dhe korrupsion, me kapacitet të lartë operativ dhe përdorim të bizneseve të ligjshme si mbulesë për fshehjen dhe zgjerimin e aktivitetit kriminal.	15%
	Mesatar	Përfshin grupe të diversifikuara që operojnë në disa fusha kriminale, duke kombinuar krimin tradicional me pastrimin e parave dhe mashtrimet financiare, me aftësi përshtatëse ndaj kushteve të tregut dhe presionit ligjor, si dhe me ndikim të moderuar dhe të qëndrueshëm në ekonominë kriminale.	48%
	I ulët	Përfshin grupe të specializuara ose mono-kriminale që fokusohen në një ose dy aktivitete kriminale, me strukturë më të thjeshtë dhe mungesë diversifikimi, duke qenë më të ekspozuara ndaj ndjekjes penale dhe shpesh duke bashkëpunuar me rrjete më të mëdha si mbështetje operative.	37%

Vlera e mallrave të përfshira	I lartë	Përfshin aktivitete kriminale me volum shumë të lartë ekonomik mbi 50 milion € në vit, të lidhura me rrjete ndërkombëtare dhe skema të strukturuar financiare, me qarkullim të qëndrueshëm kapitali, përdorim të sistemit bankar dhe investime në pasuri, duke prodhuar ndikim të drejtpërdrejtë në ekonomi dhe tregje.	8%
	Mesatar	Përfshin aktivitete me volum të konsiderueshëm ekonomik prej 10-50 milion € në vit, të karakterizuara nga modele të strukturuar kriminale dhe të ardhura të përsëritshme, me organizim operacional të zhvilluar dhe aftësi për gjenerim të qëndrueshëm të fitimeve, duke prodhuar ndikim të rëndësishëm në tregje, por jo në nivel dominues.	50%
	I ulët	Përfshin aktivitete me volum ekonomik nën 10 milion € në vit, shpesh të lidhura me operacione të vogla ose informale si kultivim narkotikësh dhe trafik i kufizuar, me mungesë të vlerësimeve të sakta financiare dhe me nivel të ulët formalizimi, duke prodhuar ndikim të reduktuar në akumulimin dhe qarkullimin e kapitalit kriminal.	42%

Krahasimi i shpërndarjes së çështjeve sipas komponentëve të vlerësimit (2025-2024)


Grafikët në vijim paraqesin shpërndarjen në përqindje të çështjeve të korrupsionit dhe krimin të organizuar për vitet 2025 dhe 2024, sipas komponentëve të vlerësimit të përcaktuara në metodologjinë e raportit. Për secilën komponent të analizës, paraqitet pesha relative që zënë çështjet në kategorinë përkatëse të vlerësimit (i lartë, mesatar dhe i ulët), duke mundësuar një krahasim të drejtpërdrejtë ndërmjet dy viteve.

Të dhënat e viteve të mëparshme/mesatarja e (2020–2023) nuk janë përfshirë në këtë analizë krahasimore, pasi në fazat fillestare të funksionimit të institucioneve, numri dhe natyra e çështjeve kanë qenë më të kufizuara, ndërkohë që në vijim metodologjia është zhvilluar dhe avancuar më tej. Për një analizë të detajuar të kësaj periudhe, Qendra ka përgatitur një raport të dedikuar.¹

¹ Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG). “Vlerësimi i Performancës: Matja e Efektivitetit, Monitorimi i Progresit dhe Rritja e Llogaridhënies së Prokurorisë së Posaçme (SPAK) dhe Gjykatave të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (2020-2023)”. Tiranë: CSDG, 2024, https://csdgalbania.org/publications/SPAK_Report_2020-2023_AL.pdf


Çështjet e korrupsionit

Grafik 1: Krahasimi i shpërndarjes së çështjeve të korrupsionit sipas komponentëve të vlerësimit në % (2025 vs 2024)



Çështjet e krimit të organizuar

Grafik 2: Krahasimi i shpërndarjes së çështjeve të krimit të organizuar sipas komponentëve të vlerësimit % (2025 vs 2024)



Hyrje

Në fazën aktuale të procesit të integritimit evropian, korrupsioni dhe krimi i organizuar mbeten ndër faktorët më përcaktues për vlerësimin e progresit të Shqipërisë, jo vetëm për shkak të ndikimit të tyre në funksionimin e shtetit të së drejtës, por edhe për shkak të rolit që këto fenomene luajnë në besueshmërinë e përgjithshme të reformave. Kalimi nga një fazë procedurale e hapjes së negociatave drejt një faze më të avancuar, të bazuar në përmbushjen e kushteve të ndërmjetme dhe mbyllëse, ka rritur ndjeshëm fokusin mbi rezultate konkrete në këto fusha, duke e zhvendosur vlerësimin drejt zbatimit efektiv dhe të matshëm në praktikë. Në këtë kontekst, vlerësimi i progresit në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar nuk lidhet vetëm me treguesit proceduralë dhe rezultatet e ndjekjes penale, por gjithnjë e më shumë edhe me mënyrën se si funksionimi i sistemit perceptohet dhe përjetohet në praktikë nga qytetarët, bizneset dhe profesionistët e drejtësisë.²

Kjo dinamikë ka sjellë një rritje të pritshmërive ndaj institucioneve të drejtësisë dhe strukturave të specializuara, veçanërisht në drejtim të ndërtimit të një historiku të qëndrueshme hetimesh, ndjekjesh penale dhe vendimesh gjyqësore në çështje komplekse. Në të njëjtën kohë, zhvillimet e viteve të fundit tregojnë një intensifikim të përpjekjeve institucionale dhe një konsolidim gradual të kapaciteteve, por edhe vijimësinë e sfidave strukturore që lidhen me kompleksitetin e këtyre fenomeneve, kohëzgjatjen e procedurave dhe efektivitetin e rezultateve përfundimtare. Këto sfida shfaqen edhe në perceptimet e përdoruesve dhe profesionistëve të sistemit të drejtësisë, ku kohëzgjatja e procedurave dhe efica e trajtimit të çështjeve vijnë të identifikohen si elementë me ndikim të drejtpërdrejtë në besueshmërinë e sistemit.³

Raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë⁴ e vërtetojnë një forcim të dukshëm të dimensionit ndëshkues. Në veçanti, është konsoliduar roli i strukturave të posaçme, me një rritje të hetimeve komplekse dhe përfshirjen gjithnjë e më të shpeshtë të aktorëve të nivelit të lartë. Hetimet financiare janë bërë më të strukturuar, përdorimi i sekuestrimit dhe konfiskimit është intensifikuar, ndërsa

² World Bank, *Studimi Rajonal i Drejtësisë 2025: Raporti për Shqipërinë* (Washington, DC: World Bank, 2025).

³ Po aty

⁴ European Commission, *Albania 2025 Report*, SWD(2025) 750 final (Brussels: European Commission, 4 November 2025), https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en?filename=albania-report-2025.pdf

European Commission, *Albania 2024 Report*, SWD(2024) 690 final (Brussels: European Commission, 30 October 2024), https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf

European Commission, *Albania 2023 Report*, SWD(2023) 690 final (Brussels: European Commission, 8 October 2023), https://enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf

European Commission, *Albania 2022 Report*, SWD(2022) 332 final (Brussels: European Commission, 12 October 2022), https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/dde85556-8061-41f3-ba0c-5e921158bc53_en?filename=Albania%20Report%202022.pdf

European Commission, *Albania 2021 Report*, SWD(2021) 289 final (Brussels: European Commission, 19 October 2021), <https://enlargement.ec.europa.eu/system/files/2021-10/Albania-Report-2021.pdf>

European Commission, *Albania 2020 Report*, SWD(2020) 354 final (Brussels: European Commission, 6 October 2020), https://enlargement.ec.europa.eu/system/files/2020-10/albania_report_2020.pdf

bashkëpunimi ndërkombëtar, sidomos me agjenci dhe shtete të BE-së, ka prodhuar rezultate konkrete në goditjen e grupeve kriminale me shtrirje ndërkufitare. Në këtë kuptim, mund të flitet për një kalim nga një fazë ndërtimi institucional në një fazë ku po krijohet një praktikë më e qëndrueshme dhe e verifikueshme në ndjekjen penale.

Nga ana tjetër, të njëjtat burime nënvizojnë se këto zhvillime nuk janë shoqëruar me të njëjtin nivel efekti në dimensionin parandalues dhe sistematik. Kjo dinamikë reflektohet edhe në perceptimet mbi funksionimin e sistemit të drejtësisë, ku pavarësisht progresit të raportuar në kuadër të reformës, perceptimet mbi korrupsionin, ndikimin informal dhe pavarësinë institucionale vijojnë të mbeten një komponent i rëndësishëm i debatit mbi efektivitetin real të sistemit.⁵ Korrupsioni vijon të jetë i përhapur në sektorë kyç dhe mbetet një problem i strukturuar, jo vetëm një fenomen i izoluar në raste individuale. Mekanizmat e kontrollit administrativ, si verifikimi i deklarimeve të pasurisë, analizat e riskut apo planet e integritetit, kanë ende ndikim të kufizuar dhe shpesh nuk arrijnë të ndërhyjnë në fazat e hershme të fenomenit. Në mënyrë të ngjashme, në luftën kundër krimit të organizuar, megjithëse janë rritur kapacitetet operacionale, mbeten boshllëqe në analizën kriminale dhe financiare, në rikuperimin efektiv të pasurive dhe në koordinimin ndërinstitutional.

Ky kontrast bëhet edhe më i dukshëm kur shihet në nivelin e çështjeve konkrete, ndërsa rastet e trajtuara tregojnë një rritje të kompleksitetit, të shtrirjes dhe të nivelit të aktorëve të përfshirë, ato njëkohësisht ekspozojnë kufizimet e sistemit në sigurimin e rezultateve përfundimtare dhe në krijimin e një efekti të qëndrueshëm parandalues. Në këtë kuptim, zhvillimet e viteve të fundit përbëjnë një fazë ku kapacitetet ndëshkuese janë forcuar ndjeshëm, ndërsa sfida kryesore mbetet shndërrimi i këtij progresi në një ndikim më të gjerë dhe të qëndrueshëm mbi vetë fenomenet. Nga ana tjetër, këto zhvillime tregojnë se progresi institucional dhe zgjerimi i kapaciteteve ndëshkuese nuk përkthehen automatikisht në një perceptim të konsoliduar mbi efektivitetin dhe integritetin e sistemit të drejtësisë, duke e bërë të domosdoshëm një vlerësim më substancial të ndikimit real të reformave.⁶

Në këtë kuadër, raporti adreson mënyrën se si duhet vlerësuar progresi në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në një kontekst ku këto fenomene paraqiten si të konsoliduara, të adaptueshme dhe të ndërthurura me dimensionin ekonomik dhe institucional. Më konkretisht, pyetja që udhëheq këtë analizë është nëse zhvillimet e viteve të fundit, të reflektuara në rritjen e hetimeve komplekse, përfshirjen e aktorëve të nivelit të lartë dhe intensifikimin e mekanizmave financiarë si sekuestrimi dhe konfiskimi, përbëjnë një ndryshim të qëndrueshëm në raportin ndërmjet shtetit dhe këtyre fenomeneve, apo nëse ato mbeten kryesisht në nivelin e reagimit ndaj rasteve individuale. Në këtë kuptim, analiza synon të kalojë përtej një vlerësimi formal të rezultateve, duke u fokusuar në mënyrën se si këto rezultate lidhen me natyrën dhe dinamikën reale të korrupsionit dhe krimit të organizuar në praktikë.

⁵ World Bank, *Studimi Rajonal i Drejtësisë 2025: Raporti për Shqipërinë* (Washington, DC: World Bank, 2025).

⁶ Po aty

Duke u mbështetur në analizën e çështjeve konkrete dhe në vlerësimin e tyre sipas komponentëve të përcaktuar, ky raport argumenton se ndërhyrja institucionale në Shqipëri ka bërë progres të dukshëm në drejtim të forcimit të dimensionit ndëshkues dhe të zhvillimit të një praktike më të konsoliduar hetimore dhe gjyqësore. Megjithatë, ky progres nuk reflekton ende një raport të plotë proporcional me nivelin e kompleksitetit dhe qëndrueshmërisë së këtyre fenomeneve, veçanërisht në aspektin e goditjes së bazës së tyre ekonomike dhe organizative. Në këtë kuptim, raporti thekson se sfida kryesore qëndron në aftësinë për të transformuar këto ndërhyrje në një ndikim më të gjerë dhe të qëndrueshëm, që redukton hapësirat strukturore për korrupsion dhe krim të organizuar dhe forcon në mënyrë të qëndrueshme integritetin institucional dhe funksionimin e tregut.

Në këtë kontekst, ky raport synon të ofrojë një analizë të thelluar dhe të strukturuar të mënyrës se si korrupsioni dhe krimi i organizuar manifestohen në praktikë, duke u fokusuar jo vetëm në përshkrimin e rasteve, por në identifikimin e modeleve, trendeve dhe dinamikave që karakterizojnë këto fenomene. Për këtë qëllim, raporti është ndërtuar mbi një metodologji analitike të bazuar në vlerësimin e çështjeve konkrete sipas një sërë komponentësh kyç, të cilët lejojnë një lexim më të plotë të kompleksitetit të tyre.

Pjesa e parë përfshin një analizë të detajuar të çështjeve të korrupsionit dhe krimin të organizuar sipas komponentëve përkatës, me qëllim evidentimin e karakteristikave të tyre strukturore dhe operacionale. Pjesa tjetër kryesore e raportit trajton në mënyrë të veçantë dimensionin financiar dhe pasuror të këtyre fenomeneve, duke analizuar rolin dhe efektivitetin e hetimeve financiare, sekuestrimit dhe konfiskimit si instrumente për goditjen e bazës ekonomike të korrupsionit dhe kriminalitetit. Në tërësi, raporti synon të kontribuojë në një kuptim më të thelluar të raportit ndërmjet zhvillimit të fenomenit dhe kapacitetit të reagimit institucional, duke ofruar një bazë analitike për vlerësimin e progresit dhe për identifikimin e sfidave që mbeten në funksion të forcimit të shtetit të së drejtës dhe avancimit të procesit të integritetit evropian.

Metodologjia

Që nga fillimi i monitorimit të veprimtarisë së institucioneve të posaçme, Qendra ka synuar të ndërtojë një metodologji vlerësimi që të kapërcejë kufijtë e analizës tradicionale juridike dhe të ofrojë një kuptim më të thelluar të fenomeneve të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Përgjatë viteve, kjo metodologji është zhvilluar gradualisht, duke reflektuar jo vetëm përvojën e akumuluar nga analizat e mëparshme, por edhe nevojën për të adresuar kompleksitetin gjithnjë në rritje të këtyre fenomeneve.

Në këtë kontekst, raporti për vitin 2025 përfaqëson një fazë të mëtejshme të konsolidimit të kësaj qasjeje analitike. Ashtu si edhe përgjatë viteve të mëparshme, metodologjia e aplikuar në këtë raport synon të ofrojë një lexim më të avancuar të çështjeve, duke u larguar nga një trajtim thjesht përshkrues dhe duke u fokusuar në analizën e strukturës, funksionimit dhe ndikimit real të korrupsionit dhe aktiviteteve të krimit të organizuar.

Në thelb të saj qëndron një kornizë analitike e ndërtuar mbi disa dimensione kyçe, të cilat përfshijnë produktivitetin, efikasitetin dhe relevancën dhe të cilat synojnë të mundësojnë një vlerësim të integruar të çështjeve të korrupsionit dhe krimit të organizuar në institucionet e posaçme.


Në këtë kuadër, instrumenti i posaçëm i vlerësimit është organizuar në dy blloqe kryesore analitike, që reflektojnë dy fenomenet e trajtuara në raport. Për analizën e korrupsionit janë përdorur 6 komponentë vlerësimi, ndërsa për krimin e organizuar janë identifikuar gjithashtu 6 komponentë kryesorë, të cilët së bashku mbulojnë dimensionet thelbësore të strukturës, operimit dhe ndikimit të këtyre fenomeneve. Në total, metodologjia operon me 12 komponentë analitike, të cilët synojnë të ofrojnë një vlerësim të shumëanshëm dhe të thelluar të rasteve. Secili komponent është i ndarë në tre kategori të standardizuara vlerësimi: i lartë, mesatar dhe i ulët, duke krijuar një sistem të unifikuar me 36 kategori vlerësimi në total, të cilat aplikohen në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë analizën. Standardizimi ka synuar ndërtimin e një kornize të qëndrueshme dhe të krahasueshme, që lejon vlerësimin horizontal të rasteve dhe identifikimin e tendencave ndërmjet komponentëve të ndryshëm.

Komponentët për korrupsionin përfshijnë dimensione si niveli substancial i çështjes, kompleksiteti i skemave korruptive, volumi i flukseve financiare, kohëzgjatja dhe vazhdimësia e aktivitetit, roli i aktorëve privatë dhe ndërmjetësve, si dhe vlera e humbjes ekonomike. Ndërkohë, për krimin e organizuar analiza fokusohet në shtrirjen gjeografike të veprimtarisë, madhësinë dhe strukturën e grupeve kriminale, aktivitetet kryesore, kompleksitetin e modus operandi, shkallën e diversifikimit kriminal (polikriminalitetin) dhe vlerën ekonomike të aktiviteteve të përfshira.

Për analizën e çështjeve të korrupsionit dhe krimit të organizuar janë përdorur si burim primar vendimet e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Këto vendime janë trajtuar jo vetëm si akte

përfundimtare të procesit gjyqësor, por burime që lejojnë evidentimin e mënyrës konkrete të organizimit, funksionimit dhe zhvillimit të skemave korruptive dhe aktiviteteve kriminale. Mbështetja në këtë burim është bërë me qëllim për të mundësuar një analizë të bazuar në prova dhe të orientuar drejt realitetit empirik të çështjeve, për të rritur nivelin e objektivitetit të gjetjeve.

Grafik 3: Numri i çështjeve të korrupsionit dhe krimit të organizuar të analizuara për vitin 2025



Burimi: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Qasja e ndjekur nuk është kufizuar në leximin linear të përmbajtjes së vendimeve, por është mbështetur në një proces të strukturuar analitik, i cili ka synuar të nxjerrë në pah elementet thelbësore të çdo çështjeje përtej organizimit të tyre formal.

Në këtë kuadër, analiza është orientuar drejt identifikimit dhe sistematizimit të informacionit që lidhet me strukturën e veprës penale, rolin e aktorëve, mënyrën e realizimit të aktivitetit kriminal dhe dimensionin ekonomik të tij. Duke qenë se vendimet përmbajnë një volum të konsiderueshëm informacioni të natyrës procedurale dhe përshkruese, metodologjia ka parashikuar një proces seleksionimi dhe përpunimi të të dhënave, në mënyrë që fokusi analitik të vendoset mbi ato elemente që kontribuojnë drejtpërdrejt në kuptimin e fenomenit.

Një komponent thelbësor i kësaj qasjeje ka qenë rindërtimi i çështjeve në nivel funksional dhe tematik. Në vend që analiza të ndjekë strikt ndarjen e informacionit sipas të pandehurve apo sipas seksioneve të vendimit, ajo ka synuar të integrojë elementet e shpërndara në tekst në një tablo të vetme analitike. Kjo ka mundësuar që çdo çështje të trajtohet si një tërësi, duke evidentuar lidhjet ndërmjet aktorëve, ndërveprimin e tyre dhe mënyrën se si strukturohet aktiviteti kriminal në praktikë.

Në mënyrë të veçantë, kjo qasje ka lejuar një dallim më të qartë të dimensioneve specifike të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Për çështjet e krimit të organizuar, analiza është fokusuar në rindërtimin e elementeve si struktura e grupit, hierarkia, shtrirja gjeografike dhe diversifikimi i aktiviteteve. Ndërsa për çështjet e korrupsionit, vëmendja është përqendruar në identifikimin e skemave të

ndërveprimet ndërmjet aktorëve publikë dhe privatë, rolit të ndërmjetësve dhe formave të përfitimit të paligjshëm.

Në këtë mënyrë, metodologjia e ndjekur është bazuar në një qasje të ndërmjetme midis leximit teknik të vendimit dhe interpretimit analitik të përmbajtjes së tij. Vendimet gjyqësore nuk janë trajtuar vetëm si produkte përfundimtare të procesit penal, por si burime që lejojnë një kuptim më të thelluar të mënyrës se si manifestohen dhe strukturohen këto forma të kriminalitetit në praktikë. Kjo është bërë me qëllim për të mundësuar analizën të kalojë nga përshkrimi i rasteve individuale drejt ndërtimit të një panorame më të gjerë dhe më të integruar të fenomeneve.

Konsiderata metodologjike dhe analitike në vlerësimin e çështjeve të korrupsionit dhe krimit të organizuar

Analiza e çështjeve të korrupsionit dhe krimit të organizuar në këtë raport synon të pasqyrojë dimensionet kryesore të këtyre fenomeneve përmes një sistemi të unifikuar kategorizimi dhe vlerësimi. Megjithatë, natyra e burimeve të përdorura dhe karakteristikat e vetë fenomeneve mund të imponojnë disa kufizime metodologjike, të cilat duhen marrë në konsideratë në interpretimin e gjetjeve.

Së pari, përdorimi i vendimeve gjyqësore si burim primar i të dhënave përbën një zgjedhje me vlerë të lartë analitike, pasi këto dokumente përfaqësojnë produkte të verifikuara të procesit penal dhe përmbajnë elemente faktike të konsoliduara. Megjithatë, ato nuk janë ndërtuar me qëllim analitik apo statistik, por për të adresuar përgjegjësinë penale në raste konkrete. Si rezultat, niveli i detajimit të informacionit ndryshon ndjeshëm nga një çështje në tjetrën, duke krijuar kufizime në kapjen e plotë dhe të njëtrajtshme të të gjithë indikatorëve të parashikuar në metodologji.

Në këtë kuadër, elementë të rëndësishëm të analizës, si shtrirja e aktivitetit, kompleksiteti i strukturave apo modus operandi në rastet e krimit të organizuar, si dhe dimensionet financiar, niveli substancial i korrupsionit për zyrtarë të nivelit të lartë apo ndikimi ekonomik në rastet e korrupsionit, mund të jenë të përfaqësuar në mënyrë të plotë në disa vendime, ndërsa në të tjera të mbeten të nënkuptuara ose të trajtuara në mënyrë të pjesshme. Për rrjedhojë, vlerësimi nuk reflekton gjithmonë drejtpërdrejt mungesën e një elementi në realitet, por shpesh kufizohet nga mënyra se si ky element është dokumentuar në vendimin gjyqësor.

Së dyti, metodologjia e përdorur, e bazuar në kategorizimin e çështjeve në tre nivele (i ulët, mesatar, i lartë) për secilin komponent, krijon një bazë të rëndësishme për standardizimin dhe krahasueshmërinë e analizës. Megjithatë, kjo qasje përfshin një nivel të pashmangshëm abstragimi, duke reduktuar kompleksitetin e fenomeneve reale në kategori të paracaktuara. Në praktikë, si korrupsioni ashtu edhe krimi i organizuar shpesh paraqiten përmes formave hibride, ku elementë të niveleve të ndryshme bashkëjetojnë në të njëjtin rast. Për këtë arsye, kategorizimi duhet të lexohet si një instrument orientues analitik dhe jo si një klasifikim i ngurtë i realitetit.

Së treti, analiza mbështetet në një numër të kufizuar çështjesh të përfunduara në fazën e gjykimit, çka krijon kufizime në aspektin e përfaqësueshmërisë. Gjetjet reflektojnë më shumë profilin e rasteve që arrijnë të hetohen, provohen dhe gjykohen, sesa të gjithë spektrin e fenomeneve në praktikë. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të bëhet dallimi ndërmjet realitetit të këtyre fenomeneve si struktura dinamike dhe shpesh të fshehura, dhe realitetit të dokumentuar në vendimet gjyqësore, i cili përfaqëson vetëm segmentin e ekspozuar të tyre.

Së katërti, disa indikatorë kyç, veçanërisht ata që lidhen me vlerën ekonomike, flukset financiare apo dëmin ekonomik, nuk janë gjithmonë të kuantifikuar në mënyrë të plotë në vendime. Në këto raste, vlerësimi mbështetet në tregues të tërthortë, si natyra e aktivitetit, lloji i marrëdhënieve ndërmjet aktorëve apo konteksti institucional dhe ekonomik ku zhvillohet veprimtaria. Kjo sjell një komponent interpretimi analitik, i cili është i domosdoshëm për të ndërtuar një lexim të plotë të rasteve, por që duhet të kuptohet në raport me kufijtë e informacionit të disponueshëm.

Në mënyrë më specifike, për krimin e organizuar, kufizimet lidhen edhe me natyrën e tij si fenomen adaptiv dhe fleksibël, ku strukturat, modus operandi dhe rrjetet evoluojnë vazhdimisht dhe nuk janë gjithmonë të kapshme në mënyrë të plotë në dokumentimin gjyqësor. Ndërsa për korrupsionin, sfida metodologjike lidhet veçanërisht me identifikimin e nivelit substancial të tij, ku dallimi ndërmjet statusit formal të aktorëve dhe peshës reale të veprës krijon shpesh zona gri analitike, si dhe me vështirësinë për të kapur plotësisht ndërthurjen ndërmjet aktorëve publikë dhe privatë dhe ndikimin e tyre në tregje apo politika publike.

Së fundi, të dyja fenomenet karakterizohen nga një nivel i lartë informaliteti dhe përdorimi i mekanizmave të fshehjes, çka e bën të vështirë kapjen e plotë të tyre përmes instrumenteve formale të analizës. Për rrjedhojë, analiza duhet të interpretohet si një fotografi e strukturuar e fenomeneve të evidentuara, dhe jo si një pasqyrë shteruese e të gjithë realitetit.

Pavarësisht këtyre kufizimeve metodologjike, ndërtimi i një analize të tillë mbetet thelbësor për të kuptuar në mënyrë të strukturuar dhe të krahasueshme tiparet reale të korrupsionit dhe krimit të organizuar në kontekstin institucional dhe ekonomik ku ato zhvillohen. Në mungesë të instrumenteve të standardizuara për leximin e këtyre fenomeneve, ekziston rreziku që ato të trajtohen në mënyrë fragmentare, të kufizuara në përshkrime rastësore apo në tregues të përgjithshëm që nuk kapin kompleksitetin e tyre. Kjo analizë synon pikërisht të tejkalojë këtë boshllëk, duke ofruar një kornizë që lejon identifikimin e modeleve, krahasimin ndërmjet rasteve dhe evidentimin e prirjeve kryesore në mënyrën se si këto forma kriminaliteti manifestohen dhe trajtohen nga institucionet respektive. Në këtë kuptim, raporti nuk synon të japë një pasqyrë shteruese të fenomeneve, por të ndërtojë një bazë të qëndrueshme analitike, mbi të cilën mund të zhvillohen diskutime më të thelluara mbi efektivitetin e ndjekjes penale, prioritetet institucionale dhe ndikimin real të ndërhyrjeve në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Metrika e vlerësimit: Çështjet e korrupsionit

Kategoria	Çfarë mat	Rëndësia dhe qëllimi për analizën	I ulët	Mesatar	I lartë
Korrupsioni i zyrtarëve të nivelit të lartë	Peshën reale të përfshirjes së zyrtarëve të nivelit të lartë në korrupsion, përtej statusit formal	Lejon dallimin midis rasteve formalisht "high-level" dhe atyre që kanë ndikim real sistemik në institucione, treg dhe politika publike	Subjekt i nivelit të lartë vetëm formal; përfitim i kufizuar; ndikim lokal ose individual	Përfshirje e pjesshme substanciale; përfitim mesatar; ndikim sektorial ose institucional	Përfshirje substanciale e zyrtarëve të lartë; përfitime të konsiderueshme; ndikim sistemik në treg, politika ose institucione
Kompleksiteti i skemave korruptive	Shkallën e organizimit, sofistikimit dhe mekanizmave të fshehjes së korrupsionit	Ndihmon në identifikimin e nivelit të kapacitetit kriminal dhe të vështirësisë hetimore, si dhe lidhjen me forma të avancuara të krimit ekonomik	Skema të thjeshta, direkte, pa fshehje apo ndërmjetës	Skema me elementë fshehjeje dhe organizimi të moderuar	Skema shumë të sofistikuara (offshore, kompani guaskë, ndërmjetës të strukturuar, manipulim sistemik)
Volumi i flukseve financiare	Madhësinë e transaksioneve të lidhura me korrupsionin	Jep një tregues të qartë për peshën ekonomike të korrupsionit dhe potencialin për deformim të tregut	Transaksione të vogla (deri €400,000); ndikim lokal	Transaksione të mesme (€400,000-€1M); ndikim sektorial	Transaksione të mëdha (€1M+); lidhje me tendera, koncesione dhe sektorë strategjikë

Kategoria	Çfarë mat	Rëndësia dhe qëllimi për analizën	I ulët	Mesatar	I lartë
Kohëzgjatja dhe vazhdimësia e aktivitetit korruptiv	Shtirirjen në kohë dhe qëndrueshmërinë e skemës korruptive	Dallon korrupsionin episodik nga ai i strukturuar dhe i qëndrueshëm, me implikime për rrezikun sistematik	Aktivitet episodik, afatshkurtër, i paorganizuar	Aktivitet i përsëritur me organizim të moderuar	Aktivitet i zgjatur, i strukturuar dhe i konsoliduar në kohë
Roli i aktorëve privatë dhe ndërmjetësve	Nivelin e ndërthurjes publik-privat dhe përdorimin e ndërmjetësve	Evidenton mekanizmat përmes të cilëve korrupsioni depërton në ekonomi dhe krijon rrjete të qëndrueshme ndikimi	Marrëdhënie direkte, pa ndërmjetës ose me rol minimal	Ndërthurje funksionale me ndërmjetës aktivë	Ndërthurje strukturore publik-privat me rrjete të qëndrueshme dhe ndërmjetës të organizuar
Vlera e humbjes/dëmit ekonomik	Dëmin financiar të shkaktuar ndaj shtetit ose tregut	Mat ndikimin real ekonomik të korrupsionit dhe rëndësinë e tij për financat publike dhe konkurrencën	Dëm i kufizuar (deri €400,000); ndikim lokal	Dëm i konsiderueshëm (€400,000–€1M); ndikim sektorial	Dëm i lartë (€1Million+); ndikim i gjerë në financat publike dhe ekonomi

Metrika e vlerësimit: Çështjet e krimit të organizuar

Kategoria	Çfarë mat	Rëndësia dhe qëllimi për analizën	I ulët	Mesatar	I lartë
Shtrirja gjeografike e veprimtarisë kriminale	Hapësirën territoriale ku operon grupi kriminal	Lejon identifikimin e dimensionit ndërkombëtar të krimit dhe lidhjen me rrjete transnacionale	Veprimtari kryesisht brenda Shqipërisë; ndikim lokal	Veprimtari ndërkufitare me një vend tjetër; lidhje të kufizuara ndërkombëtare	Veprimtari ndërkombëtare në disa shtete; rrjete të konsoliduara dhe operacione të koordinuara
Madhësia dhe struktura e grupit kriminal	Numrin e anëtarëve dhe nivelin e organizimit të brendshëm	Jep një tregues për kapacitetin operativ, qëndrueshmërinë dhe potencialin për zgjerim të aktivitetit kriminal	Grup i vogël, strukturë e thjeshtë dhe fleksibël	Grup i mesëm me organizim funksional dhe role bazike	Grup i madh me hierarki të qartë, role të specializuara dhe strukturë të qëndrueshme
Pesha dhe përhapja e aktiviteteve kriminale	Dominimin dhe ndikimin e aktiviteteve kryesore në tregun kriminal	Ndihmon në vlerësimin e ndikimit real të grupit në ekonominë kriminale dhe në shoqëri	Aktivitetet sporadik ose i kufizuar në sektorë specifike	Prani e konsiderueshme me ndikim të moderuar dhe veprimtari të qëndrueshme	Dominim i tregut kriminal, ndikim i gjerë ekonomik dhe lidhje të forta me korrupsionin dhe dhunën
Kompleksiteti i modus operandi	Nivelin e sofistikimit të metodave kriminale dhe teknologjisë së përdorur	Evidenton aftësinë e grupeve për të shmangur drejtësinë dhe për të	Metoda tradicionale, teknologji e kufizuar,	Përdorim i moderuar i teknologjisë dhe mekanizmave të fshehjes	Metoda shumë të sofistikuara (kriptim, offshore, rrjete

Kategoria	Çfarë mat	Rëndësia dhe qëllimi për analizën	I ulët	Mesatar	I lartë
		operuar në mënyrë të avancuar	operacione të drejtpërdrejta		financiare komplekse, infiltrimi institucional)
Polikriminaliteti (diversifikimi i aktiviteteve)	Numrin dhe larminë e aktiviteteve kriminale të ushtruara nga grupi	Mat kapacitetin e grupit për diversifikim dhe rezistencë ndaj presionit ligjor	Fokus në 1-2 aktivitete kriminale (grup i specializuar)	Angazhim në disa aktivitete (3-4), me diversifikim të moderuar	Diversifikim i lartë (5+ aktivitete), operim shumësektorial dhe i integruar
Vlera ekonomike e aktiviteteve kriminale	Volumin financiar të mallrave/fitimeve të gjeneruara	Jep një tregues për peshën reale ekonomike të kimit të organizuar dhe ndikimin në ekonomi	Vlerë e ulët (< €10 milion); ekonomi informale dhe e paformalizuar	Vlerë e konsiderueshme (€10-50 milion); aktivitet i strukturuar	Vlerë shumë e lartë (> €50 milion); ndikim i drejtpërdrejtë në treg dhe ekonomi

Analiza e gjetjeve të vlerësimit

Në vijim të kuadrit metodologjik të paraqitur më sipër, ky seksion synon të zhvillojë një analizë të detajuar të gjetjeve të vlerësimit, duke u fokusuar në mënyrën se si korrupsioni dhe krimi i organizuar manifestohen në praktikë dhe në çfarë mase karakteristikat e tyre përputhen me dinamikat dhe kompleksitetin që i shoqërojnë këto fenomene. Duke u mbështetur në shqyrtimin e çështjeve konkrete, analiza nuk synon thjesht përshkrimin e rasteve individuale, por identifikimin e modeleve të përsëritura, strukturave funksionale dhe mekanizmave përmes të cilëve këto forma kriminaliteti zhvillohen dhe operojnë në kontekstin shqiptar.

Në këtë kuptim, qasja e ndjekur bazohet në një lexim substancial të çështjeve, ku rëndësi nuk i jepet vetëm elementëve formalë të veprave penale apo statusit të subjekteve të përfshirë, por mbi të gjitha mënyrës se si këto elemente ndërthuren për të krijuar struktura më të gjera dhe më të qëndrueshme veprimtarie kriminale. Analiza synon të evidentojë jo vetëm nivelin e kompleksitetit të rasteve, por edhe mënyrën se si ky kompleksitet reflektohet në organizimin, kohëzgjatjen, dimensionin financiar dhe ndërveprimin ndërmjet aktorëve të përfshirë.

Struktura e këtij seksioni është ndërtuar mbi dy komponentë kryesorë, që trajtojnë veçmas korrupsionin dhe krimin e organizuar, duke respektuar natyrën e ndryshme, por njëkohësisht të ndërlidhur të këtyre fenomeneve. Në secilin prej tyre, analiza zhvillohet mbi bazën e komponentëve të përcaktuar në metodologji, të cilët lejojnë një vlerësim të shumëdimensionshëm të çështjeve, duke përfshirë elementë si niveli i kompleksitetit, shtrirja e aktivitetit, struktura e grupeve apo skemave, roli i aktorëve të përfshirë dhe dimensionin ekonomik i veprimtarisë.

Megjithëse korrupsioni dhe krimi i organizuar trajtohen në mënyrë të ndarë për qëllime analitike, analiza mban parasysh ndërthurjen e tyre të vazhdueshme në praktikë. Në shumë raste, këto fenomene nuk shfaqen si realitete të izoluara, por si pjesë e të njëjtit ekosistem, ku korrupsioni mund të shërbejë si mekanizëm lehtësues për aktivitetin kriminal, ndërsa krimi i organizuar krijon dhe ushqen kërkesën për ndërhyrje korruptive në strukturat institucionale dhe ekonomike. Për këtë arsye, leximi i gjetjeve nuk kufizohet në një analizë të fragmentuar, por synon të ofrojë një kuptim të integruar të tyre.

Në këtë kontekst, rëndësi të veçantë merr identifikimi i trendeve që dalin nga analizimi i çështjeve, të cilat shërbejnë si tregues të mënyrës se si këto fenomene po evoluojnë dhe po përshtaten në kohë. Këto trende nuk duhet të kuptohen si përfundime të izoluara, por si elementë që kontribuojnë në ndërtimin e një tabloje më të gjerë mbi funksionimin real të korrupsionit dhe krimin të organizuar, si dhe mbi sfidat që paraqiten në trajtimin e tyre.

Në tërësi, ky seksion synon të ofrojë një analizë që shkon përtej nivelit deskriptiv, duke krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet gjetjeve empirike dhe interpretimit të tyre në kontekstin më të gjerë të zhvillimit të këtyre fenomeneve në Shqipëri. Përmes kësaj qasjeje, synohet të evidentohet jo vetëm se çfarë tregojnë çështjet e analizuar, por edhe se çfarë nënkuptojnë ato për mënyrën se si korrupsioni dhe krimi i organizuar funksionojnë dhe evoluojnë në kontekstin e gjerë.

1. Analiza e rasteve të korrupsionit

Analiza e korrupsionit në Shqipëri, gjithnjë e më shumë ka shfaqur nevojën për ta trajtuar atë veçanërisht në kontekstin e ndikimit të tij ekonomik dhe financiar, ndjekur nga një qasje që e vendos këtë fenomen jo thjesht në planin penal, por si një faktor strukturor që ndikon drejtpërdrejt në funksionimin e shtetit, klimën e biznesit dhe zhvillimin ekonomik të vendit.⁷ Pavarësisht një kuadri ligjor të konsoliduar dhe përpjekjeve të vazhdueshme reformuese, korrupsioni vijon të mbetet një nga sfidat më të rëndësishme sistemike, si një fenomen jo i izoluar, por një element që ndërthuret me një sërë faktorë të tjerë strukturorë. Në veçanti, ai manifestohet në fusha kyçe të administrimit publik, përfshirë prokurimet publike, sistemin gjyqësor dhe marrëdhëniet ndërmjet sektorit publik dhe atij privat, duke ndikuar drejtpërdrejt në besimin e investitorëve dhe eficiencën e tregut.

Të dhënat mbi dëmin ekonomik të shkaktuar nga praktikatat abuzive dhe korruptive tregojnë një impakt të konsiderueshëm dhe të vazhdueshëm në financat publike. Auditimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit evidentojnë se dëmi ekonomik i lidhur me shkeljet në administratën publike dhe keqmenaxhimin e fondeve arrin në qindra milionë euro çdo vit, duke reflektuar jo vetëm humbje direkte financiare, por edhe kosto të fshehura që lidhen me uljen e eficiencës së investimeve publike dhe deformimin e prioritetëve buxhetore. Në këtë kontekst, dëmi ekonomik i lidhur me veprimtaritë korruptive dhe abuzive nuk duhet parë thjesht si një tregues financiar, por si një indikator kyç i cilësisë së qeverisjes dhe integritetit institucional, duke reflektuar nivelin e respektimit të ligjit, funksionimin e mekanizmave të kontrollit dhe efektivitetin e administrimit publik.

Në vitin 2025, dëmi ekonomik arriti në rreth 26.2 miliardë lekë (rreth 273 milionë euro), duke shënuar një rritje të dukshme krahasuar me vitin 2024, ku ky dëm ishte rreth 16 miliardë lekë (rreth 172 milionë euro). Evidentohet se dëmi ekonomik ka arritur nivele edhe më të larta në vitet e mëparshme, si në vitin 2023 me mbi 72 miliardë lekë, apo në vitin 2022 me rreth 138 miliardë lekë, çka tregon se fenomeni nuk është episodik, por lidhet me modele të përsëritura të keqadministrimit dhe shkeljeve ligjore. Edhe në vitet më të hershme, si 2021 dhe 2020, megjithëse në nivele më të ulëta absolute, dëmi ekonomik mbetet i konsiderueshëm, duke konfirmuar një prirje të vazhdueshme të ndikimit financiar negativ në buxhetin e shtetit.⁸

⁷ U.S. Department of State, *2025 Investment Climate Statements: Albania* (Washington, DC: U.S. Department of State, 2025), <https://www.state.gov/reports/2025-investment-climate-statements/albania/>

⁸ Kontrolli i Lartë i Shtetit, *Raporti Vjetor i Performancës 2025* (Tiranë: KLSH, 2026), <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202604080837169394Raporti%20i%20Performances%202025.pdf>

K Kontrolli i Lartë i Shtetit, *Raporti Vjetor i Performancës 2024* (Tiranë: KLSH, 2025), <https://klsh.org.al/wp-content/uploads/2026/02/Raporti-Vjetor-i-Performances-2024.pdf>

K Kontrolli i Lartë i Shtetit, *Raporti Vjetor i Performancës 2023* (Tiranë: KLSH, 2024), <https://klsh.org.al/wp-content/uploads/2025/04/Raporti-Vjetor-i-Performances-2023.pdf>

K Kontrolli i Lartë i Shtetit, *Raporti Vjetor i Performancës 2022* (Tiranë: KLSH, 2023), <https://klsh.org.al/wp-content/uploads/2025/05/Raporti-Vjetor-i-Performances-2022.pdf>

Nga pikëpamja cilësore, burimi kryesor i këtij dëmi lidhet në mënyrë të qëndrueshme me disa fusha kritike: prokurimet publike, të cilat rezultojnë “thembrë e Akilit”, me problematika në planifikim, vlerësim ofertash dhe respektim të parimeve të konkurrencës; menaxhimi i kontratave publike dhe PPP-ve, ku evidentohen pagesa për shërbime të pakryera ose të realizuara pjesërisht; administrimi i të ardhurave dhe disiplinës buxhetore, përfshirë mangësi në mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe doganore; apo menaxhimi i pasurisë publike dhe investimeve, shpesh i shoqëruar me mungesë efektiviteti dhe kontrolli. Një element me rëndësi është fakti se një pjesë e konsiderueshme e dëmit ekonomik nuk përfaqëson vetëm humbje direkte financiare, por edhe efekte negative të zgjatura në performancën e financave publike, si krijimi i detyrimeve të prapambetura, shtrembërimi i konkurrencës në treg dhe ulja e eficiencës së investimeve publike.

Pavarësisht, zhvillime të fundit dhe përpjekjeve për të ndërtuar mekanizma më efektive të luftës kundër korrupsionit, të konsideruar thelbësore edhe në kuadër të procesit të integritetit evropian dhe përmirësimit të klimës së investimeve, duhet theksuar se lufta kundër korrupsionit në Shqipëri paraqitet si bashkëjetesë e dy realiteteve: një realiteti penal, ku ka më shumë hetime, më shumë çështje komplekse dhe më shumë goditje të figurave me peshë dhe një realiteti institucional e shoqëror, ku korrupsioni vijon të perceptohet si i përhapur, ku masat parandaluese nuk kanë ende efekt transformues dhe ku integriteti i administrimit publik mbetet i brishtë.

Vitet e fundit përbëjnë një periudhë më aktive në evolucionin e luftës kundër korrupsionit në Shqipëri, e karakterizuar nga një intensifikim i dukshëm i veprimeve hetimore dhe procedurale, veçanërisht në raport me rastet që përfshijnë zyrtarë të nivelit të lartë.⁹ Këto raste shpesh kanë përfshirë skema të ndërlikuara, që përfshijnë përdorimin e ndërmjetësve, manipulimin e procedurave publike dhe ndërthurjen e interesave private me funksionin publik. Paralelisht, është vënë re gjithashtu një rritje më e theksuar e dimensionit financiar të hetimeve, ku fokusi nuk mbetet vetëm në provimin e veprës penale, por zgjerohet në identifikimin dhe ndjekjen e përfitimeve ekonomike që burojnë prej saj. Megjithatë, ndërsa ka një avancim të dukshëm në drejtim të ndërtimit të një praktike më të qëndrueshme të ndjekjes së korrupsionit, konsolidimi i plotë i këtij progresi mbetet ende në zhvillim.

Komisioni Evropian, në raportin për Shqipërinë dhe në kapitullin për shtetin e së drejtës për vitin 2025, vlerëson se SPAK ka konsoliduar rezultate pozitive në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë, ka bërë përparim të prekshëm drejt një “track record” /historiku më solid dhe ka përmirësuar përdorimin e hetimeve financiare dhe konfiskimit të pasurive. Megjithatë, i njëjti vlerësim nënvizon se korrupsioni mbetet i përhapur në sektorë të cënueshëm, se kuadri institucional i parandalimit vazhdon të ketë ndikim të kufizuar, se koordinimi me organet e zbatimit të ligjit mbetet i

Kontrolli i Lartë i Shtetit, *Raporti Vjetor i Performancës 2021* (Tiranë: KLSH, 2022), <https://klsh.org.al/wp-content/uploads/2025/05/Raporti-Vjetor-i-Performances-2021.pdf>

Kontrolli i Lartë i Shtetit, *Raporti Vjetor i Performancës 2020* (Tiranë: KLSH, 2021), <https://klsh.org.al/wp-content/uploads/2025/05/Raporti-Vjetor-i-Performances-KLSH-2020-Alb.pdf>

⁹ Balkan Insight, “Timeline: Albania’s High-Level Corruption Cases Raise Political Temperature,” 23 mars 2026, <https://balkaninsight.com/2026/03/23/timeline-albanias-high-level-corruption-cases-raise-political-temperature/bi/>

dobët, dhe se kontrollet mbi deklarin e pasurisë dhe masat parandaluese kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Po ashtu, raporti evidenton se, pavarësisht rezultateve të SPAK, kapacitetet njerëzore, teknike dhe organizative mbeten nën presion për shkak të rritjes së ngarkesës dhe nevojës për më shumë referime proaktive nga institucionet e tjera shtetërore.¹⁰

Në të njëjtën linjë, raporti i Parlamentit Europian për Shqipërinë thekson se korrupsioni mbetet një shqetësim serioz dhe se vendi duhet të konsolidojë më tej rezultatet në hetime, ndjekje penale dhe dënime përfundimtare, veçanërisht në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë.¹¹ Vlerësimi e vendos çështjen e korrupsionit jo vetëm si problem të sundimit të ligjit, por edhe si faktor që ndikon drejtpërdrejt mbi besimin e qytetarëve, klimën e biznesit dhe ritmin e integritit europian. Në tërësi, mesazhi i institucioneve evropiane është se progresi nuk matet më vetëm me hapjen e procedimeve apo me peshën simbolike të rasteve të ndjekura, por me aftësinë për të krijuar një standard të qëndrueshëm përgjegjshmërie në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Transparency International e renditi Shqipërinë me 39 pikë nga 100 në indeksin më të fundit të perceptimit të korrupsionit, me një rënie prej 3 pikësh nga viti i mëparshëm, çka tregon se, pavarësisht aktivizimit të ndjekjes penale, perceptimi mbi integritetin e sektorit publik mbetet i dobët.¹² Pamja e perceptimit publik e përforcon këtë konstatim. Sipas Barometrit të Sigurisë 2025, korrupsioni dhe krimi i organizuar renditen dukshëm mbi kërcënimet e tjera, duke reflektuar bindjen se rreziku kryesor për qëndrueshmërinë e vendit vjen kryesisht nga dobësitë e brendshme të qeverisjes, mungesa e integritetit institucional dhe cënueshmëria ndaj kapjes së shtetit.¹³

Veprimtaria dhe fokusi i SPAK është zhvendosur drejt çështjeve më komplekse dhe me më shumë persona të përfshirë. Kjo evidentohet nga natyra e rasteve të trajtuara, ku një pjesë e konsiderueshme lidhet me dyshime për devijim të fondeve publike dhe favorizim të operatorëve ekonomikë përmes marrëdhënieve të afërta apo interesave të ndërlidhura. Këto raste kanë nxjerrë në pah një dimension më të gjerë të korrupsionit, i cili nuk kufizohet vetëm në dëm financiar, por prodhon deformim të konkurrencës dhe rrezikon të zhvendosë rolin e shtetit nga garantues i interesit publik në instrument të interesave të veçanta.

Çështje të tjera të trajtuara kanë evidentuar procedura të mëdha infrastrukturore dhe ndërhyrje të dyshuara në tendera me vlera të konsiderueshme, duke e vendosur

¹⁰ European Commission, *2025 Rule of Law Report - Country Chapter on the Rule of Law Situation in Albania*, SWD(2025) 928 final (Brussels: European Commission, 8 July 2025), https://commission.europa.eu/document/download/3732ae59-5ab4-48a6-a3e6-0ef9aa593863_en?filename=2025%20Rule%20of%20Law%20Report%20-%20Country%20Chapter%20Albania.pdf

¹¹ European Parliament, *Draft Report on the 2025 Commission Report on Albania* (AFET_PR(2026)784259, Brussels: European Parliament, 16 February 2026), https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/AFET-PR-784259_EN.pdf

¹² Transparency International, *Corruption Perceptions Index 2025 - Albania* (Berlin: Transparency International, 2026), <https://www.transparency.org/en/cpi/2025/index/alb>


¹³ Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG), *Barometri i Sigurisë 2025: Anketë Kombëtare 2025 - Shqipëri* (Tiranë: CSDG, 2025), https://csdgalbania.org/publications/Barometri_i_Sigurise_2025.pdf

korruptionin jo vetëm në kuadrin e integritetit institucional, por edhe në atë të menaxhimit të zhvillimit ekonomik dhe të shpërndarjes së burimeve publike. Gjithashtu, çështje të konsoliduara të kontratave publike, përfshirë rastet e inceneratorëve, kanë evidentuar dobësi të akumuluar në mekanizmat e kontrollit administrativ, financiar dhe politik, përpara se ndërhyrja të materializohet në fazën penale.

Në vitet e fundit, zhvillimet në fushën e luftës kundër korruptionit tregojnë një intensifikim të dukshëm të ndërhyrjes penale, pa arritur ende në një fazë të konsoliduar të kontrollit të fenomenit. Shqipëria ka shfaqur progres në rritjen e kapaciteteve për hetimin dhe ndjekjen e çështjeve me profil të lartë, një qasje më të qartë ndaj korruptionit si problem i integritetit të shtetit dhe një ndërgjegjësim në rritje për ndërlidhjen e tij me krimin e organizuar, deformimin e tregut dhe dobësimin e sundimit të ligjit.

Megjithatë, këto zhvillime ndërveprojnë me një sërë treguesish që dëshmojnë për qëndrueshmërinë e rrezikut. Korruptioni vijon të perceptohet si një nga kërcënimet kryesore të brendshme, sektorë të caktuar mbeten të ekspozuar ndaj abuzimit, mekanizmat parandalues rezultojnë me ndikim të kufizuar dhe efektiviteti i institucioneve përtej strukturave të specializuara nuk është i njëtrajtshëm. Kjo situatë sugjeron se, pavarësisht progresit në planin penal, sfida thelbësore mbetet shndërrimi i rezultateve individuale në ndryshime strukturore dhe të qëndrueshme në funksionimin e institucioneve. Në këtë kuptim, vlerësimi i gjendjes së korruptionit në Shqipëri kërkon një qasje të balancuar ku nga njëra anë evidentohet një avancim real dhe i matshëm në trajtimin e rasteve më të rënda, ndërsa nga ana tjetër mbetet e kufizuar ulja e cenueshmërisë institucionale që e gjeneron dhe e riprodhon këtë fenomen në kohë.

Grafik 4: Ecuria e çështjeve të korruptionit në Prokurorinë e Posaçme (2025 vs 2024)




Burimi: Prokuroria e Posaçme kundër Korruptionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK)

Numri i procedimeve të regjistruara për korrupsion në Prokurorinë e Posaçme ka mbetur pothuajse në të njëjtin nivel, me një diferencë minimale ndërmjet dy viteve të fundit (183 në 2025 kundrejt 186 në 2024). Procedimet e dërguara për gjykim kanë shënuar ulje, nga 41 në 2024 në 33 në 2025. Në të njëjtën kohë, numri i të pandehurve në çështjet e korrupsionit gjithashtu ka qenë më i ulët, nga 193 në 2024 në 175 në 2025. Evidentohet një tendencë e kundërt për të pandehurit në çështjet e dërguara për gjykim, nga 141 në 2024 në 160 në 2025. Ndërkohë, numri i të pandehurve të dënuar ka shënuar ulje, nga 134 në 2024 në 108 në 2025.

Ndërkohë në lidhje me të dhënat mbi ecurinë e çështjeve të korrupsionit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë, evidentohet një nivel relativisht i qëndrueshëm i volumit të çështjeve ndërmjet viteve 2024 dhe 2025. Në vitin 2025 janë regjistruar 44 çështje të reja, krahasuar me 41 çështje në vitin 2024, duke reflektuar një rritje të lehtë të numrit të procedimeve të reja të trajtuara nga gjykata. Numri i çështjeve të mbartura rezulton i njëjtë në të dy vitet, me nga 19 çështje, çka tregon një nivel të pandryshuar të stokut procedural në fillim të periudhës pasuese. Ndërkohë, për sa i përket çështjeve të përfunduara, në vitin 2025 janë përfunduar 38 çështje, kundrejt 41 çështjeve në vitin 2024. Në tërësi, të dhënat paraqesin një dinamikë relativisht stabile të fluksit të çështjeve të korrupsionit në gjykatë, me ndryshime të kufizuara ndërmjet dy viteve të fundit të analizuara.

Grafik 5: Ecuria e çështjeve të korrupsionit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë (2025 vs 2024)




Burimi: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

Të dhënat mbi treguesit e eficiencës lidhur me çështjet e korrupsionit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë tregojnë ndryshime ndërmjet viteve 2024 dhe 2025 në disa prej indikatorëve kryesorë të kohëzgjatjes dhe përfundimit të çështjeve. Norma e likuidimit të çështjeve rezulton 86% në vitin 2025, krahasuar me 100% në vitin 2024, duke reflektuar një ulje të raportit ndërmjet çështjeve të përfunduara

dhe atyre të reja të regjistruara. Ndërkohë, koha mesatare për zgjidhjen e çështjeve paraqitet më e lartë në vitin 2025, me 240 ditë, kundrejt 169 ditëve në vitin 2024. Sa i përket çështjeve më të vjetra se dy vite në fund të periudhës, në vitin 2025 rezultojnë 2 çështje të tilla, ndërsa në vitin 2024 nuk rezulton asnjë çështje në këtë kategori. Po ashtu, në vitin 2025, 8% e çështjeve kanë qenë në pritje të gjykimit mbi dy vite, ndërsa në vitin 2024 ky tregues rezulton 0%. Në tërësi, të dhënat tregojnë një rritje të kohëzgjatjes së trajtimit të çështjeve dhe të pranisë së çështjeve me kohëzgjatje më të gjatë procedurale në vitin 2025 krahasuar me vitin pararendës.


Të dhënat mbi kohëzgjatjen e çështjeve të korrupsionit të gjykuara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë tregojnë se pjesa më e madhe e çështjeve në të dy vitet janë përfunduar brenda një periudhe më të shkurtër se 6 muaj. Në vitin 2025, 31 çështje janë gjykuar brenda këtij afati, ndërsa në vitin 2024 rezultojnë 34 çështje. Për çështjet me kohëzgjatje nga 6 deri në 12 muaj, në vitin 2025 rezultojnë 2 çështje, kundrejt 5 çështjeve në vitin 2024. Ndërkohë, numri i çështjeve me kohëzgjatje nga 1 deri në 2 vite është më i lartë në vitin 2025, me 3 çështje, krahasuar me 1 çështje në vitin 2024. Po ashtu, për çështjet që kanë zgjatur mbi 2 vite, në vitin 2025 rezultojnë 2 çështje, ndërsa në vitin 2024 rezulton 1 çështje. Në tërësi, të dhënat tregojnë se, megjithëse shumica e çështjeve vijojnë të përfundojnë në afate relativisht të shkurtra, në vitin 2025 evidentohet një prani më e lartë e çështjeve me kohëzgjatje më të zgjatur krahasuar me vitin 2024.

Grafik 6: Tregues të efijencës lidhur me çështjet e korrupsionit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë (2025 vs 2024)



Burimi: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Grafik 7: Kohëzgjatja e çështjeve të korrupsionit të gjykuara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë (2025 vs 2024)



Burimi: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

1.1. Korrupsioni i zyrtarëve të nivelit të lartë

Në analizën e korrupsionit në nivel të lartë, një nga sfidat kryesore vazhdon të mbetet mungesa e një përkufizimi të unifikuar dhe operacional për korrupsionin e zyrtarëve të këtij niveli. Edhe në nivel ndërkombëtar, instrumentet kryesore ligjore nuk ofrojnë një përkufizim të vetëm dhe të detyrueshëm, duke lënë hapësirë për interpretime të ndryshme në nivel kombëtar dhe institucional.¹⁴ Megjithatë, zhvillimet e fundit në kuadër të OECD, Këshillit të Europës, Bashkimit European dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë tregojnë një tendencë të qartë drejt konsolidimit të një kuptimi më të strukturuar të këtij fenomeni.¹⁵

Në thelb, korrupsioni i nivelit të lartë nuk identifikohet vetëm nga statusi formal i subjektit/ve, por nga ndërthurja e disa elementeve thelbësore siç janë: (i) përfshirja e zyrtarëve me funksione vendimmarrëse ose ndikim të lartë institucional; (ii) përfitimi i konsiderueshëm material ose jomaterial; dhe (iii) ndikimi i drejtpërdrejtë ose sistemik në funksionimin e institucioneve publike, tregut dhe politikave publike. Kjo qasje e kombinuar është veçanërisht e rëndësishme, për të shmangur reduktimin e konceptit vetëm në listimin formal të posteve, duke e orientuar analizën drejt peshës reale të veprës penale dhe pasojave të saj në interesin publik.

¹⁴ Organisation for Economic Co-operation and Development (OECD), *Combating High-Level Corruption in Eastern Europe* (Paris: OECD Publishing, 2024), https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2024/09/combating-high-level-corruption-in-eastern-europe_1f4dff82/3c82f87d-en.pdf

¹⁵ Po aty

Praktika ndërkombëtare dëshmon një pluralitet qasjesh. Në disa raste, si në kuadër të OECD/ACN, korrupsioni i nivelit të lartë lidhet me pragje të konsiderueshme përfitimi dhe përfshirjen e zyrtarëve të lartë publikë apo personave të ekspozuar politikisht (PEP). Ndërkohë, qasjet e tjera si ato të Këshillit të Europës apo të BE-së fokusohen më shumë në funksionin dhe rolin institucional të aktorëve, duke përfshirë nivelet më të larta të ekzekutivit, legjislativit, gjyqësorit dhe institucioneve të pavarura.¹⁶

Edhe, analiza e vendeve të Europës Lindore dhe Ballkanit tregon se në praktikë shumë shtete nuk kanë një përkufizim të drejtpërdrejtë në legjislacion; përdoren qasje të fragmentuara, shpesh të lidhura me juridiksionin e institucioneve të specializuara; kufijtë midis korrupsionit të zakonshëm dhe atij të nivelit të lartë mbeten të paqartë. Kjo mungesë harmonizimi ndikon drejtpërdrejt në mënyrën se si maten rezultatet, si prioritizohen hetimet dhe si ndërtohen politikat kundër korrupsionit.¹⁷

Në kontekstin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, korrupsioni i nivelit të lartë paraqitet gjithashtu me disa tipare të përsëritura ndërthurja me pushtetin politik dhe ekonomik, përfshirë kapjen e proceseve vendimmarrëse; përdorimi i strukturave shtetërore dhe ndërmarrjeve publike për përfitime private; ndikimi në prokurime publike, koncesione dhe menaxhimin e burimeve publike dhe lidhjet me krimin e organizuar, ku korrupsioni vepron si mekanizëm lehtësues.¹⁸

Në Shqipëri, trajtimi i korrupsionit të zyrtarëve të nivelit të lartë përcakton si subjektet ashtu edhe juridiksionin institucional për hetimin dhe ndjekjen penale të këtyre veprave. Në këtë kuadër, Prokuroria e Posaçme (SPAK), në përputhje me nenin 135, paragrafi 2, të Kushtetutës dhe legjislacionin përkatës, ushtron ndjekjen penale për një gamë të gjerë veprash penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, duke përfshirë si veprat specifike të parashikuara në Kodin Penal, ashtu edhe një kategori të përcaktuar qartë funksionarësh të lartë publikë. Ky kuadër normativ specifikon subjekte që konsiderohen si zyrtarë të nivelit të lartë, duke përfshirë ndër të tjera drejtuesit më të lartë të shtetit, anëtarët e ekzekutivit dhe legjislativit, drejtues të institucioneve të pavarura, si dhe funksionarë të lartë të sistemit të drejtësisë.

Megjithatë, një analizë e kufizuar vetëm në këtë dimension formal rrezikon të mos reflektojë në mënyrë të plotë natyrën reale të fenomenit. Në praktikë, klasifikimi i një çështjeje si korrupsion i nivelit të lartë nuk mund të mbështetet ekskluzivisht dhe vetëm në pozicionin institucional të personit të përfshirë. Statusi i subjektit është një element i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm për të vlerësuar peshën dhe rëndësinë e një rasti në kuptimin substancial.

Kjo sepse, nga njëra anë, mund të ekzistojnë raste që përfshijnë funksionarë të nivelit të lartë, por që karakterizohen nga një ndikim relativisht i kufizuar, si në

¹⁶ Po aty

¹⁷ Po aty

¹⁸ European Western Balkans, “EC Reports on Western Balkans: Fighting Corruption Remains One of the Most Challenging Issues,” 31 tetor 2024, <https://europeanwesternbalkans.com/2024/10/31/ec-reports-on-western-balkans-fighting-corruption-remains-one-of-the-most-challenging-issue/>

aspektin ekonomik, ashtu edhe në atë institucional. Nga ana tjetër, janë pikërisht ato raste ku ndërthuren pozicioni i lartë institucional me një veprimtari korruptive me pasoja të gjera, të cilat përfaqësojnë thelbin e korrupsionit të nivelit të lartë si fenomen me rrezik të shtuar për shtetin e së drejtës.

Në këtë kuadër, analiza e këtij raporti mbështetet në një qasje më të zgjeruar, ku vlerësimi i rasteve ndërtohet mbi kombinimin e statusit të subjektit me peshën e veprës penale dhe implikimet e saj. Konkretisht, përtej identifikimit të funksionarëve të përfshirë, vëmendja përqendrohet në disa elementë kyç që lidhen me gravitetin dhe natyrën e veprës penale, përfshirë ndikimin e saj në interesin publik, dëmin ekonomik dhe financiar, veçanërisht kur lidhet me menaxhimin e fondeve publike, tenderat apo sektorët strategjikë, kompleksitetin e skemës korruptive, përfshirë përdorimin e ndërmjetësve, rrjeteve të organizuara dhe mekanizmave të fshehjes së përfitimeve, ndikimi institucional dhe sistemik, sidomos kur veprimtaria korruptive cënon procese vendimmarrëse, deformon konkurrencën në treg ose krijon kushte për kapje të institucioneve.


Kjo qasje synon të jetë në përputhje me zhvillimet më të fundit ndërkombëtare, të cilat theksojnë se korrupsioni i nivelit të lartë duhet të kuptohet si një fenomen që lidhet jo vetëm me “kush” është i përfshirë, por edhe me “çfarë pasoja prodhon” dhe “sa thellë ndikon” në funksionimin e shtetit dhe ekonomisë.

Në të njëjtën kohë, kjo qasje nuk ka vetëm vlerë analitike, por edhe implikime të drejtpërdrejta për praktikën institucionale. Kuadri kushtetues dhe ligjor në fuqi në Shqipëri i ofron institucioneve të specializuara, një hapësirë të mjaftueshme kompetencash dhe instrumentesh për të prioritarizuar korrupsionin në nivelet më të larta, jo vetëm në aspektin formal të identifikimit të subjekteve, por edhe në drejtim të hetimit të formave më komplekse dhe me ndikim të gjerë të këtij fenomeni. Kjo nënkupton një fokus të shtuar të institucioneve në identifikimin dhe ndjekjen e atyre rasteve që, për nga natyra dhe pasojat, përfaqësojnë forma të avancuara të korrupsionit, duke përfshirë, rastet me ndikim të lartë në politikat publike dhe vendimmarrjen shtetërore; rastet që lidhen me menaxhimin e burimeve të konsiderueshme financiare publike; rastet që përfshijnë mekanizma të ndërlikuar dhe rrjete aktorësh, përfshirë ndërthurjen publik-privat; si dhe rastet që krijojnë rrezik sistemik për integritetin institucional dhe funksionimin e tregut.

Një qasje e tillë synon të kontribuojë në kalimin nga një reagim kryesisht reaktiv ndaj rasteve individuale, drejt një prioritizimi më të qartë dhe më të qëndrueshëm të korrupsionit të nivelit të lartë si fenomen me impakt strategjik. Në këtë mënyrë, synohet që institucionet jo vetëm të zbatojnë ligjin, por edhe ta përdorin atë si një instrument për të maksimizuar efektin parandalues dhe goditës ndaj formave më të rënda të korrupsionit. Në përputhje me këtë logjikë, vlerësimi i paraqitur në këtë raport synon gjithashtu të kontribuojë në një reflektim më të gjerë institucional mbi mënyrën se si kuadri ekzistues mund të përdoret në mënyrë më të synuar për të rritur ndikimin e luftës kundër korrupsionit, duke orientuar vëmendjen drejt atyre rasteve që kanë potencialin më të madh për të cenuar interesin publik dhe shtetin e së drejtës.

Përgjatë vitit 2025, nga 25 vendime ku janë përfshirë subjekte të nivelit të lartë, 17 prej tyre lidhen me vepra penale të korrupsionit. Nga analiza e këtyre çështjeve, evidentohet një dallim thelbësor ndërmjet dimensionit formal të statusit dhe dimensionit substancial të korrupsionit, duke treguar se prania e një subjekti me funksion të lartë publik nuk mund të jetë në vetvete e mjaftueshme për ta klasifikuar një rast si korrupsion i nivelit të lartë.

Grafik 8: Kategorizimi i çështjeve në të cilat përfshihen zyrtarë të nivelit të lartë (2025 vs 2024)



Në mënyrë të përsëritur në të gjitha rastet e analizuara evidentohet se, ndonëse një pjesë e konsiderueshme e çështjeve përfshijnë subjekte si kryetarë bashkish, funksionarë të lartë shtetërorë apo pjesëtarë të sistemit të drejtësisë, vetëm një numër i kufizuar prej tyre arrin pragun substancial të korrupsionit të nivelit të lartë. Kjo lidhet drejtpërdrejt me faktin se ky lloj korrupsioni nuk mund të përcaktohet vetëm nga pozicioni institucional, por nga një kombinim faktorësh që përfshijnë gravitetin ekonomik, kompleksitetin e skemës, dhe mbi të gjitha ndikimin sistematik të veprimtarisë.

“Prania e një zyrtari të nivelit të lartë nuk është në vetvete përcaktuese për ta kategorizuar si korrupsion i nivelit të lartë, i cili kërkon një kombinim të gravitetit ekonomik, kompleksitetit të skemës dhe ndikimit sistematik të veprimtarisë.”

Një nga gjetjet më të rëndësishme është prania e një kategorie të gjerë rastesh që mund të përkufizohen si “korrupsion i nivelit të mesëm me subjekt të lartë”, ku subjekti ka status të lartë formal, por veprimtaria e tij mbetet e kufizuar në nivel lokal, procedural ose episodik. Në këto raste, edhe pse kemi ndërhyrje në procese të rëndësishme si prokurimi publik, planifikimi urban apo administrimi i pronës, ndikimi mbetet i kufizuar në një numër të vogël vendimmarrjesh, pa u shndërruar në një mekanizëm të qëndrueshëm korrupsioni. Këto raste karakterizohen zakonisht nga vlera ekonomike të moderuara ose të ulëta, shpesh të lidhura me tendera lokalë

apo përfitime individuale; kompleksitet mesatar ose i ulët, pa prani të rrjeteve të strukturuar apo ndërmjetëve të shumtë dhe ndikim institucional të kufizuar, i cili nuk shtrihet përtej një rasti apo sektori të veçantë.

Një dimension tjetër i rëndësishëm që del nga analiza është prania e rasteve ku korruptioni nuk materializohet në formën klasike të shkëmbimit financiar, por shfaqet si abuzim me funksionin publik, shpërdorim detyre apo ndërhyrje në procedura administrative. Në këto situata, edhe pse kemi shkelje serioze të ligjshmërisë dhe cenim të integritetit institucional, mungesa e një elementi të qartë të përfitimit financiar apo e një skeme të organizuar e mban rastin jashtë kategorisë së korruptsionit të nivelit të lartë. Këto raste tregojnë qartë se jo çdo devijim nga ligji në nivele të larta përbën korruptsion në kuptimin substancial, por shpesh mbetet në nivelin e abuzimit administrativ të zgjeruar.

“Shumica e rasteve që përfshijnë zyrtarë të nivelit të lartë mbeten të kufizuara në forma episodike dhe procedurale, pa u shndërruar në mekanizma të qëndrueshëm korruptsionit me ndikim sistematik.”

Në të njëjtën kohë, analiza eidenton një kategori të veçantë rastesh që mund të përkufizohen si korruptsion me ndikim sistematik jo-ekonomik, veçanërisht në kontekstin e proceseve demokratike apo të drejtësisë. Raste të tilla, edhe pse nuk përfshijnë shuma të mëdha financiare, kanë potencial për të cenuar drejtpërdrejt funksionimin e shtetit të së drejtës, duke ndikuar në integritetin e zgjedhjeve apo vendimmarrjen gjyqësore. Këto raste tregojnë se dimensionin i korruptsionit të nivelit të lartë nuk është vetëm ekonomik, por mund të jetë edhe politik apo institucional, megjithëse në mungesë të kompleksitetit dhe shkallës së gjerë, ato shpesh mbeten në kategori ndërmjetëse (borderline).

Një tjetër gjetje me rëndësi të veçantë është identifikimi i rasteve të korruptsionit të integritetit (integrity-based corruption), ku sjellja e paligjshme konsiston në fshehjen e pasurisë, deklarime të rreme apo mungesë transparence financiare. Në këto raste, nuk kemi një marrëdhënie të drejtpërdrejtë korruptsionit (quid pro quo), por një akumulim të përfitimeve të paligjshme në kohë dhe një cenim të vazhdueshëm të mekanizmave të kontrollit. Kjo formë korruptsionit është veçanërisht e rëndësishme në nivelet e larta të drejtësisë, pasi minon besimin publik dhe krijon kushte për korruptsion të fshehur, duke përfaqësuar një formë të avancuar, por jo klasike, të korruptsionit të nivelit të lartë.

“Korruptsioni i nivelit të lartë materializohet vetëm në ato raste ku ndërthurja publik-privat, kompleksiteti organizativ dhe ndikimi në treg apo politika publike krijojnë një mekanizëm të integruar dhe afatgjatë për përfitim.”

Në kontrast me këto kategori, analiza eidenton një numër të kufizuar rastesh që përbëjnë dhe përfshijnë plotësisht kriteret e korruptsionit të nivelit të lartë në

kuptimin substancial.¹⁹ Këto raste karakterizohen nga një kombinim i elementeve të mëposhtme: ndërthurje e aktorëve publikë dhe privatë, shpesh me rol aktiv të sektorit privat në nxitjen dhe strukturimin e skemës; përfshirje në kontrata apo procese me vlerë të lartë ekonomike, si koncesione apo PPP, që krijojnë rrjedhë të vazhdueshme përfitimi; kompleksitet i lartë organizativ, me shumë faza, ndërmjetës dhe mekanizma të fshehjes dhe mbi të gjitha, ndikim sistematik, që prek tregun, konkurrencën dhe politikat publike në mënyrë të qëndrueshme.

Në këto raste, korrupsioni nuk është një episod i izoluar, por një mekanizëm i integruar në vendimmarrjen publike, i cili prodhon efekte afatgjata dhe të shumëfishta. Veçanërisht të rëndësishme janë rastet që lidhen me kontrata afatgjata publike, ku përfitimi nuk është një pagesë e vetme, por një rrjedhë e vazhdueshme ekonomike e ndërtuar mbi një vendim të deformuar. Një dimension tjetër kritik që del nga analiza është roli i kompleksitetit të skemës si faktor përcaktues për klasifikimin. Rastet që përfshijnë rrjete ndërmjetësish, struktura jo-lineare dhe përdorim të ndikimit informal tregojnë një nivel më të avancuar të korrupsionit, duke e bërë atë më të vështirë për t'u zbuluar dhe më të rrezikshëm për sistemin. Këto forma të korrupsionit shpesh nuk janë të dukshme në mënyrë të drejtpërdrejtë, por operojnë përmes mekanizmave të ndërmjetësuar dhe marrëdhënieve informale.

Në tërësi, një nga konkluzionet kryesore të këtij kriteri është se korrupsioni i nivelit të lartë duhet të kuptohet si një fenomen që kërkon një prag të caktuar intensiteti dhe ndikimi, i cili përfshin: jo vetëm status të lartë të subjektit, por edhe gravitet të konsiderueshëm ekonomik, strukturë të organizuar dhe komplekse, dhe ndikim sistematik në institucionet dhe tregun. Mungesa e njërit prej këtyre elementeve e ul ndjeshëm nivelin e rastit, duke e zhvendosur atë drejt kategorive të ndërmjetme si korrupsion administrativ, korrupsion operativ apo shkelje e integritetit.

Analiza e këtij kriteri tregon se pjesa më e madhe e raste në të cilat janë përfshijë zyrtarë të nivelit të lartë nuk arrijnë të materializohen si korrupsion i nivelit të lartë në kuptimin substancial, duke reflektuar një realitet ku statusi formal nuk përkthehet automatikisht në ndikim sistematik. Në të njëjtën kohë, rastet që e kalojnë këtë prag janë relativisht të pakta, por me impakt shumë më të thellë dhe më të rrezikshëm, pasi ato kanë potencialin të deformojnë jo vetëm vendimmarrjen individuale, por vetë funksionimin e sistemit publik dhe të ekonomisë.

¹⁹ Rasti i “Inceneratorit të Tiranës” i referohet një prej çështjeve më të rëndësishme të hetuara në fushën e korrupsionit, që lidhet me procedurat e koncesionit për ndërtimin dhe menaxhimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve në Tiranë.

1.2. Kompleksiteti i skemave korruptive

Analiza e çështjeve të korrupsionit nxjerr në pah një tablo të diferencuar të kompleksitetit të skemave korruptive, ku bashkëjetojnë forma relativisht të thjeshta dhe lineare me skema më të strukturuar, të karakterizuara nga ndërveprim ndërmjet aktorëve dhe përdorimi i mekanizmave institucionale si instrument për realizimin e përfitimit. Në tërësi, korrupsioni nuk paraqitet si një fenomen homogjen, por si një spektër modelesh që variojnë nga ndërveprime individuale deri tek struktura më të artikuluar që përfshijnë koordinim, ndërmjetësim dhe ndërthurje me procese administrative apo vendimmarrëse.

“Korrupsioni nuk paraqitet si një fenomen homogjen, por si një spektër modelesh që variojnë nga ndërveprime individuale deri tek struktura të artikuluar që ndërthuren me mekanizmat institucionale.”

Një nga gjetjet më domethënëse që del nga kjo analizë është dominimi i skemave me kompleksitet të ulët dhe mesatar. Në shumicën e rasteve, korrupsioni nuk kërkon ndërtimin e strukturave të qëndrueshme apo rrjeteve të mirëorganizuar, por mbështetet në marrëdhënie direkte ose gjysmë-direkte ndërmjet palëve, ku një aktor kryesor luan rol dominues. Këto skema karakterizohen nga një logjikë funksionimi relativisht lineare, ku përfitimi realizohet përmes aksesit individual, besimit personal dhe manipulimit të perceptimit të ndikimit mbi institucionet publike. Në një numër të konsiderueshëm rastesh, ndikimi mbi institucionet mbetet në nivel pretendimi dhe nuk materializohet në një ndërhyrje reale të strukturave administrative, çka tregon se korrupsioni shpesh operon si një marrëdhënie oportuniste dhe jo si një mekanizëm i konsoliduar institucional.

Në këtë kuadër, bie në sy edhe mungesa pothuajse e plotë e mekanizmave të avancuar financiarë apo juridikë. Edhe në rastet ku konstatohet një nivel më i lartë organizimi, nuk evidentohet përdorim sistematik i kompanive fasadë, kontratave fiktive apo strukturave komplekse transaksionesh. Kjo e bën korrupsionin të zhvillohet kryesisht në forma të drejtpërdrejta, të gjurmueshme dhe të kufizuara në kompleksitetin e tyre financiar, duke e zhvendosur fokusin e analizës drejt dimensionit organizativ dhe institucional të fenomenit.

“Në shumicën e rasteve të analizuara, veprimtaria korruptive operon përmes strukturave funksionale të thjeshta, duke u mbështetur më shumë në marrëdhënie direkte dhe akses individual sesa në organizim të avancuar.”

Megjithatë, analiza tregon edhe një shtresë më të avancuar të kompleksitetit, e cila lidhet kryesisht me rolin e ndërmjetësimit dhe ndërtimin e asaj që mund të përkufizohet si “zinxhir ndikimi”. Në këto raste, korrupsioni nuk mbetet në nivelin e një marrëveshjeje të thjeshtë dypalëshe, por përfshin disa aktorë që ndërveprojnë

në mënyrë të ndërlidhur për realizimin e përfitimit. Prania e ndërmjetësve, ndarja funksionale e roleve dhe koordinimi në kohë krijojnë një strukturë më të artikuluar, ku veprimet zhvillohen në disa faza dhe përfitimi shpërndahet ndërmjet disa hallkave. Ky tip korrupsioni reflekton një nivel organizimi mbi mesataren, por pa arritur të konsolidohet në struktura kriminale të mirëfillta, duke mbetur në një fazë ndërmjetëse midis spontanitetit dhe organizimit.

Një dimension veçanërisht i rëndësishëm i kompleksitetit lidhet me përdorimin e procedurave formalisht të ligjshme si mbulesë për veprimtarinë korruptive. Në këto raste, kompleksiteti nuk buron nga fshehja e përfitimeve apo nga ndërlikimi i rrjedhave financiare, por nga aftësia për të instrumentalizuar mekanizmat institucionalë ekzistues. Procedurat e prokurimit publik, proceset administrative apo dokumentacioni zyrtar përdoren për të legjitimuar një rezultat të paravendosur, duke e maskuar ndërhyrjen si vendimmarrje normale. Kjo e zhvendos korrupsionin nga një akt i dukshëm në një proces të integruar në funksionimin formal të administratës, duke rritur ndjeshëm vështirësinë e identifikimit dhe provimit të tij.

Në këtë drejtim, një rol kyç në përcaktimin e nivelit të kompleksitetit luan shkalla e ndërthurjes së skemës me strukturat institucionale. Analiza tregon se ekziston një avancim i dukshëm nga raste ku institucionet përdoren vetëm si referencë për ndikim të pretenduar, drejt rasteve ku ato shndërrohen në instrument aktiv për realizimin e përfitimit. Në nivelin më të ulët, institucionet janë thjesht objekt retorik i ndikimit, pa përfshirje reale. Në një nivel më të avancuar, ato përdoren në mënyrë funksionale për të prodhuar rezultate konkrete në raste specifike. Ndërsa në rastet më komplekse, struktura të tëra institucionale përfshihen në mënyrë të ndërlidhur, duke krijuar një mekanizëm ku korrupsioni integrohet në vetë procesin vendimmarrës.

“Kompleksiteti i lartë materializohet atëherë kur korrupsioni kalon nga ndërveprime individuale në procese të ndërthurura institucionale që prodhojnë përfitime të strukturuar dhe pasoja ekonomike konkrete.”

Rastet me kompleksitet të lartë, megjithëse më të rralla, paraqesin një dimension cilësisht të ndryshëm të fenomenit. Në këto raste, skemat janë shumëfazore, zhvillohen në kohë dhe përfshijnë ndërveprim ndërinstitutional, shpesh të kombinuar me teknika të ndryshme si falsifikimi i dokumenteve, shpërdorimi i detyrës dhe fshehja e përfitimeve. Ajo që i dallon këto skema është fakti se ato nuk ndalen në nivelin e manipulimit administrativ, por prodhojnë pasoja ekonomike konkrete, duke kaluar nga ndërhyrja në procedura drejt përfitimit pasuror dhe integritetit të tij në ekonomi. Këtu korrupsioni shfaqet si një proces i plotë, që fillon në administratë, legjitimohet përmes mekanizmave institucionalë dhe përfundon në treg, duke krijuar rrezik real për deformimin e konkurrencës dhe infiltrimin e interesave korruptive në ekonomi.

Megjithatë, edhe në këto raste më të avancuara, vihet re një mungesë e theksuar e sofistikimit financiar dhe juridik në kuptimin klasik të kriminit të organizuar. Nuk evidentohet një përdorim i strukturuar i mekanizmave ndërkombëtarë, rrjeteve të

pastrimit të parave apo instrumenteve të komplikuar financiare. Kjo sugjeron se kompleksiteti i korrupsionit në këto çështje mbetet kryesisht i natyrës administrative dhe organizative, i lidhur me mënyrën se si përdoren dhe deformohen mekanizmat institucionalë, dhe jo me ndërtimin e arkitekturave të avancuara për fshehjen e përfitimeve.

Në tërësi, analiza e kompleksitetit të skemave korruptive tregon se kemi të bëjmë me një fenomen që në pjesën më të madhe të tij mbetet i përqendruar në forma të ndërmjetme organizimi, ku korrupsioni funksionon përmes kombinimit të ndërveprimeve personale, ndërmjetësimit dhe përdorimit të procedurave administrative. Kompleksiteti rritet në mënyrë progresive në varësi të shkallës së koordinimit, ndërthurjes me institucionet dhe shtrirjes në kohë të veprimeve, ndërsa rastet më të avancuara dallohen për aftësinë për të prodhuar pasoja ekonomike konkrete. Në këtë kuptim, korrupsioni i evidentuar në këto vendime paraqitet më shumë si një fenomen i integruar në praktikën e përditshme të administratës dhe vendimmarrjes publike, sesa si një aktivitet i zhvilluar përmes strukturave kriminale të sofistikuara në kuptimin klasik.

1.3. Volumi i flukseve/transaksioneve financiare

Volumi i flukseve dhe transaksioneve financiare në çështjet e korrupsionit evidenton një dimension thelbësor për të kuptuar natyrën reale të fenomenit, duke treguar se korrupsioni nuk duhet parë vetëm përmes shumave monetare të përfshira, por përmes mënyrës se si këto flukse strukturohen, kanalizohen dhe përdoren në funksion të ndikimit të paligjshëm. Në këtë kuptim, volumi financiar nuk është thjesht një tregues sasior, por një indikator kompleks që reflekton nivelin e organizimit, qëllimin dhe impaktin e aktivitetit korruptiv.

Në tërësi, analiza nxjerr në pah një variacion të gjerë të konfigurimeve financiare, që shtrihen nga forma të thjeshta me volum të kufizuar, deri tek struktura shumë-shtresore me impakt të gjerë ekonomik dhe buxhetor. Ky diversitet tregon se korrupsioni nuk është homogjen në dimensionin e tij financiar, por përshtatet në varësi të kontekstit institucional dhe objektivit të synuar.

“Volumi financiar në korrupsion nuk është thjesht tregues i shumës, por një indikator i mënyrës se si përfitimi strukturohet, kanalizohet dhe integrohet në vendimmarrje.”

Në një pjesë të konsiderueshme të rasteve, evidentohet një tipologji që mund të përkufizohet si korrupsion funksional me volum të ulët ose mesatar financiar. Në këto raste, flukset financiare janë relativisht të kufizuara në vlerë dhe zakonisht realizohen përmes transaksioneve direkte ndërmjet palëve. Paraja përdoret si një instrument i drejtpërdrejtë për të ndikuar një vendimmarrje konkrete, pa kërkuar ndërtimin e strukturave të ndërlikuara financiare.

Megjithatë, edhe në këto konfigurime të thjeshta, flukset financiare nuk janë gjithmonë të reduktuara në një pagesë të vetme, por shpesh përfshijnë transfertat e përsëritura, ndërveprime të shumëfishta dhe në disa raste përdorimin e ndërmjetësve për realizimin e pagesave. Kjo tregon se edhe kur volumi është i kufizuar, ekziston një logjikë funksionale e organizimit financiar që synon të sigurojë realizimin e përfitimit dhe të reduktojë rrezikun e ekspozimit.

Një tjetër gjetje e rëndësishme lidhet me faktin se në disa raste, dimensionin financiar nuk paraqitet në mënyrë të plotë apo të detajuar në vendim, duke mbetur implicit dhe jo i dokumentuar plotësisht. Në këto situata, pesha e analizës nuk qëndron te madhësia e shumës, por te ekzistenca e përfitimit financiar në vetvete si element i veprës penale. Kjo sugjeron se në praktikë, korrupsioni nuk është gjithmonë i ndërtuar mbi transaksione të gjurmueshme dhe të strukturuar, por mund të zhvillohet edhe në forma më pak të dokumentuara financiarisht, duke e bërë më të vështirë provueshmërinë e tij.

“Në shumicën e rasteve të shqyrtuara, korrupsioni operon përmes flukseve financiare të kufizuara dhe të drejtpërdrejta, ku pagesa shërben si instrument i menjëhershëm për të ndikuar një vendimmarrje specifike.”

Në një nivel më të avancuar, identifikohen raste ku flukset financiare marrin një formë hibride, duke kombinuar elemente direkte dhe indirekte të përfitimit. Në këto situata, përfitimi nuk kufizohet vetëm në pagesa monetare, por përfshin edhe avantazhe procedurale, favorizime apo përfitime ekonomike të tërthorta. Kjo strukturë hibride e zgjeron konceptin e “fluksit financiar”, duke treguar se ndikimi ekonomik i korrupsionit shpesh shkon përtej transfertave të drejtpërdrejta dhe materializohet në forma më të gjera të përfitimit.

Një nga gjetjet më domethënëse të këtij kriteri është prania e pak rasteve ku përfshihen transaksione me volum shumë të lartë financiar, të lidhura me projekte publike, kontrata koncesionare dhe struktura të financimit publik-privat. Në këto raste, korrupsioni nuk operon më përmes pagesave individuale, por përmes manipulimit të proceseve që gjenerojnë flukse financiare shumë të mëdha në kohë.

“Në rastet më komplekse, pagesa korruptive nuk përfaqëson përfitimin në vetvete, por një kosto hyrjeje për të siguruar akses në flukse financiare shumë më të mëdha dhe të qëndrueshme në kohë.”

Këto raste karakterizohen nga flukse shumë-shtresore, që përfshijnë investime fillestare, operim afatgjatë, subvencione publike dhe rrjedha të vazhdueshme të të ardhurave. Korrupsioni në këtë nivel nuk është më një akt i izoluar financiar, por një mekanizëm që ndikon në arkitekturën e gjithë projektit, duke krijuar përfitime të vazhdueshme dhe të strukturuara. Në këtë kuptim, volumi financiar nuk është vetëm i madh në vlerë absolute, por edhe i shpërndarë në kohë dhe i integruar në funksionimin e projektit.

Një dimension tjetër kritik që del nga analiza është mënyra se si flukset financiare realizohen përmes kanaleve formale dhe të ligjshme në dukje. Në shumë raste, transaksionet kryhen përmes procedurave të prokurimit publik, kontratave zyrtare dhe mekanizmave institucionalë, duke krijuar një “maskim ligjor” të aktivitetit korruptiv.

Në këto situata, problemi nuk qëndron te vetë fluksi financiar, por te mënyra se si ai gjenerohet, pra në fazën e përzgjedhjes së përfituesit apo manipulimit të procedurës. Kjo e zhvendos analizën nga transaksioni në vetvete tek procesi që e prodhon atë, duke treguar se korupsioni mund të integrohet në mekanizma plotësisht formalë dhe të funksionojë brenda tyre pa qenë i dukshëm në sipërfaqe.

“Korrupsioni financiar shpesh maskohet përmes mekanizmave formalisht të ligjshëm, duke e zhvendosur problemin nga transaksioni tek procesi që e gjeneron atë.”

Një tjetër element i rëndësishëm është niveli i sofistikimit financiar, i cili në shumicën e rasteve rezulton relativisht i ulët ose mesatar. Në këto raste, nuk evidentohet përdorim sistematik i mekanizmave kompleksë të pastrimit të parave apo strukturave të avancuara financiare. Në vend të kësaj, korrupsioni mbështetet kryesisht në ndërveprime direkte, kanale informale apo procedura standarde të deformatuara.

Megjithatë, në rastet me volum të lartë financiar, sofistikimi nuk qëndron domosdoshmërisht në teknikën financiare, por në përdorimin e instrumenteve ligjore dhe ekonomike për të realizuar përfitimin. Kjo formë e “sofistikimit procedural” është veçanërisht e rëndësishme, pasi e bën korrupsionin më të vështirë për t’u identifikuar dhe për t’u adresuar, duke qenë se ai operon brenda strukturave legjitime të sistemit.

Një gjetje tjetër thelbësore lidhet me raportin midis shumës së përfshirë dhe përfitimit të synuar. Në rastet e korrupsionit klasik, ekziston një lidhje relativisht e drejtpërdrejtë midis pagesës dhe vendimmarrjes. Por në rastet më komplekse, përfitimi nuk është më një shumë e izoluar, por akses në burime financiare shumë më të mëdha, si kontrata publike apo projekte afatgjata.

Kjo krijon një model të veprimtarisë korruptive, ku pagesa korruptive (nëse ekziston) është vetëm një “kosto hyrjeje” për të siguruar një përfitim shumë më të madh në vijim. Në këtë kuptim, analiza e volumit financiar duhet të marrë parasysh jo vetëm fluksin e drejtpërdrejtë, por edhe vlerën ekonomike të mundësisë së krijuar përmes ndërhyrjes korruptive.

Analiza e këtij kriteri tregon se flukset financiare në rastet e korrupsionit nuk mund të reduktohen në madhësinë e shumave, por duhet të kuptohen si pjesë e një mekanizmi më të gjerë që përfshin strukturimin e përfitimit, përdorimin e kanaleve formale dhe informale, dhe ndërthurjen me proceset institucionale. Rastet variojnë nga forma të thjeshta me volum të kufizuar dhe sofistikim të ulët, deri tek struktura komplekse me impakt të gjerë ekonomik dhe buxhetor. Në të gjitha rastet, megjithatë, fluksi financiar mbetet elementi që materializon ndikimin korruptiv, duke e bërë atë të matshëm, të provueshëm dhe me pasoja konkrete për funksionimin e tregut dhe administratës publike.

1.4. Kohëzgjatja dhe vazhdimësia e aktivitetit korruptiv

Analiza e kohëzgjatjes dhe vazhdimësisë së aktivitetit korruptiv evidenton një dimension thelbësor të fenomenit që shkon përtej aspektit të thjeshtë kohor dhe lidhet ngushtë me mënyrën se si korrupsioni zhvillohet, konsolidohet dhe mbijeton në raport me mekanizmat institucionale të kontrollit. Në këtë kuptim, kohëzgjatja nuk përfaqëson vetëm një tregues kronologjik, por një indikator të drejtpërdrejtë të kapacitetit të sistemit për të identifikuar, ndërprerë dhe parandaluar devijimet në kohë.

Në tërësi, analiza e çështjeve tregon se aktiviteti korruptiv nuk paraqitet në një formë të vetme lineare, por shfaqet në tre profile kryesore: (i) raste episodike me kohëzgjatje të shkurtër, (ii) raste me vazhdimësi funksionale në kohë të kufizuar dhe (iii) raste me kohëzgjatje të gjatë që lidhen me procese institucionale të zgjatura. Ky diferencim është thelbësor, pasi tregon se korrupsioni nuk duhet kuptuar vetëm si një akt i izoluar, por si një fenomen që shpesh zhvillohet në kohë dhe në faza të ndërlydhura.

“Kohëzgjatja e aktivitetit korruptiv nuk është thjesht tregues kohor, por një indikator i drejtpërdrejtë i kapacitetit të sistemit për të identifikuar dhe ndërprerë devijimet në kohë.”

Në një pjesë të konsiderueshme të rasteve, korrupsioni paraqitet në formë episodike, i përqendruar në një interval kohor relativisht të shkurtër, por që përmban një cikël të plotë veprimi. Edhe kur kohëzgjatja është e kufizuar, këto raste nuk reduktohen në një moment të vetëm, por përfshijnë një fazë paraprake komunikimi dhe dakordësie, e ndjekur nga realizimi konkret i përfitimit. Kjo tregon se edhe korrupsioni “i shpejtë” ka një strukturë minimale organizimi dhe nuk është thjesht spontan, por përfshin një sekuencë veprimesh që e bëjnë atë funksional dhe efektiv.

Megjithatë, rëndësia e këtyre rasteve nuk qëndron vetëm në kohëzgjatjen e tyre, por në intensitetin dhe ndikimin që prodhojnë. Në disa raste specifike, edhe një aktivitet i kufizuar në kohë mund të ketë pasoja të thella institucionale, sidomos kur prek procese sensitive si ato zgjedhore apo vendimmarrjen publike. Në këto situata, impakti i korrupsionit nuk matet në vite, por në efektet që prodhon mbi integritetin institucional dhe besimin publik.

Një kategori tjetër e rëndësishme e rasteve janë ato që paraqesin një vazhdimësi funksionale në kohë, ku aktiviteti korruptiv nuk është i kufizuar në një episod të vetëm, por zhvillohet përmes një serie veprimesh të ndërlydhura. Këto raste karakterizohen nga një strukturë më e qëndrueshme, ku ekziston përsëritje, koordinim dhe një nivel i caktuar konsolidimi operacional. Aktiviteti nuk është thjesht i shtrirë në kohë, por zhvillohet në disa etapa që ndërtojnë njëra-tjetrën, duke krijuar një vazhdimësi reale dhe jo vetëm procedurale.

Në këtë kontekst, vazhdimësia shfaqet si një faktor që rrit ndjeshëm rrezikshmërinë e fenomenit, pasi krijon kushte për ndërtimin e marrëdhënieve të qëndrueshme ndërmjet aktorëve. Koha në dispozicion lejon rritjen e besimit reciprok, uljen e perceptimit të riskut dhe strukturimin më të mirë të veprimeve, duke e bërë aktivitetin korruptiv më të qëndrueshëm dhe më të vështirë për t'u identifikuar. Kjo dinamikë tregon se korrupsioni nuk zhvillohet vetëm për shkak të mundësive individuale, por edhe për shkak të një mjedisi institucional që lejon vazhdimësinë e tij.

Një nga gjetjet më të rëndësishme të këtij kriteri është fakti se në shumë raste, kohëzgjatja dhe vazhdimësia nuk lidhen domosdoshmërisht me ekzistencën e një skeme të strukturuar korruptive, por me zhvillimin e një procesi vendimmarrës që në vetvete krijon hapësira për devijim. Në këto raste, korrupsioni nuk paraqitet si një praktikë e përsëritur në mënyrë të drejtpërdrejtë, por si një zinxhir vendimesh dhe veprimesh të ndërlidhura që, në tërësi, prodhojnë një rezultat problematik. Kjo formë është veçanërisht e rëndësishme, pasi e zhvendos analizën nga individi tek procesi dhe nga veprimi i izoluar tek funksionimi i sistemit.

“Korrupsioni në shumicën e rasteve nuk shfaqet si një akt i izoluar, por si një proces i ndërtuar në kohë përmes veprimesh të ndërlidhura që prodhojnë një rezultat të vetëm.”

Rastet me kohëzgjatje të gjatë paraqesin një dimension edhe më kompleks të fenomenit, pasi ato shpesh lidhen me procese institucionale që zhvillohen për vite me radhë. Në këto situata, mungesa e ndërhyrjes së hershme dhe e mekanizmave efektivë të kontrollit bëhet elementi kyç që lejon vazhdimësinë e aktivitetit. Fakti që një proces mund të zhvillohet për një periudhë të gjatë kohore pa u ndërprerë sugjeron jo vetëm dështim në identifikimin e problematikave, por edhe një fragmentim të kontrollit institucional, ku ndërhyrjet vijnë vonë dhe në mënyrë reaktive.

Një pasojë e drejtpërdrejtë e kësaj dinamike është ajo që mund të përkufizohet si “normalizimi i devijimit”. Kur një aktivitet zhvillohet përmes procedurave formalisht të ligjshme për një periudhë të gjatë kohore, ekziston rreziku që devijimet të mos perceptohen më si të tilla dhe që sistemi të absorbojë gradualisht praktika problematike. Në këtë kuptim, kohëzgjatja nuk është vetëm tregues i mungesës së kontrollit, por edhe faktor që kontribuon në konsolidimin e korrupsionit si pjesë e funksionimit normal të proceseve.

Një element tjetër thelbësor që del nga analiza është lidhja e drejtpërdrejtë midis kohëzgjatjes dhe dobësive në mekanizmat e monitorimit dhe mbikëqyrjes. Në mënyrë të përsëritur, rastet tregojnë mungesë të identifikimit të hershëm të sinjaleve, mungesë të ndërhyrjeve parandaluese dhe një nivel të ulët koordinimi ndërinstitutional. Aktiviteti korruptiv zhvillohet në disa etapa pa u ndërprerë, çka tregon se kontrolli është ose i fragmentuar, ose jo funksional në praktikë.

“Vazhdimësia e aktivitetit korruptiv reflekton më pak aftësinë e aktorëve për të vepruar dhe më shumë hapësirën që sistemi u krijon për të vazhduar në kohë.”

Në këtë kontekst, kohëzgjatja dhe vazhdimësia shfaqen si indikatorë të drejtpërdrejtë të “hapësirës funksionale” që ekziston brenda sistemit për zhvillimin e korrupsionit. Sa më e gjatë kjo hapësirë dhe sa më e vazhdueshme kjo aktivitet, aq më shumë tregon për një mjedis institucional që nuk reagon në mënyrë të menjëhershme ndaj devijimeve dhe që lejon konsolidimin gradual të praktikave korruptive.

Gjetjet që dalin nga analiza e këtij kriteri tregojnë se korrupsioni në këto çështje nuk është vetëm një fenomen i lidhur me momentin e kryerjes së veprës, por një proces që zhvillohet në kohë dhe në ndërveprim me institucionet. Rastet variojnë nga episode të shkurtra me intensitet të lartë, deri tek procese të zgjatura që reflektojnë dobësi strukturore në kontroll dhe mbikëqyrje. Vazhdimësia rrit rrezikun për konsolidimin e marrëdhënieve korruptive, ndërsa kohëzgjatja e gjatë evidencon mungesën e ndërhyrjes së hershme dhe normalizimin gradual të devijimeve. Në këtë kuptim, ky kriter nxjerr në pah një dimension kritik të fenomenit ku korrupsioni nuk mbijeton vetëm për shkak të aktorëve të përfshirë, por për shkak të hapësirës që i krijohet nga vetë sistemi për të vazhduar në kohë.

1.5. Roli i aktorëve privatë dhe ndërmjetësve në skemën korruptive

Në lidhje me rolin e aktorëve privatë dhe ndërmjetësve në çështjet e korrupsionit paraqitet një dimension thelbësor i funksionimit të skemave korruptive, duke evidentuar se korrupsioni rrallëherë mbetet një marrëdhënie e thjeshtë dypalëshe ndërmjet një zyrtari publik dhe një përfituesi, por zhvillohet përmes një ndërveprimi më të gjerë që përfshin aktorë të ndryshëm nga sektori privat, individë me rol ndërmjetësues dhe, në disa raste, struktura të organizuara që mundësojnë realizimin dhe maskimin e përfitimit.

“Korrupsioni rrallëherë mbetet një marrëdhënie dypalëshe, por zhvillohet si një proces ndërveprues që përfshin aktorë privatë dhe ndërmjetës në funksione të ndryshme.”

Në një pjesë të konsiderueshme të rasteve, aktorët privatë shfaqen si iniciatorë ose përfitues të drejtpërdrejtë të veprimtarisë korruptive, duke kërkuar avantazhe në raport me administratën publike. Këto përfshijnë situata ku individë apo subjekte ekonomike synojnë të përfitojnë nga akses i privilegjuar në vendimmarrje, shmangie e detyrimeve ligjore, apo përfitime në procese të caktuara administrative. Në këto raste, ndërveprimi publik-privat mbetet relativisht i drejtpërdrejtë dhe funksionon mbi bazën e një marrëveshjeje të qartë ndërmjet palëve, pa ndërmjetësim të zhvilluar apo strukturim kompleks.

Megjithatë, një gjetje e rëndësishme që del nga analiza është se në një numër të konsiderueshëm rastesh, marrëdhënia nuk zhvillohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, por ndërmjetësohet nga aktorë të tretë që luajnë rol kyç në realizimin e skemës. Këta ndërmjetës shfaqen si hallkë lidhëse ndërmjet sektorit privat dhe zyrtarëve publikë, duke lehtësuar komunikimin, negociimin dhe në disa raste edhe transferimin e përfitimeve. Prania e tyre rrit ndjeshëm kompleksitetin e skemës, pasi krijon distancë midis palëve kryesore dhe vështirëson identifikimin e lidhjes direkte ndërmjet kërkesës dhe vendimmarrjes.

Roli i ndërmjetësve nuk është homogjen, por varion nga funksione relativisht pasive, si përcjellja e mesazheve apo krijimi i kontaktit fillestar, deri tek role më aktive që përfshijnë negociimin e kushteve, koordinimin e veprimeve dhe shpërndarjen e përfitimeve. Në disa raste, ndërmjetësit shfaqen si figura kyçe që mbajnë kontrollin operacional të skemës, duke menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet palëve dhe duke garantuar realizimin e marrëveshjes. Kjo tregon se korrupsioni nuk është thjesht rezultat i marrëdhënieve personale, por mund të strukturohet përmes aktorëve që specializohen në këtë rol ndërmjetësues.

“Ndërmjetësit shfaqen si hallka kyçe që strukturojnë dhe lehtësojnë korrupsionin, duke krijuar distancë midis palëve dhe duke vështirësuar identifikimin e lidhjes direkte.”

Një dimension veçanërisht i rëndësishëm i këtij kriteri lidhet me faktin se aktorët privatë nuk shfaqen vetëm si përfitues pasivë, por shpesh kontribuojnë në ndërtimin dhe funksionimin e skemës korruptive. Në disa raste, ata ofrojnë burimet financiare, propozojnë zgjidhje për të shmangur kontrollin apo krijojnë mekanizma për të maskuar përfitimin. Kjo e zhvendos rolin e tyre nga një pozicion reaktiv në një rol aktiv dhe strategjik, duke e bërë korrupsionin një proces të bashkëprodhuar ndërmjet sektorit publik dhe atij privat.

Një tjetër gjetje e rëndësishme lidhet me mënyrën se si ndërveprimi publik-privat ndikon në deformimin e proceseve ekonomike dhe administrative. Në rastet ku aktorët privatë arrijnë të ndikojnë vendimmarrjen publike në mënyrë të paligjshme, krijohen avantazhe konkurruese të padrejta që dëmtojnë funksionimin e tregut. Kjo është veçanërisht e dukshme në situata që lidhen me procedura administrative, kontrata publike apo akses në burime, ku ndërhyrja korruptive çon në përzgjedhje të paracaktuara dhe eliminim të konkurrencës reale.

“Sektori privat nuk shfaqet vetëm si përfitues, por si bashkëprodhues i korrupsionit, duke kontribuar në ndërtimin dhe funksionimin e skemave.”

Në këtë kuadër, roli i ndërmjetësve merr një rëndësi të veçantë, pasi ata shpesh veprojnë si mekanizëm që e bën të mundur këtë ndërthurje midis interesave private dhe vendimmarrjes publike. Duke operuar në zona gri ndërmjet formalitetit dhe informalitetit, ndërmjetësit krijojnë një hapësirë ku marrëveshjet korruptive mund të zhvillohen pa ekspozuar drejtpërdrejt palët kryesore. Kjo jo vetëm që rrit vështirësinë e zbulimit, por edhe e bën korrupsionin më të qëndrueshëm dhe më të përsëritshëm.

Një element tjetër i rëndësishëm që del nga analiza është se në shumicën e rasteve, përfshirja e aktorëve privatë dhe ndërmjetësve nuk shoqërohet me përdorimin e strukturave komplekse korporative apo mekanizmave të avancuar financiarë. Edhe pse ndërthurja publik-privat është e pranishme, ajo zhvillohet kryesisht në forma relativisht të drejtpërdrejta dhe të kufizuara në kompleksitetin e tyre organizativ. Kjo sugjeron se korrupsioni operon shpesh përmes rrjeteve informale dhe marrëdhënieve personale, sesa përmes strukturave të formalizuara dhe të sofistikuara.

Megjithatë, kjo nuk e ul rrezikshmërinë e fenomenit. Përkundrazi, fakti që ndërveprimi zhvillohet në mënyrë të integruar me funksionimin normal të proceseve administrative e bën atë më të vështirë për t'u identifikuar dhe për t'u adresuar. Në këtë kuptim, korrupsioni nuk shfaqet si një devijim i jashtëm ndaj sistemit, por si një praktikë që mund të ndërthuret me të dhe të shfrytëzojë mekanizmat ekzistues për qëllime private.

Një dimension kritik i këtij kriteri është edhe rreziku i infiltrimit të korrupsionit në ekonomi. Kur aktorët privatë përfshihen në mënyrë aktive në skema korruptive, krijohet një lidhje e drejtpërdrejtë midis përfitimit të paligjshëm dhe aktivitetit ekonomik. Kjo jo vetëm që dëmton konkurrencën, por edhe krijon kushte për

konsolidimin e praktikave të padrejta në treg, duke favorizuar subjektet që operojnë përmes lidhjeve dhe ndikimit, në vend të atyre që respektojnë rregullat.

Kjo pjesë e analizës që lidhet me rolin e aktorëve privatë dhe ndërmjetësve tregon se korrupsioni paraqitet si një fenomen i ndërtuar mbi ndërveprim, ku sektori privat nuk është thjesht përfitues, por një pjesë integrale e mekanizmit. Ndërmjetësit luajnë një rol kyç në strukturimin dhe funksionimin e skemave, duke krijuar lidhje, duke menaxhuar marrëdhënie dhe duke rritur kompleksitetin operacional të korrupsionit. Ndërkohë, ndërthurja publik-privat prodhon pasoja të drejtpërdrejta në funksionimin e tregut dhe në integritetin e proceseve administrative, duke e bërë këtë kriter një nga elementët më kritikë për të kuptuar dimensionin real të rrezikut që paraqet korrupsioni në ekonomi dhe në institucionet publike.

1.6. Vlera e humbjes/dëmit ekonomik

Analiza e vlerës së humbjes dhe dëmit ekonomik në çështjet e korrupsionit nxjerr në pah një tablo komplekse dhe shumëdimensionale të ndikimit financiar të këtij fenomeni, duke treguar se dëmi ekonomik nuk paraqitet në një formë të vetme apo lineare, por materializohet përmes një spektri të gjerë konfigurimesh që variojnë nga humbje të drejtpërdrejta monetare deri tek pasoja të thella strukturore në funksionimin e institucioneve dhe tregut.

“Dëmi ekonomik në korrupsion nuk kufizohet në humbje monetare të drejtpërdrejta, por materializohet në forma të shumëfishta që ndikojnë në funksionimin e institucioneve dhe tregut.”

Në një nivel të parë analitik, evidentohet qartë prania e një kategorie të gjerë rastesh ku dëmi ekonomik është i drejtpërdrejtë, i matshëm dhe i materializuar përmes transfertave monetare, zakonisht në formën e ryshfetit ose pagesave të paligjshme. Në këto raste, dëmi konsiston në një zhvendosje të menjëhershme të pasurisë nga individ apo subjekti privat drejt funksionarit publik ose ndërmjetësve, duke krijuar një marrëdhënie tipike transaksionale ku përfitimi ekonomik është i lidhur drejtpërdrejt me ushtrimin e ndikimit apo kryerjen e një veprimi administrativ. Këto forma të dëmit janë të karakterizuara nga një lidhje e qartë shkakësore, ku kërkesa për pagesë dhe realizimi i saj përbëjnë elemente të drejtpërdrejta të veprës penale, dhe në shumicën e rasteve shumat janë të identifikueshme, edhe pse shpesh të fragmentuara në disa episode.

Brenda kësaj kategorie, një tipar i rëndësishëm është fragmentimi i dëmit ekonomik, ku pagesat nuk kryhen në një moment të vetëm, por shpërndahen në kohë dhe në forma të ndryshme (transferta bankare, cash, ndërmjetësim përmes personave të tretë). Ky model tregon se edhe në rastet me vlera relativisht të kufizuara, korrupsioni mund të marrë formën e një marrëdhënieje të vazhdueshme financiare, duke krijuar një mekanizëm të qëndrueshëm përfitimi për funksionarin dhe një barrë të përsëritur ekonomike për palën paguese.

“Në shumë raste, dëmi ekonomik nuk qëndron te shuma e paguar, por te deformimi i proceseve që gjenerojnë pasoja më të gjera dhe afatgjata për ekonominë.”

Një dimension tjetër i rëndësishëm që del nga analiza është ekzistenca e rasteve ku dëmi ekonomik është i drejtpërdrejtë, por i strukturuar dhe i shpërndarë ndërmjet disa aktorëve, duke reflektuar një nivel më të avancuar organizimi. Në këto raste, përfitimi financiar nuk përqendrohet tek një individ i vetëm, por ndahet ndërmjet disa pjesëmarrësve (funksionarë, ndërmjetës, profesionistë të lidhur), duke krijuar një mekanizëm të koordinuar të shpërndarjes së përfitimit. Kjo tregon se korrupsioni, në disa konfigurime, tejkalon dimensionin individual dhe merr karakter të strukturuar, duke funksionuar si një rrjet përfitimi ekonomik.

Paralelisht me këto forma të drejtpërdrejta, analiza eidenton një kategori të rëndësishme rastesh ku dëmi ekonomik nuk materializohet përmes një pagese konkrete, por shfaqet në formën e dëmit indirekt, funksional ose strukturor, të lidhur me deformimin e proceseve publike. Këto janë veçanërisht të dukshme në rastet që lidhen me procedurat e prokurimit publik, koncesionet apo vendimmarrjen administrative me ndikim ekonomik të gjerë. Në këto situata, dëmi nuk është një shumë e menjëhershme e humbur, por një devijim i mekanizmave që duhet të garantojnë përdorimin efikas të burimeve publike.

Në këtë kategori, një tipar kyç është mungesa e një vlere të drejtpërdrejtë të kuantifikuar në vendim, edhe pse impakti ekonomik potencial mund të jetë shumë i lartë. Dëmi këtu duhet të kuptohet përmes analizës së pasojave të vendimmarrjes: favorizimi i operatorëve ekonomikë, shtrembërimi i konkurrencës, rreziku për kontrata joefikase dhe përdorimi jo optimal i fondeve publike. Kjo e zhvendos fokusin nga shuma konkrete tek efekti ekonomik i vendimit të deformuar, duke e bërë këtë kategori veçanërisht të rëndësishme për analizën e korrupsionit në nivel sistematik.

“Pagesat korruptive shpesh përfaqësojnë vetëm një kosto të vogël në raport me përfitimet ekonomike që ato mundësojnë, duke krijuar një model disproporcional dhe të rrezikshëm për sistemin.”

Një dimension tjetër i rëndësishëm është prania e më pak rasteve me dëm ekonomik potencial shumë të lartë, sidomos në kontekste që lidhen me projekte ndërtimi, koncesione apo marrëdhënie ekonomike me vlerë të konsiderueshme. Në këto raste, edhe në mungesë të një pagese të drejtpërdrejtë të dokumentuar, vendimmarrja e deformuar krijon mundësi për përfitime ekonomike shumë të mëdha për subjektet private. Kjo formë e dëmit është veçanërisht e rrezikshme, pasi nuk kufizohet në një episod të vetëm, por prodhon efekte afatgjata dhe të shumëfishta në ekonomi.

Një element me rëndësi të veçantë është edhe fenomeni i dëmit të dyfishtë, i identifikuar në disa raste ku korrupsioni ndërthuret me një problem administrativ ekzistues. Në këto situata, individi ose subjekti privat pëson fillimisht një dëm nga një veprim administrativ i gabuar (p.sh. mbifaturim), dhe më pas detyrohet të paguajë ryshfet për të korrigjuar këtë padrejtësi. Kjo krijon një strukturë të dyfishtë dëmi: një dëm fillestar institucional dhe një dëm shtesë korruptiv, duke e rënduar ndjeshëm barrën ekonomike mbi individin.

Analiza gjithashtu eidenton raste ku dëmi ekonomik është i lidhur drejtpërdrejt me transferimin e pasurisë, veçanërisht në kontekstin e ndërhyrjeve në proceset gjyqësore apo administrative që lidhen me të drejta pasurore. Në këto raste, korrupsioni nuk prodhon thjesht një pagesë të paligjshme, por çon në përfitimin e një aktivi konkret (si pasuri e paluajtshme), duke krijuar një dëm ekonomik të menjëhershëm dhe të matshëm për palën tjetër. Ky është një nga format më të qarta dhe më të rënda të dëmit ekonomik, pasi përfshin zhvendosje reale të pasurisë në vlera të konsiderueshme.

Një tjetër dimension kritik që del nga analiza është ekzistenca e rasteve ku dëmi ekonomik është i vështirë për t'u identifikuar dhe kuantifikuar, për shkak të mungesës së transparencës financiare apo natyrës së veprës penale (si mosdeklarimi i pasurisë). Në këto raste, nuk kemi një humbje të drejtpërdrejtë të dokumentuar, por një rrezik të lartë për pasurim të paligjshëm dhe për ndikim të fshehur në vendimmarrje. Dëmi këtu është kryesisht potencial dhe sistemik, pasi lidhet me dobësimin e mekanizmave të kontrollit dhe transparencës në sektorin publik.

“Dëmi ekonomik në korrupsion shtrihet nga individi tek tregu dhe institucionet, duke prodhuar pasoja të ndërthurura që cenojnë konkurrencën dhe besimin publik.”

Në tërësi, një nga gjetjet më të rëndësishme është se dëmi ekonomik në korrupsion nuk është gjithmonë proporcional me shumën e përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në shumë raste, pagesat korruptive janë relativisht të vogla në krahasim me përfitimin ekonomik që ato mundësojnë. Kjo krijon një raport disproporcional midis kostos së korrupsionit dhe përfitimit të tij, duke e bërë fenomenin ekonomikisht “efikas” për autorët dhe veçanërisht të rrezikshëm për sistemin.

Analiza e këtij kriteri tregon se dëmi ekonomik në korrupsion duhet të kuptohet si një fenomen shumëdimensional, që përfshin dëme direkte dhe të matshme, përmes pagesave korruptive; dëme indirekte dhe funksionale, përmes deformimit të proceseve publike; dëme potenciale me impakt të lartë, të lidhura me vendimmarrje strategjike; dëme të strukturuar dhe të shpërndara, në skema të organizuara përfitimi dhe dëme sistemike, që ndikojnë në konkurrencën, tregun dhe besimin në institucionet publike. Kjo shumëllojshmëri formash tregon se korrupsioni nuk është thjesht një fenomen i humbjeve monetare të izoluar, por një mekanizëm që prodhon pasoja ekonomike të thella dhe të ndërthurura, duke prekur njëkohësisht individin, administratën publike dhe funksionimin e përgjithshëm të ekonomisë.

2. Analiza e rasteve të krimit të organizuar

Krimi i organizuar paraqitet si një fenomen i konsoliduar, dinamik dhe me shtrirje të theksuar ndërkuftare, ku progresi i institucioneve të ndjekjes penale bashkëjeton me qëndrueshmërinë e tregjeve kriminale dhe me aftësinë e grupeve kriminale për t'u riorganizuar, për t'u përshtatur dhe për të shfrytëzuar hapësirat e dobësisë institucionale. Në këtë kontekst, tabloja nuk reflekton vetëm praninë e një kriminaliteti të rëndë, por evidenton ekzistencën e një ekosistemi kriminal të ndërthurur, që përfshin trafikimin e narkotikëve, pastrimin e produkteve të veprës penale, trafikimin e qenieve njerëzore, krimin financiar dhe depërtimin në sektorë ekonomikë me risk të lartë. Për rrjedhojë, për të vlerësuar situatën e krimit të organizuar nuk mjaftojnë vetëm tregues sasiore, si numri i operacioneve apo i arrestimeve, por dhe raporti me kapacitetin e vazhdueshëm të rrjeteve kriminale për të ruajtur aktivitetin e tyre, elasticitetin organizativ dhe nivelin e ndikimit në ekonomi dhe institucione. Në këtë kuptim, sfida kryesore qëndron në aftësinë e shtetit për të dobësuar jo vetëm aktivitetin kriminal në vetvete, por edhe bazën ekonomike dhe strukturat organizative që e mbështesin atë në mënyrë të qëndrueshme.

Vlerësimet zyrtare të Bashkimit European për vitin 2025 e vendosin qartë këtë problematikë në qendër të agjendës së sundimit të ligjit. Komisioni European thekson se Shqipëria ka shënuar progres në bashkëpunimin ndërkombëtar kundër krimit të organizuar dhe në zhvillimin e kapaciteteve për hetimet financiare, por njëkohësisht nënvizon se kuadri ligjor për krimin e organizuar mbetet vetëm pjesërisht i përafuar me *acquis*-në e BE-së, se kapacitetet për ta luftuar këtë fenomen duhen përmirësuar më tej, dhe se nevojiten përpjekje shtesë për të rritur efikasitetin e hetimeve, veçanërisht përmes forcimit të analizës kriminale dhe financiare.²⁰ Në të njëjtën linjë, komunikimi i Komisionit për zgjerimin i vitit 2025 thekson se Shqipëria ka bërë përparim në bashkëpunimin aktiv ndërkombëtar kundër krimit të organizuar, por kërkon më shumë rezultate konkrete në hetimin e trafikantëve të drogës, si dhe në identifikimin dhe çmontimin e grupeve kriminale.²¹ Siç evidentohet, problemi nuk qëndron vetëm te ekzistenca e rrjeteve kriminale, por te nevoja për të kaluar nga reagimi penal ndaj episodeve individuale në goditjen sistematike të strukturave kriminale si organizata, si ekonomi dhe si rrjete influence.

Gjithashtu, edhe tregues më të gjerë vijojnë të konfirmojnë se Shqipëria mbetet një vend me ekspozim të konsiderueshëm ndaj riskut të kriminalitetit të organizuar dhe financave të paligjshme. Sipas profilit të Shqipërisë në Global Organized Crime Index 2025, vendi ka ulur disi nivelin e kriminalitetit krahasuar me vitet e mëparshme, por vazhdon të ketë tregje kriminale me rezultat të lartë, veçanërisht në trafikun e kokainës dhe kanabisit, krimet financiare, krimin kibernetik,

²⁰ European Commission, *Albania 2025 Report*, SWD(2025) 750 final (Brussels: European Commission, 4 November 2025), https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en?filename=albania-report-2025.pdf

²¹ European Commission, *2025 Rule of Law Report - Country Chapter on the Rule of Law Situation in Albania*, SWD(2025) 928 final (Brussels: European Commission, 8 July 2025), https://commission.europa.eu/document/download/3732ae59-5ab4-48a6-a3e6-0ef9aa593863_en?filename=2025%20Rule%20of%20Law%20Report%20-%20Country%20Chapter%20Albania.pdf

kontrabandën e migrantëve dhe trafikun e heroinës.²² Po ashtu, platforma analitike e Global Initiative vëren se trafiku i drogës ka qenë qendra kryesore e fitimit për grupet kriminale shqiptare gjatë dekadave të fundit, ndërsa korrupsioni, krimi i jakave të bardha dhe evazioni fiskal mbeten burime të rëndësishme të flukseve financiare të paligjshme. Në të njëjtën kohë, Basel AML Index 2025 paralajmëron në nivel global se progresi kundër pastrimit të parave mbetet i ngadaltë dhe i pabarabartë, ndërsa vetë metodologjia e këtij indeksi e lidh riskun financiar jo vetëm me pastrimin e parave në kuptimin klasik, por edhe me krime paraprirëse si korrupsioni, trafiku i drogës dhe trafikimi i qenieve njerëzore.²³ Për Shqipërinë, kjo është veçanërisht e rëndësishme, sepse tregon se krimi i organizuar nuk duhet kuptuar vetëm si aktivitet dhune apo kontrabande, por edhe si kapacitet për të futur të ardhurat kriminale në ekonomi, për t'i maskuar ato dhe për t'i shndërruar në fuqi ekonomike e sociale.

Nga kjo perspektivë, tipari më i rëndësishëm është karakteri dukshëm transnacional i grupeve kriminale shqiptare. Europol ka vënë në dukje se shumica e rrjeteve kriminale më kërcënuese për Bashkimin Europian veprojnë njëkohësisht brenda dhe jashtë BE-së, dhe se në rrjetet e trafikut të kokainës kombësia shqiptare është ndër më të përfaqësuarat. Ky nuk është thjesht një tregues statistikor, por një element që ndihmon të kuptohet pesha reale e aktorëve kriminalë shqiptarë në zinxhirët europianë të furnizimit, transportit, logjistikës dhe shpërndarjes së drogave të forta. Në këtë kuptim, krimi i organizuar nuk paraqitet më thjesht si fenomen kombëtar me degëzime ndërkombëtare, por si pjesë funksionale e rrjeteve kriminale europiane, me aftësi për të bashkëpunuar me aktorë të tjerë, për të operuar në disa juridiksione dhe për të diversifikuar aktivitetet e veta sipas presionit të zbatimit të ligjit. Kjo e bën problemin jo vetëm më të madh, por edhe më kompleks, sepse kërkon jo vetëm hetim penal, por inteligjencë financiare, shkëmbim të vazhdueshëm informacioni dhe hetime të koordinuara ndërkufitare.

Zhvillimet të ndryshme operative të vitit 2025 e përforcojnë këtë tablo. Gjatë vitit u evidentuan raste të rëndësishme të goditjes së rrjeteve kriminale shqiptare me shtrirje ndërkombëtare, ku bashkëpunimi me Europol dhe me autoritete të shteteve të tjera ishte vendimtar. Mes tyre u përfshinë operacione kundër rrjeteve të përfshira në trafik droge dhe pastrim parash, si edhe goditje ndaj strukturave të lidhura me trafikimin e qenieve njerëzore. Europol raportoi në gusht 2025 për goditjen e një rrjeti kriminal shqiptar aktiv ndërkombëtarisht,²⁴ ndërsa në tetor 2025 raportoi edhe për një rrjet trafikimi njerëzor të goditur në Shqipëri dhe Kolumbi.²⁵

²² Global Initiative Against Transnational Organized Crime, *Global Organized Crime Index 2025: Albania Profile* (Geneva: Global Initiative Against Transnational Organized Crime, 2025), https://ocindex.net/assets/downloads/2025/english/ocindex_profile_albania_2025.pdf

²³ Basel Institute on Governance, *Basel AML Index 2025: 14th Public Edition* (Basel: Basel Institute on Governance, 2025), <https://baselgovernance.org/publications/basel-aml-index-2025>

²⁴ Europol, "Internationally Active Albanian Organised Crime Network Busted – 10 Arrests," 12 August 2025, <https://www.europol.europa.eu/media-press/newsroom/news/internationally-active-albanian-organised-crime-network-busted-10-arrests>

²⁵ Europol, "17 Suspected Human Traffickers Arrested in Albania and Colombia," 3 October 2025, <https://www.europol.europa.eu/media-press/newsroom/news/17-suspected-human-traffickers-arrested-in-albania-and-colombia>

Këto zhvillime tregojnë se profili i krimit të organizuar të lidhur me Shqipërinë mbetet i shumëfishtë: ai nuk kufizohet vetëm te tregu i narkotikëve, por shfaqet edhe në forma të tjera të kriminalitetit të rëndë fitimprurës, të lidhur me shfrytëzim njerëzor, logjistikë transnacionale dhe përdorim të infrastrukturave ndërkufitare. Më e rëndësishmja, këto raste tregojnë se grupet kriminale shqiptare nuk veprojnë më domosdoshmërisht si struktura të mbyllura kombëtare, por si partnerë fleksibël në ekosisteme më të gjera kriminale.²⁶


Po aq e rëndësishme është se, pavarësisht presionit të shtuar institucional, mjedisi i përgjithshëm i rezistencës ndaj krimit të organizuar mbetet i brishtë. Global Organized Crime Index i jep Shqipërisë një rezultat të afërt mes kriminalitetit dhe reziliencës, çka tregon se, edhe pse kapacitetet e shtetit janë përmirësuar, ato ende nuk krijojnë një avantazh të qartë dhe të qëndrueshëm ndaj tregjeve kriminale dhe aktorëve të tyre.²⁷ Vlerësimet shkojnë në të njëjtin drejtim kur kërkojnë forcim të kapaciteteve të zbatimit të ligjit, më shumë eficiencë hetimore dhe më shumë çmontim real të grupeve kriminale. Kjo do të thotë se problemi i Shqipërisë nuk është vetëm ekzistenca e krimit të organizuar, por fakti që rezistenca institucionale ndaj tij nuk është ende mjaftueshëm e fortë për ta tkurrur në mënyrë të dukshme hapësirën e veprimit, të fitimit dhe të infiltrimit të tij. Në terma më të thjeshtë, shteti po arrin më shumë se më parë të reagojë, por ende jo aq sa të ndryshojë në rrethje ekuilibrit e forcës mes ligjshmërisë dhe ekonomisë kriminale.

Vlerësimi i krimit të organizuar në Shqipëri mund të përshkruhet si një kombinim mes presionit më të madh institucional dhe qëndrueshmërisë së lartë të rrjeteve kriminale. Ka elementë të qartë progresi: bashkëpunim më i fortë ndërkombëtar, më shumë vëmendje ndaj hetimeve financiare, më shumë operacione të përbashkëta dhe një fokus më i dukshëm mbi strukturat kriminale me shtrirje ndërkombëtare. Por ka po aq qartë edhe kufijtë e këtij progresi: Shqipëria mbetet e ekspozuar ndaj tregjeve kriminale me fitim të lartë, ndaj pastrimit të parave, ndaj ndërthurjes së krimit me korrupsionin dhe ndaj depërtimit të kapitalit kriminal në ekonomi. Lufta kundër krimit të organizuar ka hyrë në një fazë më të sofistikuar, por ende jo në një fazë ku mund të thuhet se shteti ka fituar epërsi të qëndrueshme ndaj rrjeteve që ushqehen nga transnacionaliteti, fitimet e larta dhe dobësitë e kontrollit institucional.

²⁶ Balkan Insight, “Port-to-Port: How Albanians Conquered the European Cocaine Market,” 9 janar 2026, <https://balkaninsight.com/2026/01/09/port-to-port-how-albanians-conquered-the-european-cocaine-market/bi/>

²⁷ Global Initiative Against Transnational Organized Crime, *Global Organized Crime Index 2025: Albania Profile* (Geneva: Global Initiative Against Transnational Organized Crime, 2025), https://ocindex.net/assets/downloads/2025/english/ocindex_profile_albania_2025.pdf


Grafik 9: Ecuria e çështjeve të krimit të organizuar në Prokurorinë e Posaçme (2025 vs 2024)



Burimi: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK)

Numri i procedimeve të regjistruara për krim të organizuar rezulton më i ulët në vitin 2025, me 74 procedime, krahasuar me 101 procedime në vitin 2024. Në të njëjtën linjë, edhe procedimet e dërguara për gjykim kanë shënuar një rënie të lehtë, nga 21 procedime në vitin 2024 në 18 procedime në vitin 2025. Ndërkohë, numri i të pandehurve në çështjet e krimit të organizuar rezulton më i ulët në vitin 2025, me 185 të pandehur, kundrejt 263 në vitin 2024. Në të kundërt, numri i të pandehurve në çështjet e dërguara për gjykim paraqet rritje, duke kaluar nga 134 në vitin 2024 në 183 në vitin 2025. Sa i përket të pandehurve të dënuar për krim të organizuar, të dhënat paraqesin një nivel pothuajse të pandryshuar ndërmjet dy viteve, me 89 të dënuar në vitin 2025 dhe 88 në vitin 2024. Në tërësi, të dhënat tregojnë një ulje të volumit të procedimeve dhe të personave të përfshirë në fazën e hetimit, ndërkohë që numri i të pandehurve të dërguar për gjykim dhe i atyre të dënuar mbetet në nivele të qëndrueshme ose në rritje krahasuar me vitin pararendës.

Grafik 10: Ecuria e çështjeve të krimit të organizuar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë (2025 vs 2024)




Burimi: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Ndërkohë, në vitin 2025 në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë, janë regjistruar 32 çështje të reja për krim të organizuar, krahasuar me 39 çështje në vitin 2024, duke reflektuar një rënie të numrit të çështjeve të reja të trajtuara nga gjykata. Numri i çështjeve të mbartura rezulton më i lartë në vitin 2025, me 35 çështje, kundrejt 26 çështjeve në vitin 2024, çka tregon një rritje të stokut procedural të çështjeve në proces. Sa i përket çështjeve të përfunduara me vendim, në vitin 2025 janë përfunduar 33 çështje, ndërsa në vitin 2024 rezultojnë 30 çështje të përfunduara, duke paraqitur një rritje të lehtë të numrit të vendimeve të dhëna gjatë vitit. Në tërësi, të dhënat paraqesin një ulje të fluksit të çështjeve të reja të regjistruara, të shoqëruar me një rritje të çështjeve të mbartura dhe të atyre të përfunduara me vendim në vitin 2025.

Të dhënat mbi treguesit e eficiencës lidhur me çështjet e krimit të organizuar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë tregojnë ndryshime ndërmjet viteve 2024 dhe 2025 në disa prej indikatorëve proceduralë kryesorë. Norma e likuidimit të çështjeve rezulton më e lartë në vitin 2025, me 103%, krahasuar me 77% në vitin 2024, duke reflektuar një raport më të lartë të çështjeve të përfunduara në raport me çështjet e reja të regjistruara gjatë vitit. Ndërkohë, koha mesatare për zgjidhjen e çështjeve rezulton më e ulët në vitin 2025, me 376 ditë, kundrejt 426 ditëve në vitin 2024. Sa i përket çështjeve më të vjetra se dy vite në fund të periudhës, në vitin 2025 rezultojnë 5 çështje të tilla, ndërsa në vitin 2024 rezultojnë 6 çështje. Po ashtu, përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit mbi dy vite paraqitet në nivel më të ulët në vitin 2025, me 15%, krahasuar me 17% në vitin 2024. Në tërësi, të dhënat tregojnë një ulje të kohëzgjatjes mesatare të trajtimit të çështjeve dhe të peshës së çështjeve me kohëzgjatje më të gjatë procedurale në vitin 2025 krahasuar me vitin pararendës.


Grafik 11: Tregues të efijencës në çështjet e krimit të organizuar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë (2025 vs 2024)



Burimi: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Të dhënat mbi kohëzgjatjen e çështjeve të krimit të organizuar të gjykuara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë tregojnë një shpërndarje të ndryshme të çështjeve sipas afateve kohore ndërmjet viteve 2024 dhe 2025. Në vitin 2025, 10 çështje janë gjykuar brenda një periudhe më të shkurtër se 6 muaj, ndërsa në vitin 2024 rezultojnë 14 çështje në këtë kategori. Për çështjet me kohëzgjatje nga 6 deri në 12 muaj, në vitin 2025 rezultojnë 14 çështje, krahasuar me 9 çështje në vitin 2024. Ndërkohë, numri i çështjeve me kohëzgjatje nga 1 deri në 2 vite rezulton më i lartë në vitin 2025, me 6 çështje, kundrejt 4 çështjeve në vitin 2024. Sa i përket çështjeve që kanë zgjatur mbi 2 vite, të dhënat paraqesin të njëjtin numër në të dy vitet, me nga 3 çështje. Në tërësi, të dhënat tregojnë një zhvendosje të një pjese të çështjeve drejt kategorive me kohëzgjatje më të gjatë në vitin 2025, ndërkohë që numri i çështjeve të përfunduara brenda 6 muajve rezulton më i ulët krahasuar me vitin 2024.

Grafik 12: Kohëzgjatja e çështjeve të krimit të organizuar të gjykuara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë (2025 vs 2024)



Burimi: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

2.1. Shtrirja gjeografike e grupeve dhe aktivitetit kriminal

Shtrirja gjeografike e veprimtarisë kriminale përbën një nga dimensionet më të rëndësishme për të kuptuar nivelin e organizimit, kompleksitetin dhe kapacitetin operativ të grupeve të krimit të organizuar. Përtej identifikimit të vendeve ku zhvillohet aktiviteti kriminal, analiza e këtij kriteri mundëson vlerësimin e mënyrës se si këto grupe strukturojnë hapësirën, shfrytëzojnë territorin dhe ndërtojnë lidhje ndërmjet zonave të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Në këtë kuadër, evidentohet se shtrirja gjeografike nuk paraqitet si një element statik, por si një komponent dinamik dhe funksional i aktivitetit kriminal, i cili varion nga kontrolli i territorit lokal deri te ndërtimi i rrjeteve të integruara transnacionale.

Veprimtaria kriminale nuk paraqet një model unik territorial, por një spektër konfigurimesh hapësinore që variojnë nga kontrolli lokal i zonave të izoluar, te rrjetet kombëtare me lëvizshmëri të lartë, e deri te arkitektura të plota transnacionale, ku territori përdoret si korridor, nyje logjistike, bazë operationale, hapësirë investimi apo platformë financiare. Në këtë kuptim, kriteri i shtrirjes gjeografike nuk shërben thjesht për të treguar “ku” ndodh aktiviteti kriminal, por mbi të gjitha për të kuptuar si organizohet ai në hapësirë, sa i qëndrueshëm është, çfarë niveli kontrolli ushtron mbi territorin dhe në çfarë mase ndërtohet mbi lidhje ndërkuftare ose shumëjuridiksionale.

Një nga gjetjet më të rëndësishme që del nga tërësia e çështjeve është se, në një numër të konsiderueshëm rastesh, krimi i organizuar nuk paraqitet më si fenomen i lidhur me një vend të vetëm, por si rrjet me funksione të shpërndara territoriale. Kjo shihet qartë në rastet ku një hapësirë përdoret për organizim, një tjetër për prodhim ose magazinim, një tjetër për transport, dhe një tjetër për shpërndarje ose investim të të ardhurave. Në këtë mënyrë, territori ndahet sipas logjikës së zinxhirit kriminal dhe jo sipas kufijve administrativë formalë. Kjo ndarje funksionale del si tipar i përsëritur si në çështjet e narkotikëve, ashtu edhe në ato të migracionit të paligjshëm, të transferimit të kapitaleve apo të strukturave me bazë urbane, duke treguar se hapësira kriminale është e organizuar, jo spontane.

“Analiza e tregon se territori nuk përdoret më si një hapësirë e vetme operimi, por si një rrjet funksional i ndarë sipas fazave të aktivitetit kriminal (organizim, prodhim, transport dhe shpërndarje).”

Në rastet që lidhen me kultivimin dhe prodhimin e lëndëve narkotike, territori del si një aset strategjik në vetvete. Zonat malore, pyjore, periferike dhe të vështira për akses nuk përzgjidhen rastësisht, por për shkak të kapacitetit të tyre për kamuflim, për mbrojtje nga kontrolli dhe për ndërtimin e një lloji “infrastruktura të heshtur” kriminale. Në këto raste, shtrirja gjeografike nuk përkthehet domosdoshmërisht në zgjerim ndërkombëtar, por në kontroll të zgjuar dhe të segmentuar të territorit lokal, ku parcelat, zonat e përpunimit, hapësirat e magazinimit dhe rrugët e transportit ndërthuren në një hartë të vetme operative. Veçanërisht domethënëse janë rastet ku ky kontroll territorial shoqërohet edhe me

mbështetje ose tolerim nga aktorë lokalë, madje në disa situata edhe me rrjedhje informacioni nga struktura shtetërore, çka e ngre analizën nga niveli i përdorimit të territorit te niveli i penetrimin të mekanizmave lokalë të kontrollit. Kjo tregon se në disa çështje territori nuk është thjesht vendndodhje, por objekt menaxhimi kriminal.

“Në rastet e kultivimit dhe prodhimit të narkotikëve evidentohet një prirje e qartë për shfrytëzimin strategjik të zonave të izoluar, ku territori kthehet në një aset të kontrolluar dhe të menaxhuar nga grupi kriminal.”

Një tjetër prirje e fortë është ajo e korridoreve ndërkufitare të konsoliduara, sidomos në rastet që lidhen me trafikun e narkotikëve dhe me migracionin e paligjshëm. Këtu, territori shqiptar del jo thjesht si bazë e brendshme operimi, por si pjesë e një aksit më të gjerë rajonal apo evropian. Në disa vendime, Shqipëria shfaqet si pikë nisjeje drejt Greqisë; në të tjera si nyje tranziti mes Greqisë dhe Italisë; në të tjera sërish si bazë e origjinës ose si vend riinvestimi të të ardhurave kriminale. Kjo do të thotë se gjeografia e krimit të organizuar nuk ndërtohet vetëm mbi kontrollin e një vendi, por mbi shfrytëzimin e pozicionit gjeostrategjik të Shqipërisë në korridore lëvizjeje të mallrave, personave dhe kapitaleve. Rastet e kontrabandimit të migrantëve janë veçanërisht domethënëse në këtë drejtim, sepse tregojnë se Shqipëria funksionon si hapësirë grumbullimi, strehimi të përkohshëm, koordinimi dhe daljeje drejt Italisë, pra si një nyje e ndërmjetme pa qenë destinacion final. Kjo e bën territorin shqiptar pjesë të një arkitekture transnacionale, jo vetëm të një fenomeni lokal.

“Një pjesë e konsiderueshme e çështjeve dëshmon për ekzistencën e korridoreve të konsoliduara ndërkufitare, ku territori shqiptar funksionon si nyje tranziti dhe organizimi në rrjete më të gjera rajonale dhe evropiane.”

Në plan më të gjerë, evidentohet se shtrirja transnacionale nuk është homogjene. Në disa raste ajo është relativisht lineare, e ndërtuar mbi një aks të qartë, si p.sh. Shqipëri-Greqi ose BE-Shqipëri. Në raste të tjera, sidomos në rrjetet më të avancuara të narkotikëve, ajo merr formën e rrjeteve shumëjuridiksionale, ku disa shtete shërbejnë për funksione të ndryshme, njëri për magazinim, një tjetër për transport, një tjetër për shpërndarje, dhe një tjetër për menaxhim financiar. Këto konfigurime tregojnë jo vetëm zgjerim hapësinor, por edhe ritje të kapacitetit organizativ, pasi operimi në disa juridiksione kërkon mobilitet, komunikim të sofistikuar, përdorim të infrastrukturës ligjore ndërkombëtare dhe aftësi për t'u përshtatur me sisteme të ndryshme kontrolli. Në këtë grup çështjesh, territori nuk është më një vend, por një rrjet i koordinuar hapësirash funksionale.

Shumë e rëndësishme është edhe dallimi mes territorit statik dhe territorit dinamik. Në disa raste, veçanërisht ato të kultivimit, mbështeten te territore relativisht të qëndrueshme dhe të kontrolluara, ku aktiviteti zhvillohet në mënyrë ciklike e të

përsëritur. Në të kundërt, disa raste të tjera, sidomos ato me bazë urbane ose me lëvizje të brendshme ndërmjet qyteteve, tregojnë se krimi i organizuar funksionon përmes një mobiliteti të vazhdueshëm, ku aktiviteti nuk varet nga një zonë fikse, por nga lidhja mes pikave të ndryshme: vende takimi, vende koordinimi, zona veprimi, korridore largimi dhe hapësira fshehjeje. Ky model e bën territorin më pak “pronë” të grupit dhe më shumë rrjet rrjedhësor veprimi, duke rritur fleksibilitetin dhe aftësinë për t’iu shmangur ndërhyrjes së autoriteteve. Në këtë këndvështrim, shtrirja gjeografike bëhet edhe tregues i reziliencës operative të grupit kriminal.

“Një tipar i përsëritur është zhvendosja nga kontrolli i territorit statik drejt përdorimit të territorit si rrjedhë lëvizjeje, ku mobiliteti bëhet element kyç i operimit kriminal.”

Një nën-trend me peshë që evidentohet është urbanizimi i veprimtarisë kriminale. Jo të gjitha rastet mbështeten në zona të izoluara apo korridore kufitare; disa vendime tregojnë qartë se aktiviteti kriminal operon në zemër të mjediseve urbane, duke shfrytëzuar dendësinë njerëzore, normalitetin e jetës qytetare, bizneset, ambientet publike dhe infrastrukturën e lëvizjes. Në këto raste, kamuflimi nuk sigurohet përmes izolimit, por përmes fshehjes brenda rutinës urbane. Tirana shfaqet në disa çështje si qendër operationale, qoftë për planifikim dhe ekzekutim të akteve të dhunshme, qoftë për menaxhim financiar dhe ndërveprim me sektorin ekonomik. Kjo tregon se krimi i organizuar nuk duhet kuptuar vetëm si fenomen periferik apo rural; ai ka kapacitet të ndërtohet edhe mbi anonimitetin dhe kompleksitetin e hapësirës urbane, çka e vështirëson identifikimin e hershëm të modeleve të operimit.

Nga ana tjetër, në aktivitete kriminale të caktuara, shtrirja gjeografike është kombëtare, por e centralizuar, me një qendër të fortë operative dhe zona periferike mbështetëse. Ky model është i rëndësishëm sepse zë një vend të ndërmjetëm mes rrjeteve plotësisht të shpërndara dhe atyre plotësisht transnacionale. Në këto raste, grupi kriminal duket se ka kaluar nga spontaniteti në një fazë më të konsoliduar, ku qendra kontrollon vendimmarrjen dhe koordinimin, ndërsa zona të tjera përdoren për logjistikë, ekzekutim, transport apo shmangie të ekspozimit. Kjo tipologji është veçanërisht domethënëse për analizën sepse tregon se rritja e organizimit nuk shfaqet domosdoshmërisht me zgjerim ndërkombëtar, por mund të manifestohet edhe përmes konsolidimit të kontrollit mbi një hapësirë kombëtare të diferencuar.

“Në rastet më të avancuara, shtrirja gjeografike merr formën e rrjeteve shumëjuridiksionale, ku territore të ndryshme shërbejnë për funksione të specializuara brenda të njëjtit zinxhir kriminal.”

Një dimension shumë i rëndësishëm, është se territori përdoret jo vetëm për operim kriminal, por edhe për integrim në ekonomi dhe qarkullim të të ardhurave. Kjo shihet qartë në rastet ku shtrirja gjeografike lidhet me pasuritë e paluajtshme, investimet, transaksionet, qendrat urbane ekonomike dhe përdorimin e territorit si bazë për legalizimin ose fshehjen e produkteve të krimit. Në këto raste, gjeografia e aktivitetit kriminal nuk është më vetëm logjistikë kriminale, por edhe gjeografi e

penetrimit ekonomik, ku territori shërben si mjedis për transformimin e kapitalit kriminal në prani të dukshme apo të padukshme në ekonominë formale. Kjo tregon se shtrirja gjeografike duhet parë jo vetëm në raport me lëvizjen e mallrave apo personave, por edhe me vendosjen territoriale të fuqisë ekonomike kriminale.

“Në disa aktivitete kriminale, shtrirja gjeografike nuk lidhet me lëvizjen fizike të aktivitetit kriminal, por me shpërndarjen e tij në rrjete financiare dhe ekonomike, duke krijuar një ‘gjeografi të padukshme’ të krimit.”

Po aq domethënës është fakti që në aktivitetet kriminale gjerësia e shtrirjes gjeografike pasqyrohet drejtpërdrejt edhe në nevojën për bashkëpunim penal ndërkombëtar. Aty ku aktiviteti përfshin disa shtete, itinerare ndërkufitare, juridiksione të ndryshme apo aktorë të vendosur jashtë Shqipërisë, hetimi dhe ndjekja penale nuk mund të mbështeten vetëm në mjetet kombëtare. Përdorimi i skuadrave të përbashkëta hetimore, urdhër-arresteve europiane, referencave ndaj vendimeve të gjykatave të huaja dhe koordinimit ndërmjet prokurorive të disa vendeve tregon se shtrirja gjeografike nuk është thjesht atribut i grupit kriminal, por edhe faktor që kushtëzon përgjigjen institucionale. Sa më shumë zgjerohet hapësira e veprimit kriminal, aq më e nevojshme bëhet një arkitekturë po aq e integruar e hetimit dhe bashkëpunimit. Në këtë kuptim, kriteri i shtrirjes gjeografike ndihmon edhe për të matur indirekt nivelin e sfidës që këto struktura paraqesin për sistemin penal.

“Gjerësia dhe kompleksiteti i shtrirjes gjeografike lidhet drejtpërdrejt me nivelin e organizimit kriminal, duke rritur njëkohësisht sfidat për hetimin dhe nevojën për bashkëpunim ndërkombëtar.”

Në tërësi, shtrirja gjeografike e veprimtarisë kriminale mund të lexohet përmes disa tipologjive kryesore: së pari, modeli i kontrollit territorial rural/periferik, sidomos në kultivim e përpunim; së dyti, modeli i korridorit ndërkufitar, kryesisht në trafikimin e narkotikëve, migracionin e paligjshëm dhe transferimin e kapitaleve; së treti, modeli i rrjetit shumëjuridiksional transnacional, me ndarje funksionale të aktivitetit në disa shtete; së katërti, modeli i shtrirjes kombëtare me mobilitet të lartë, ku territori është rrjet pikash dhe jo hapësirë fikse; dhe së pesti, modeli i përqendrimit urban dhe ekonomik, ku veprimtaria kriminale kamuflohet brenda jetës qytetare dhe qarkullimit financiar. Këto tipologji nuk janë plotësisht të ndara nga njëra-tjetra; përkundrazi, në disa vendime ato mbivendosen, gjë që tregon se krimi i organizuar po bëhet njëkohësisht më fleksibël, më funksional në përdorimin e territorit dhe më i aftë për të kaluar nga kontrolli fizik i hapësirës te kontrolli i korridoreve, i lëvizjes dhe i nyjeve ekonomike.

Prandaj, në këtë seksion të raportit, është e rëndësishme të theksohet se shtrirja gjeografike nuk duhet trajtuar si element dytësor përshkrues, por si një tregues thelbësor i pjekurisë organizative të grupeve kriminale. Ajo tregon nëse grupi

kontrollon territor, nëse ndërton korridore, nëse përdor mobilitetin si avantazh, nëse depërton në ekonomi, dhe nëse është në gjendje të kombinojë hapësira lokale me rrjete ndërkombëtare. Pikërisht për këtë arsye, analiza sugjeron se krimi i organizuar nuk karakterizohet më vetëm nga prania në një zonë të caktuar, por nga aftësia për ta funksionalizuar territorin sipas nevojave operative të grupit. Kjo e bën kriterin e shtrirjes gjeografike një nga dritaret më të forta për të kuptuar jo vetëm ku vepron krimi i organizuar, por edhe çfarë kapaciteti ka për t'u konsoliduar, për t'u fshehur, për t'u zgjeruar dhe për të depërtuar në ekonomi e në hapësira ndërkufitare.

2.2. Numri i personave të përfshirë

Numri i personave të përfshirë në veprimtarinë kriminale përbën një nga treguesit më të rëndësishëm për të vlerësuar jo vetëm ekzistencën e krimit të organizuar, por mbi të gjitha nivelin e organizimit, strukturimin e brendshëm dhe kapacitetin operacional të grupeve kriminale. Ky kriter nuk duhet parë thjesht si një element numerik, por si një indikator që reflekton mënyrën se si grupet ndërtohen, funksionojnë dhe evoluojnë në kohë. Në këtë kuptim, analiza rasteve tregon qartë se numri i personave është i lidhur ngushtë me kompleksitetin e strukturës kriminale, ndarjen e roleve dhe shkallën e koordinimit ndërmjet aktorëve.

“Numri i personave të përfshirë rezulton të jetë një indikator i drejtpërdrejtë i nivelit të organizimit dhe kompleksitetit të strukturave kriminale.”

Në një segment të çështjeve evidentohet prania e grupeve kriminale të zgjeruara, me një numër të lartë personash të përfshirë, që në disa raste arrijnë në më shumë se 10 individë të identifikuar, të shoqëruar shpesh nga një numër edhe më i madh bashkëpunëtorësh në sfond. Këto struktura përfaqësojnë formën më të zhvilluar të organizimit kriminal, ku veprimtaria nuk është episodike, por e qëndrueshme dhe e strukturuar në kohë. Numri i lartë i pjesëmarrësve në këto raste lidhet drejtpërdrejt me ndarjen e avancuar të roleve, duke përfshirë nivele drejtuese, operacionale dhe mbështetëse, si dhe me aftësinë për të zhvilluar aktivitete kriminale të shumëfishta në mënyrë paralele. Në këtë kontekst, rritja e numrit të personave përkthehet në rritje të kapacitetit kriminal, kompleksitetit dhe rezistencës së strukturës ndaj ndërhyrjeve ligjzbatuese.

“Grupet me numër të lartë pjesëmarrësish shfaqin një nivel të avancuar organizimi, me ndarje të qartë rolesh dhe kapacitet për veprimtari kriminale të shumëfishta.”

Një kategori tjetër e rëndësishme përbëhet nga grupet kriminale me përbërje mesatare, zakonisht me 5-10 persona në bërthamë, të shoqëruar nga një rrjet bashkëpunëtorësh periferikë që aktivizohen sipas nevojës. Këto struktura përfaqësojnë një model të ndërmjetëm organizimi, ku evidentohet një balancë ndërmjet fleksibilitetit dhe strukturimit. Ndërsa numri nuk është aq i lartë sa në organizatat kriminale të zgjeruara, këto grupe arrijnë të sigurojnë ndarje funksionesh dhe koordinim efektiv, duke u bërë të afta për të realizuar aktivitete të organizuara dhe të vazhdueshme. Në këto raste, rëndësia nuk qëndron vetëm te numri, por te aftësia e grupit për të funksionuar si një njësi kolektive e koordinuar, ku çdo individ ka një rol të përcaktuar në zinxhirin kriminal.

“Grupet me përbërje mesatare karakterizohen nga një ekuilibër ndërmjet strukturimit dhe fleksibilitetit operacional.”

Paralelisht, analiza eidenton një numër të konsiderueshëm rastesh ku veprimtaria kriminale realizohet nga grupe më të vogla, zakonisht me 3-5 persona, të cilët operojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të koordinuar. Këto struktura karakterizohen nga bashkëpunim i ngushtë ndërmjet anëtarëve dhe nga mungesa relative e një rrjeti të gjerë mbështetës, duke krijuar një model më kompakt dhe më të centralizuar organizimi. Megjithatë, pavarësisht numrit të kufizuar, këto grupe shpesh shfaqin efikasitet të lartë operacional dhe fleksibilitet në veprim, sidomos në rastet që përfshijnë aktivitete kriminale të targetuara. Në këtë kontekst, bëhet e qartë se kompleksiteti i veprimtarisë kriminale nuk lidhet domosdoshmërisht me madhësinë e grupit, por edhe me natyrën e funksioneve dhe nivelin e koordinimit ndërmjet anëtarëve.

“Kompleksiteti i veprimtarisë kriminale nuk lidhet domosdoshmërisht me madhësinë e grupit, por me natyrën e funksioneve dhe koordinimin ndërmjet anëtarëve.”

Një element veçanërisht i rëndësishëm që del nga analiza është diskrepanca ndërmjet numrit formal të personave të identifikuar në vendime dhe numrit real të personave të përfshirë në aktivitetin kriminal. Në një numër të konsiderueshëm rastesh, eidentohet vetëm bërthama e dukshme e grupit, ndërkohë që nga komunikimet, ndërveprimet dhe natyra e aktivitetit kriminal rezultojnë qartë ekzistenca e një rrjeti më të gjerë bashkëpunëtorësh. Ky fenomen është veçanërisht i theksuar në rastet e krimit ekonomik dhe atij kompjuterik, ku struktura kriminale shpesh operon në mënyrë të shpërndarë dhe pjesërisht të padukshme, duke e bërë të vështirë identifikimin e plotë të të gjithë pjesëmarrësve.

Nga ana tjetër, aktivitete të caktuara kriminale realizohen nga një numër shumë i kufizuar personash ose edhe nga një individ i vetëm, pa elemente të bashkëpunimit të organizuar. Këto raste përfaqësojnë një devijim nga modeli tipik i krimit të organizuar dhe karakterizohen nga mungesë e strukturës, e ndarjes së roleve dhe e koordinimit kompleks. Megjithatë, përfshirja e tyre në analizë është e rëndësishme për të eidentuar kufirin ndërmjet krimit të organizuar dhe veprimtarisë individuale, si dhe për të theksuar se jo çdo aktivitet kriminal me një numër të kufizuar personash përbën domosdoshmërisht një strukturë të organizuar.

“Rastet individuale përfaqësojnë përjashtim nga modeli i krimit të organizuar dhe karakterizohen nga mungesë e strukturës dhe koordinimit.”

Një tjetër dimension thelbësor që del nga analiza është fakti se, pavarësisht numrit të përgjithshëm të personave, shumica e grupeve kriminale shfaqin një strukturë të brendshme shumë-shtresore, e ndarë në nivele të ndryshme përfshirjeje. Në mënyrë të përsëritur eidentohet ekzistenca e një bërthame operative, e cila realizon aktivitetin kriminal, një niveli koordinues, që siguron lidhjen dhe organizimin ndërmjet anëtarëve, si dhe një rrjeti mbështetës, i përbërë nga individë që kontribuojnë në mënyrë indirekte përmes logjistikës, komunikimit apo lehtësimit të veprimtarisë. Kjo ndarje funksionale tregon se numri i personave është i lidhur

ngushtë me diferencimin e roleve dhe specializimin e funksioneve brenda grupit, duke reflektuar një nivel më të lartë organizimi në rastet me më shumë pjesëmarrës.

“Numri i pjesëmarrësve lidhet drejtpërdrejt me diferencimin e roleve dhe specializimin e funksioneve brenda grupit.”

Në tërësi, analiza e këtij kriteri konfirmon se numri i personave të përfshirë është një indikator kyç për të kuptuar natyrën, strukturën dhe funksionimin e krimit të organizuar. Rritja e numrit të pjesëmarrësve shoqërohet zakonisht me ritje të kompleksitetit, qëndrueshmërisë dhe kapacitetit operacional të grupit, ndërsa strukturat me pak individë prirjen të jenë më fleksibile, por më të kufizuara në shtrirje dhe ndikim. Në të njëjtën kohë, prania e rrjeteve të padukshme dhe e bashkëpunëtorëve të pafidentifikuar nënvizon se analiza e këtij kriteri duhet të shkojë përtej dimensionit formal dhe të fokusohet në dinamikën reale të bashkëpunimit kriminal, duke ofruar një kuptim më të thelluar të mënyrës se si operojnë këto struktura në praktikë.

2.3. Identifikimi i aktiviteteve kryesore kriminale

Aktivitetet kryesore kriminale përbëjnë thelbin e analizës së krimit të organizuar, pasi ato pasqyrojnë jo vetëm natyrën e veprimtarisë së paligjshme, por edhe mënyrën se si grupet kriminale ndërtojnë modele funksionimi, ndërveprojnë me tregun dhe përshtaten me mundësitë ekonomike dhe institucionale. Analiza eidenton një panoramë të gjerë dhe të shumëllojshme aktiviteteve kriminale, të cilat, megjithëse ndryshojnë në natyrë dhe kompleksitet, ndajnë disa karakteristika të përbashkëta, si orientimi drejt përfitimit ekonomik, organizimi në grup dhe ndërthurja e disa aktiviteteve brenda së njëjtës skemë kriminale.

“Aktivitetet kriminale reflektojnë orientimin e strukturave drejt përfitimit ekonomik përmes modeleve të organizuara dhe të ndërlidhura.”

Një nga gjetjet më të qarta që del nga analiza është dominimi i kriminalitetit të lidhur me narkotikët, i cili përbën boshtin kryesor të një pjese të madhe të çështjeve të shqyrtuara. Ky kriminalitet nuk paraqitet në një formë të vetme, por në një zinxhir të plotë aktiviteteve, që përfshin kultivimin, përpunimin, transportin dhe shpërndarjen e lëndëve narkotike. Në disa raste, aktiviteti kufizohet në një fazë të caktuar, si p.sh. kultivimi në zona të izoluara apo transporti në nivel operativ, ndërsa në raste të tjera eidentohet një integrim i plotë i gjithë ciklit kriminal, duke reflektuar një nivel më të avancuar organizimi. Kjo tregon se krimi i organizuar në fushën e narkotikëve nuk është homogjen, por varion nga struktura lokale relativisht të thjeshta deri te rrjete të konsoliduara me shtrirje ndërkombëtare.

“Kriminaliteti i narkotikëve paraqitet si aktivitet dominues, i organizuar në një zinxhir të integruar nga prodhimi deri te shpërndarja.”

Në këtë kontekst, një dimension veçanërisht i rëndësishëm është ndarja funksionale e aktiviteteve brenda zinxhirit të drogës, ku secila hallkë përfaqëson një rol të caktuar në gjenerimin dhe realizimin e fitimit kriminal. Kultivimi përfaqëson fazën fillestare të prodhimit, shpesh i organizuar në zona të fshehta dhe me përdorim të fuqisë punëtore, ndërsa transporti dhe shpërndarja përbëjnë fazat operative që kërkojnë koordinim të vazhdueshëm dhe logjistikë të strukturuar. Në nivelet më të avancuara, sidomos në rastet me element ndërkombëtar, eidentohet një rrjet i integruar që lidh prodhimin në një vend me tregjet e konsumit në vende të tjera, duke përfshirë një organizim kompleks të transportit, financimit dhe komunikimit.

Paralelisht me kriminalitetin e narkotikëve, analiza eidenton edhe zhvillimin e kriminalitetit financiar, i cili në disa raste shfaqet si aktivitet kryesor dhe në të tjera si aktivitet mbështetës i veprimtarive të tjera kriminale. Ky dimension përfshin forma të ndryshme, si huadhënia me përqindje (fajde), qarkullimi i kapitalit informal dhe pastrimi i produkteve të veprës penale. Këto aktivitete tregojnë ekzistencën e një ekonomie kriminale paralele, ku kapitali gjenerohet, qarkullon dhe riinvestohet

jashtë sistemit formal financiar. Veçanërisht në rastet e pastrimit të parave, evidentohet përdorimi i mekanizmave të sofistikuar për maskimin e origjinës së pasurisë dhe integrimin e saj në ekonomi, duke treguar një nivel të lartë ndërveprimi midis krimit dhe strukturave formale ekonomike.

“Aktivitetet financiare tregojnë ekzistencën e një ekonomie kriminale paralele dhe mekanizmave për integrimin e fitimeve në ekonomi.”

Një tjetër dimension i rëndësishëm që del nga analiza është prania e krimit të organizuar të dhunshëm, i cili përfshin aktivitete si vrasjet e planifikuara, sulmet e armatosura dhe veprimtaritë e bandave të armatosura. Ndryshe nga kriminaliteti ekonomik apo ai i narkotikëve, këto aktivitete karakterizohen nga një nivel i lartë rrezikshmërie dhe ndikimi direkt në sigurinë publike dhe rendin shoqëror. Në këto raste, aktiviteti kriminal nuk kufizohet në përfitim ekonomik, por shtrihet edhe në kontroll territorial, dominim përmes dhunës dhe përballje të drejtpërdrejtë me autoritetet shtetërore. Kjo tregon ekzistencën e një segmenti të krimit të organizuar që operon me logjikë të ndryshme nga ajo e tregut, duke përdorur forcën si instrument kryesor.

“Krimi i organizuar i dhunshëm shfaq një dimension kontrolli territorial dhe përdorimi të forcës si instrument dominimi.”

Në të njëjtën kohë, analiza nxjerr në pah një element thelbësor të krimit të organizuar: ndërthurjen e aktiviteteve kriminale brenda së njëjtës strukturë. Në shumicën e rasteve, aktiviteti kriminal nuk është i kufizuar në një veprim të vetëm, por përbëhet nga një kombinim aktiviteteve që mbështesin dhe fuqizojnë njëri-tjetrin. Për shembull, trafikimi i narkotikëve shoqërohet me përdorimin e armëve, organizimin e rrjeteve logjistike dhe menaxhimin financiar të fitimeve, ndërsa aktivitetet financiare lidhen me investime në ekonomi dhe përdorim të strukturave ligjore për mbulim. Kjo ndërthurje krijon një model të integruar kriminal, ku secili aktivitet kontribuon në funksionimin e përgjithshëm të strukturës.

“Aktivitetet kriminale nuk shfaqen të izoluara, por të ndërthurura në modele të integruara funksionimi.”

Një dimension tjetër i rëndësishëm është shfaqja e aktivitetit kriminal në forma të ndryshme organizimi, nga struktura të thjeshta dhe lokale deri te organizata të mirëfillta kriminale me shtrirje ndërkombëtare. Në rastet më të avancuara, evidentohet një cikël i plotë i aktivitetit kriminal, që përfshin prodhimin, transportin, shpërndarjen, menaxhimin financiar dhe pastrimin e të ardhurave. Këto raste përfaqësojnë forma të konsoliduara të krimit të organizuar, ku aktivitetet janë të koordinuara në mënyrë të qëndrueshme dhe të integruar në tregje më të gjera. Gjithashtu, analiza tregon se një pjesë e aktiviteteve kriminale zhvillohen në mënyrë të specializuar dhe të fokusuar, ndërsa të tjera karakterizohen nga një qasje më e diversifikuar, ku të njëjtët aktorë përfshihen në disa lloje aktiviteteve

njëkohësisht. Kjo sugjeron se krimi i organizuar nuk operon vetëm përmes specializimit, por edhe përmes fleksibilitetit dhe përshtatjes ndaj mundësive që ofron tregu kriminal.

“Krimi i organizuar paraqitet si një sistem i strukturuar dhe i diversifikuar veprimtarish, i orientuar drejt qëndrueshmërisë dhe zgjerimit të fitimit.”

Në tërësi, analiza e aktiviteteve kryesore kriminale konfirmon se krimi i organizuar në rastet e shqyrtuara nuk është i fragmentuar apo sporadik, por paraqitet si një sistem kompleks dhe i strukturuar veprimtarish të ndërlidhura, që operojnë në funksion të përfitimit ekonomik, kontrollit dhe qëndrueshmërisë së strukturës kriminale. Diversiteti i aktiviteteve, ndërthurja e tyre dhe prania e dimensioneve ndërkombëtare në disa raste tregojnë se krimi i organizuar ka kaluar përtej formave tradicionale dhe është zhvilluar në modele më të sofistikuara, që kërkojnë analiza të thelluara dhe qasje të integruara për t’u kuptuar dhe adresuar në mënyrë efektive.

2.4. Kompleksiteti i operacioneve (Modus Operandi)

Analiza e modus operandi të aktiviteteve kriminale ofron një kuptim të thelluar të mënyrës konkrete se si strukturat e krimit të organizuar operojnë në praktikë, duke kaluar përtej identifikimit të thjeshtë të aktiviteteve kriminale dhe duke evidentuar modelet e organizimit, teknikave operative dhe mekanizmave të fshehjes që këto struktura përdorin për të siguruar funksionimin e qëndrueshëm dhe minimizimin e rrezikut nga autoritetet. Në tërësi, modus operandi i evidentuar nuk paraqitet si i rastësishëm apo spontan, por si rezultat i një procesi të qëllimshëm planifikimi, përshtatjeje dhe sofistikimi, që reflekton evoluimin e krimit të organizuar drejt formave gjithnjë e më të sofistikuara.

Një nga karakteristikat më të dukshme që del nga analiza është prania e strukturave të organizuara dhe funksionalisht të diferencuara, ku ndarja e roleve përbën një element themelor të modus operandi. Në shumicën e rasteve, grupet kriminale operojnë përmes një ndarjeje të qartë ndërmjet funksioneve drejtuese, operative dhe mbështetëse, duke krijuar një sistem ku secili anëtar kontribuon në një hallkë specifike të aktivitetit kriminal. Kjo ndarje funksionale shfaqet në forma të ndryshme, nga strukturat më të avancuara me organizim hierarkik dhe drejtim të centralizuar, deri te struktura më fleksibël dhe modulare, ku rolet janë të zëvendësueshme dhe të adaptueshme sipas nevojave operative. Në të gjitha rastet, kjo logjikë organizimi shërben për të rritur efikasitetin dhe për të reduktuar ekspozimin penal të strukturës drejtuese, duke izoluar hallkat më të rëndësishme nga aktivitetet e drejtpërdrejta kriminale.

Një dimension tjetër thelbësor i modus operandi është planifikimi i fazuar i aktivitetit kriminal, i cili evidentohet qartë në pothuajse të gjitha kategoritë e veprave penale. Aktivitetet kriminale nuk zhvillohen në mënyrë të rastësishme, por përmes një sekuence të strukturuar fazash, që zakonisht përfshijnë përgatitjen, organizimin, ekzekutimin dhe menaxhimin pasues të aktivitetit. Në rastet e kultivimit të narkotikëve, kjo shfaqet në përzgjedhjen e territorit, ndërtimin e infrastrukturës dhe organizimin e prodhimit; në rastet e trafikut, në ndarjen e hallkave të furnizimit, transportit dhe shpërndarjes; ndërsa në rastet e krimeve të dhunshme, në fazën e inteligjencës, targetimit dhe ekzekutimit. Ky model tregon se krimi i organizuar operon mbi një logjikë operacionale të strukturuar dhe të parashikueshme në brendësi të tij, edhe pse shpesh i padukshëm nga jashtë.

“Ndarja e roleve përbën elementin kyç të funksionimit të strukturave kriminale. Aktiviteti kriminal zhvillohet përmes një cikli të strukturuar fazash dhe jo si veprim spontan.”

Një nga elementet më të rëndësishme që përshkon të gjitha rastet është përdorimi i mekanizmave të fshehjes dhe shmangies nga autoritetet, të cilët shfaqen në disa nivele dhe forma. Në nivel fizik, grupet kriminale shfrytëzojnë terrene të izoluara, ndërtojnë infrastruktura të fshehta dhe përdorin maskim për të shmangur identifikimin. Në nivel operacional, evidentohet një fragmentim i aktivitetit kriminal në hallka të ndara, ku secili aktor ka informacion të kufizuar për të gjithë zinxhirin,

duke e bërë më të vështirë zbulimin e strukturës së plotë. Në nivel teknik, përdoren metoda të ndryshme për shmangien e gjurmimit, si përdorimi i shumë numrave telefoni, SIM-ve të regjistruara në emra të tjerë apo komunikimeve të fragmentuara dhe jo eksplicite. Këto mekanizma tregojnë një vetëdije të lartë të grupeve kriminale ndaj teknikave të hetimit, duke reflektuar një proces të vazhdueshëm adaptimi ndaj presionit të autoriteteve.

“Fragmentimi i aktivitetit dhe përdorimi i teknikave të fshehjes synojnë minimizimin e ekspozimit ndaj autoriteteve.”

Një aspekt veçanërisht i rëndësishëm që del nga analiza është diversiteti i teknikave operative në varësi të llojit të aktivitetit kriminal, çka tregon se modus operandi nuk është uniform, por i përshtatur sipas kontekstit dhe objektivit të aktivitetit. Në rastet e kultivimit të narkotikëve, evidentohet një adaptim i avancuar i mjedisit natyror dhe përdorim i teknikave agronomike, duke përfshirë modifikimin e terrenit, instalimin e sistemeve të ujitjes dhe optimizimin e prodhimit. Në rastet e trafikut të narkotikëve, modus operandi karakterizohet nga një strukturë zinxhir (supply chain), me ndarje të qartë midis furnizimit, transportit dhe shpërndarjes. Në aktivitetet financiare, evidentohet një nivel më i lartë kompleksiteti, me përdorim të mekanizmave të pastrimit të parave, strukturave biznesore dhe sistemeve financiare informale, që krijojnë një ekonomi kriminale paralele. Ndërkohë, në rastet e krimeve të dhunshme, modus operandi karakterizohet nga planifikim taktik, përdorim i forcës dhe koordinim i drejtpërdrejtë operacional, duke reflektuar një logjikë krejtësisht të ndryshme nga ajo e aktiviteteve ekonomike.

“Modus operandi ndryshon sipas natyrës së aktivitetit, duke reflektuar përshtatje të vazhdueshme ndaj kontekstit kriminal.”

Një dimension tjetër që meriton theks të veçantë është niveli i sofistikimit të modus operandi, i cili varion ndjeshëm ndërmjet rasteve. Në disa raste evidentohet një modus operandi relativisht bazik, me përdorim të metodave të thjeshta dhe teknologjive minimale, por të mjaftueshme për realizimin e aktivitetit kriminal. Në raste të tjera, veçanërisht ato me dimension financiar apo ndërkombëtar, evidentohet një nivel i avancuar sofistikimi, që përfshin përdorim të strukturave ligjore si mbulesë, fragmentim ndërkufitar të aktivitetit dhe integrim të plotë të logjistikës dhe financës. Ky variacion tregon se krimi i organizuar nuk është homogjen, por përbëhet nga struktura me nivele të ndryshme kapaciteti dhe zhvillimi.

“Krimi i organizuar paraqet nivele të ndryshme sofistikimi, nga modele bazike deri te struktura të avancuara dhe profesionale.”

Një element thelbësor që përshkon shumë nga rastet është ndërthurja e komponentëve ligjorë dhe ilegalë brenda modus operandi, veçanërisht në rastet më të avancuara. Përdorimi i kompanive, dokumentacionit formal apo procedurave ligjore si mbulesë për aktivitet kriminal tregon një zhvendosje të krimit të

organizuar drejt formave më të sofistikuara, ku kufiri midis aktivitetit të ligjshëm dhe atij të paligjshëm bëhet gjithnjë e më i paqartë. Ky fenomen është veçanërisht i rëndësishëm, pasi tregon aftësinë e strukturave kriminale për të shfrytëzuar vetë sistemin institucional për të lehtësuar aktivitetin e tyre.

“Strukturat kriminale shfrytëzojnë mekanizmat ligjorë si mbulesë për aktivitetin e tyre.”

Gjithashtu, analiza eidenton një përdorim të qëndrueshëm të rrjeteve të besimit dhe lidhjeve personale si bazë për organizimin dhe funksionimin e aktivitetit kriminal. Në shumë raste, bashkëpunimi ndërmjet anëtarëve mbështetet në lidhje familjare, shoqërore apo komunitare, duke krijuar struktura relativisht të mbyllura dhe rezistente ndaj infiltrimit. Kjo tregon se, pavarësisht zhvillimit të teknikave dhe mekanizmave të avancuar, krimi i organizuar vazhdon të mbështetet në elementë tradicionale të besimit dhe kontrollit social, të cilët përforcojnë qëndrueshmërinë e strukturës.

Një tjetër dimension i rëndësishëm është koordinimi i vazhdueshëm dhe në kohë reale i aktivitetit kriminal, i cili eidentohet përmes komunikimeve të shpeshta dhe sinkronizimit të veprimeve ndërmjet anëtarëve. Ky koordinim mund të jetë i strukturuar dhe i planifikuar në rastet më komplekse, ose më fleksibël dhe dinamik në rastet operative, por në të gjitha rastet ai përbën një element kyç për funksionimin efektiv të aktivitetit kriminal. Kjo tregon se krimi i organizuar operon si një sistem i koordinuar dhe i integruar, ku informacioni dhe komunikimi luajnë një rol qendror.

“Modus operandi paraqitet si një sistem i strukturuar, adaptiv dhe në zhvillim të vazhdueshëm.”

Në tërësi, analiza e modus operandi konfirmon se krimi i organizuar në vendimet e shqyrtuara paraqitet si një sistem i strukturuar, adaptiv dhe në zhvillim të vazhdueshëm, i cili kombinon elementë të organizimit tradicional me teknika moderne operative dhe mekanizma të sofistikuara fshehjeje. Diversiteti i metodave, niveli i ndryshëm i sofistikimit dhe aftësia për t'u përshtatur ndaj rreziqeve tregojnë se strukturat kriminale nuk janë statike, por evoluojnë në mënyrë të vazhdueshme në përgjigje të kushteve të tregut dhe presionit institucional. Kjo e bën analizën e modus operandi një element thelbësor për të kuptuar jo vetëm se çfarë bën krimi i organizuar, por edhe si funksionon dhe si mund të kundërveprohet në mënyrë më efektive ndaj tij.

2.5. Përfshirja në veprimtari të shumta kriminale

Analiza e polikriminalitetit ofron një perspektivë të thelluar mbi shkallën e diversifikimit të veprimtarisë kriminale dhe mbi mënyrën se si strukturat e krimit të organizuar evoluojnë nga modele të thjeshta, të fokusuara në një aktivitet të vetëm, drejt formave më të avancuara të operimit në disa fusha kriminale të ndërlidhura. Në tërësi, gjetjet tregojnë se polikriminaliteti nuk paraqitet si një fenomen homogjen, por si një spektrum i gjerë që varion nga forma të kufizuara dhe të pjesshme, deri te modele të konsoliduara dhe shumëdimensionale, duke reflektuar nivele të ndryshme zhvillimi të grupeve kriminale.

Një nga konstatimet kryesore që del nga analiza është se dominon qartësisht një model i polikriminalitetit të kufizuar, ku aktiviteti kriminal mbetet i përqendruar kryesisht në një sektor të vetëm, në shumicën dërrmuese të rasteve në fushën e narkotikëve, ndërsa veprimet e tjera që shoqërojnë këtë aktivitet janë kryesisht të natyrës mbështetëse dhe instrumentale. Në këto raste, edhe pse evidentohen disa veprime të ndryshme (kultivim, transport, magazinim, shpërndarje, organizim), ato nuk përbëjnë aktivitete kriminale autonome, por pjesë të një cikli të vetëm operacional. Kjo tregon se kemi të bëjmë më shumë me një intensifikim dhe kompleksifikim të një aktiviteti të vetëm, sesa me një diversifikim real në fusha të ndryshme kriminale.

“Dominon një model ku aktiviteti kriminal mbetet i përqendruar në një sektor të vetëm, ndërsa veprimet e tjera janë kryesisht instrumentale.”

Në këtë kuadër, është e rëndësishme të theksohet dallimi thelbësor ndërmjet integritit vertikal dhe diversifikimit horizontal të veprimtarisë kriminale. Shumica e rasteve të analizuara paraqesin një integritim vertikal të zhvilluar, ku grupet kriminale kontrollojnë disa faza të të njëjtit aktivitet, nga prodhimi deri të shpërndarja, por nuk kalojnë në aktivitete të tjera kriminale të pavarura. Ky model reflekton një formë të konsoliduar organizimi brenda një tregu të vetëm kriminal, por jo domosdoshmërisht një zgjerim të portofolit kriminal të grupit.

Megjithatë, përtej këtij dominimi, analiza eidenton edhe raste ku polikriminaliteti shfaqet në forma më të avancuara dhe të konsoliduara. Në këto raste, grupet kriminale nuk kufizohen vetëm në aktivitetin bazë (si narkotikët), por angazhohen paralelisht edhe në aktivitete të tjera kriminale autonome, si pastrimi i produkteve të veprës penale, përdorimi i mekanizmave financiarë për fshehjen e të ardhurave, apo edhe ndërveprimi me aktorë publikë në mënyrë të paligjshme. Këto raste përfaqësojnë një kalim cilësor nga një model mono-kriminal drejt një ekonomie kriminale të integruar, ku aktivitetet e ndryshme nuk janë vetëm të bashkëpranishme, por edhe të ndërvarura dhe të strukturuar në mënyrë strategjike.

“Në disa raste evidentohet një kalim drejt ekonomive kriminale të integruara, ku aktivitetet janë autonome dhe të ndërlidhura.”

Një element shumë i rëndësishëm që del nga analiza është se, edhe në rastet ku polikriminaliteti është i kufizuar, struktura dhe mënyra e funksionimit të grupeve kriminale shpesh tregojnë një potencial të lartë për evoluim drejt formave më të avancuara të diversifikimit kriminal. Ndarja e roleve, organizimi i qëndrueshëm, koordinimi operacional dhe përdorimi i mekanizmave të fshehjes krijojnë një bazë strukturore që mundëson lehtësisht zgjerimin e aktivitetit në fusha të tjera kriminale në të ardhmen. Kjo sugjeron se polikriminaliteti nuk duhet parë vetëm si një gjendje statike, por si një proces dinamik në zhvillim.

Në aspektin funksional, analiza tregon se në rastet e polikriminalitetit të plotë, aktivitetet kriminale janë të lidhura në mënyrë ciklike dhe reciproke. Për shembull, aktiviteti i narkotikëve gjeneron të ardhura të paligjshme, të cilat më pas kanalizohen në aktivitete të pastrimit të parave, duke krijuar një cikël të mbyllur ekonomik kriminal. Në këto raste, kemi të bëjmë me një model të ndërthurur të tregut kriminal dhe ekonomisë kriminale, ku kufijtë ndërmjet fazave të ndryshme bëhen të paqartë dhe aktiviteti kriminal merr një dimension sistemik.

“Aktivitetet kriminale lidhen në mënyrë ciklike, ku gjenerimi i të ardhurave dhe pastrimi i tyre formojnë një sistem të integruar.”

Një tjetër gjetje e rëndësishme lidhet me faktin se në disa raste evidentohet edhe një ndërthurje e dimensionit kriminal me elementë të ndikimit institucional, përmes përfshirjes së aktorëve publikë apo tolerimit të aktivitetit kriminal. Edhe pse këto raste janë më të kufizuara në numër, ato përfaqësojnë nivelin më të lartë të rrezikshmërisë, pasi tregojnë një kapacitet të grupeve kriminale për të depërtuar në struktura që duhet të funksionojnë si mekanizma kontrolli.

“Në raste të veçanta, polikriminaliteti shoqërohet me elementë të ndikimit institucional.”

Nga një perspektivë krahasuese ndërmjet rasteve, evidentohet qartë një diferencim ndërmjet grupeve që operojnë si struktura të specializuara në një aktivitet të vetëm, me efikasitet të lartë operacional, por pa diversifikim dhe grupeve që operojnë si platforma kriminale shumëfunktionale, të afta për të menaxhuar disa aktivitete kriminale paralelisht. Ky diferencim është thelbësor për të kuptuar nivelin e zhvillimit të krimit të organizuar, pasi kalimi nga një model në tjetrin përfaqëson një rritje të ndjeshme të kapaciteteve kriminale dhe të rrezikut për ekonominë dhe institucionet.

Një dimension tjetër që meriton vëmendje është raporti ndërmjet kompleksitetit dhe polikriminalitetit. Analiza tregon se kompleksiteti i lartë i një aktiviteti kriminal nuk përkthehet automatikisht në polikriminalitet. Shumë nga rastet paraqesin struktura të ndërlikuara, me ndarje rolesh dhe koordinim të avancuar, por që

mbeten të kufizuara në një fushë të vetme kriminale. Kjo nënvizon nevojën për të bërë dallimin analitik ndërmjet një aktiviteti kompleks dhe një aktiviteti të diversifikuar.

Gjithashtu, analiza eidenton se në rastet e polikriminalitetit të plotë, grupet kriminale shfaqin një logjikë të qartë strategjike, ku diversifikimi i aktiviteteve nuk është rastësor, por i orientuar drejt maksimizimit të fitimit dhe minimizimit të rrezikut. P.sh., përfshirja në pastrim parash nuk është një aktivitet i izoluar, por një domosdoshmëri funksionale për të garantuar përdorimin dhe riinvestimin e të ardhurave kriminale.

“Kompleksiteti i aktivitetit kriminal nuk përbën domosdoshmërisht polikriminalitet.”

Analiza e polikriminalitetit tregon se krimi i organizuar karakterizohet kryesisht nga një dominim i modeleve të kufizuara dhe të përqendruara, por me prezencë të dukshme të rasteve që përfaqësojnë faza më të avancuara të zhvillimit kriminal. Kjo krijon një panoramë të ndërmjetme, ku krimi i organizuar nuk është ende në mënyrë dominuese shumëdimensional, por ka elementë të qartë që tregojnë një tendencë drejt diversifikimit dhe integritit të aktiviteteve kriminale në modele më komplekse dhe më të rrezikshme. Në këtë kuptim, polikriminaliteti del si një indikator kyç për të vlerësuar jo vetëm kompleksitetin e veprimtarisë kriminale, por edhe fazën e zhvillimit të strukturave kriminale, duke shërbyer si një element thelbësor për orientimin e politikave penale dhe administrative në luftën kundër krimi të organizuar.

2.6. Vlera e mallrave të ligjshme/paligjshme

Analiza e vlerës së mallrave të ligjshme dhe të paligjshme ofron një panoramë të detajuar mbi dimensionin ekonomik të veprimtarisë kriminale dhe mbi mënyrën se si krimi i organizuar materializohet në forma konkrete pasurore, qoftë në produkte të drejtpërdrejta të aktivitetit kriminal, qoftë në pasuri të krijuara ose të përdorura për të mbështetur dhe maskuar këtë aktivitet. Në tërësi, gjetjet tregojnë se dimensionin financiar dhe pasuror përbën një element thelbësor të strukturës së veprimtarisë kriminale, duke reflektuar jo vetëm nivelin e fitimit, por edhe shkallën e organizimit, qëndrueshmërisë dhe ndikimit të saj në ekonomi.

Analiza eidenton një variacion të dukshëm ndërmjet rasteve për sa i përket nivelit të vlerës së përfshirë. Në disa raste, aktiviteti kriminal karakterizohet nga vlera relativisht të kufizuara, duke reflektuar ose një shkallë më të ulët zhvillimi të grupit kriminal, ose një fazë fillestare të aktivitetit. Në këto raste, edhe pse aktiviteti mund të jetë i organizuar, ndikimi i tij ekonomik mbetet më i kufizuar dhe nuk arrin të krijojë një bazë të qëndrueshme pasurore.

Në anën tjetër, një pjesë e rasteve paraqesin vlera më të larta dhe të diversifikuara të asetëve, duke reflektuar një nivel më të avancuar të operimit kriminal. Në këto raste, aktiviteti kriminal nuk gjeneron vetëm produkte të paligjshme, por shoqërohet me akumulim dhe menaxhim të pasurive në forma të ndryshme, duke përfshirë edhe investime në sektorë të ligjshëm. Ky fenomen tregon një kalim nga një model i thjeshtë i përfitimit kriminal drejt një modeli të integruar ekonomik, ku të ardhurat kriminale riinvestohen dhe përdoren për të zgjeruar aktivitetin ose për të garantuar stabilitetin e tij.

Një element shumë i rëndësishëm që del nga analiza është ndërthurja ndërmjet mallrave të paligjshme dhe atyre të ligjshme brenda të njëjtës veprimtari kriminale. Në shumë raste, aktiviteti kriminal nuk operon në izolim, por përdor mjete dhe struktura të ligjshme për të mbështetur dhe fshehur aktivitetin e paligjshëm. Kjo ndërthurje krijon një zonë gri ndërmjet ekonomisë formale dhe asaj informale, duke e bërë më të vështirë identifikimin dhe goditjen e aktivitetit kriminal.

Në këtë kuadër, një dimension kyç është përdorimi i asetëve të ligjshme si instrument për realizimin ose maskimin e aktivitetit kriminal. Këto mund të përfshijnë biznese, pasuri të paluajtshme, apo mjete financiare që përdoren për të kanalizuar të ardhurat e paligjshme. Ky fenomen lidhet drejtpërdrejt me proceset e pastrimit të parave dhe me krijimin e një infrastrukture ekonomike që mbështet aktivitetin kriminal në mënyrë të qëndrueshme.

“Ndërthurja e mallrave të ligjshme dhe të paligjshme krijon një zonë gri ndërmjet ekonomisë formale dhe asaj informale. Asetet e ligjshme përdoren si instrument për realizimin dhe maskimin e aktivitetit kriminal. Pasuria e krijuar nga aktiviteti kriminal përdoret për të fuqizuar dhe zgjeruar më tej këtë aktivitet.”

Nga një perspektivë funksionale, analiza tregon se vlera e mallrave dhe asetëve nuk është vetëm rezultat i aktivitetit kriminal, por edhe një mjet për fuqizimin dhe zgjerimin e tij. Asetet e akumuluar përdoren për të financuar aktivitete të tjera kriminale, për të siguruar logjistikë, apo për të krijuar avantazhe konkurruese në tregjet ilegale. Kjo krijon një cikël të vetëpërforsues, ku aktiviteti kriminal gjeneron pasuri, dhe kjo pasuri përdoret për të zgjeruar më tej aktivitetin.

Një tjetër gjetje e rëndësishme lidhet me faktin se në disa raste evidentohet një mungesë e plotë ose e pjesshme e të dhënave mbi vlerën reale të asetëve, çka kufizon mundësinë për të vlerësuar plotësisht ndikimin ekonomik të aktivitetit kriminal. Kjo mungesë mund të lidhet me natyrën e fshehtë të aktivitetit, me vështirësitë hetimore, ose me fokusin e kufizuar të vendimeve gjyqësore në aspektin penal, pa hyrë në detaje të thelluara mbi dimensionin ekonomik.

Nga analiza krahasuese ndërmjet rasteve, evidentohet një diferencim i qartë ndërmjet rasteve ku aktiviteti kriminal ka një impakt të kufizuar ekonomik, me vlera të ulëta dhe pa akumulim të konsiderueshëm pasurie dhe rasteve ku aktiviteti paraqet një impakt të lartë ekonomik, me vlera të konsiderueshme dhe me prani të asetëve të ndryshme që tregojnë një strukturë të konsoliduar financiare. Ky diferencim është thelbësor për të kuptuar jo vetëm nivelin e rrezikshmërisë së aktivitetit kriminal, por edhe potencialin e tij për të ndikuar në ekonomi dhe për të deformuar tregjet.

Një dimension tjetër i rëndësishëm është lidhja ndërmjet vlerës së asetëve dhe nivelit të organizimit kriminal. Në përgjithësi, rastet me vlera më të larta të asetëve shoqërohen me struktura më të organizuara, me ndarje rolesh dhe me një planifikim më të avancuar të aktivitetit. Kjo sugjeron se dimensionin ekonomik nuk është një element i izoluar, por i lidhur ngushtë me kompleksitetin dhe kapacitetin organizativ të grupeve kriminale.

Në të njëjtën kohë, analiza tregon se edhe në raste me vlera më të ulëta, mund të ekzistojë një strukturë e organizuar, çka nënvizon se vlera ekonomike nuk është gjithmonë tregues i vetëm i rrezikshmërisë, por duhet parë në kombinim me faktorë të tjerë si struktura, shtrirja dhe modus operandi.

Në përmbledhje, analiza e vlerës së mallrave të ligjshme dhe të paligjshme tregon një panoramë të ndërmjetme, ku aktiviteti kriminal karakterizohet nga një variacion i gjerë në nivelin e impaktit ekonomik, por me një tendencë të qartë drejt akumulimit dhe përdorimit të pasurive si element kyç i funksionimit të tij. Kjo e bën dimensionin ekonomik një komponent thelbësor për të kuptuar jo vetëm natyrën e aktivitetit kriminal, por edhe ndikimin e tij në ekonomi dhe në strukturat institucionale.

Në këtë kuptim, vlera e mallrave dhe asetëve del si një indikator kritik për të vlerësuar fuqinë ekonomike të krimit të organizuar, potencialin e tij për të infiltruar ekonominë formale dhe nevojën për mekanizma më të avancuar për identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive me origjinë kriminale.

3. Analiza e dimensionit financiar dhe pasuror: hetimet financiare, sekuestrimi dhe konfiskimi

Fenomenet e korrupsionit dhe krimit të organizuar karakterizohen nga flukse të konsiderueshme financiare, ndërthurje mes aktorëve publikë dhe privatë dhe ndikim të drejtpërdrejtë në tregje të caktuara. Në këtë kuadër, hetimet financiare, pasurore dhe proaktive marrin një rol qendror, duke u shndërruar në një instrument thelbësor për të adresuar dimensionin ekonomik të kriminalitetit dhe pasojat e tij konkrete në ekonomi. Korrupsioni dhe krimi i organizuar nuk prodhojnë vetëm pasoja penale, por gjenerojnë flukse të konsiderueshme financiare që depërtojnë në ekonomi, shpesh përmes sektorëve me rrezik të lartë si ndërtimi, prokurimet publike, aktivitetet tregtare apo investimet me intensitet të lartë kapitali. Këto flukse jo vetëm që deformojnë konkurrencën e ndershme, por krijojnë edhe një ekonomi paralele që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, në besimin e publikut dhe në funksionimin e institucioneve. Në këtë kontekst, hetimi financiar dhe pasuror nuk është thjesht një instrument teknik, por një mekanizëm kyç për të kuptuar dhe ekspozuar këtë ndikim.

Shqipëria vijon të përballlet me nivele të konsiderueshme të tregjeve kriminale dhe aktiviteteve që gjenerojnë përfitime të larta ekonomike, duke përfshirë trafikun e drogës, krimet financiare dhe evazionin fiskal. Një nga karakteristikat kryesore të këtij fenomeni në Shqipëri është prania e flukseve të konsiderueshme financiare të paligjshme, të cilat qarkullojnë si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Vlerësimet tregojnë se daljet e paligjshme financiare përbëjnë rreth 2.16% të PBB-së, ndërsa hyrjet arrijnë në 0.84%, çka tregon një shkallë të lartë të ndërveprimit të ekonomisë shqiptare me kapitalin me origjinë të dyshimtë.²⁸ Një analizë e GI-ACE, theksohet se flukset e paligjshme financiare ushqejnë korrupsionin, gërryejnë legjitimitetin e shtetit, nxisin kapjen e institucioneve dhe dekurajojnë investimin.²⁹

Këto flukse janë të lidhura ngushtë me aktivitetet e krimit të organizuar, ku trafiku i drogës mbetet burimi kryesor i përfitimeve për dekada, ndërsa korrupsioni përbën një nga burimet kryesore dytësore të gjenerimit të të ardhurave të paligjshme. Dimensioni ekonomik i këtij fenomeni bëhet edhe më i dukshëm nëpërmjet ndikimit të tij në tregjet dhe sektorët strategjikë. Sektorë si ndërtimi, pasuritë e paluajtshme dhe investimet turistike identifikohen si veçanërisht të ekspozuar ndaj pastrimit të parave dhe riciklimit të kapitalit të paligjshëm. Rritja e vazhdueshme e çmimeve në tregun imobiliar, shpesh e pashpjegueshme plotësisht nga faktorët ekonomikë tradicionalë, reflekton në mënyrë indirekte praninë e këtyre flukseve financiare, të cilat depërtojnë në ekonomi dhe shtrembërojnë mekanizmat e tregut.

Në këtë kuadër, hetimet financiare, pasurore dhe proaktive marrin një rëndësi të veçantë, pasi ato përfaqësojnë mekanizmin kryesor për të bërë të dukshme këtë

²⁸ Global Initiative Against Transnational Organized Crime, Dardan Koçani dhe Anesa Agović, *Illicit Financial Flows in Albania* (Geneva: Global Initiative Against Transnational Organized Crime, March 2024), <https://see.globalinitiative.net/hotspots/iffs/reports/albania.pdf>

²⁹ Center for the Study of Democracy, *Illicit Financial Flows and Strategic Corruption*, Policy Brief No. 157 (GI-ACE Programme, 2025), https://giace.org/wp-content/uploads/2025/10/BRIEF_157_ENG_WEB_231025.pdf

ekonomi të fshehur dhe për të matur ndikimin real të saj. Megjithatë, pavarësisht progresit të bërë në forcimin e kuadrit ligjor dhe institucional, sfidat mbeten të konsiderueshme. Hetimet për pastrim parash shpesh trajtohen si të lidhura me veprën penale kryesore dhe jo si aktivitete autonome, ndërkohë që numri i dënimeve për këtë veprë mbetet i kufizuar. Po ashtu, megjithëse janë rritur rastet e sekuestrimit të pasurive, efektiviteti në konfiskimin përfundimtar dhe në identifikimin e pasurive jashtë vendit mbetet i kufizuar. Këto elemente tregojnë se potenciali i plotë i hetimeve financiare ende nuk është shfrytëzuar në mënyrë sistematike.

Vlerësimet e Komisioni Evropian në raportet e progresit evidentojnë se panorama e hetimeve financiare në Shqipëri paraqitet si një fushë ku ka pasur zhvillime të dukshme, por që vijon të përballet me sfida strukturore dhe metodologjike të rëndësishme.

Në mënyrë të përgjithshme, gjatë dy viteve të fundit evidentohet një rritje graduale e kapaciteteve të SPAK në hetimet financiare, e shoqëruar me një përdorim më sistematik të këtyre hetimeve dhe të mekanizmave të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive. Kjo qasje reflekton një orientim më të qartë drejt goditjes së dimensionit ekonomik të krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke e konsideruar ndjekjen e rrjedhës së parave si një komponent thelbësor të hetimit penal.³⁰

Një zhvillim i rëndësishëm lidhet me konsolidimin e njësisë së hetimeve financiare brenda SPAK, e cila ka filluar të prodhojë rezultate konkrete, përfshirë edhe në bashkëpunimin ndërkombëtar. Po ashtu, është përmirësuar ndjeshëm aksesimi në databaza shtetërore (deri në 19 të tilla), çka ka rritur potencialin për analizë financiare dhe gjurmim të aseteve. Megjithatë, raportet theksojnë se kapacitetet analitike dhe metodologjike të hetimit financiar mbeten ende të pamjaftueshme, sidomos për çështje komplekse dhe për analizën e të dhënave në shkallë të gjerë.

Nga ana tjetër, një nga problematikat më të qëndrueshme që evidentohet është fakti se hetimet financiare nuk shoqërojnë në mënyrë sistematike procedimet penale që nga fazat e hershme. Kjo kufizon efektivitetin e tyre dhe redukton potencialin për identifikimin dhe konfiskimin e pasurive të paligjshme. Për më tepër, edhe pse ka pasur progres në konfiskim, niveli i sekuestrimeve dhe konfiskimeve nuk ka një rritje të ndjeshme në raport me shkallën e fenomenit.

Një tjetër boshllëk i rëndësishëm lidhet me mungesën e një qasjeje strategjike dhe të koordinuar për identifikimin dhe konfiskimin e aseteve jashtë vendit, si dhe për trajtimin e pasurive të fshehura apo të transferuara në juridiksione të tjera. Po kështu, mbetet sfidë zbatimi efektiv i mekanizmave si konfiskimi i zgjeruar, konfiskimi ndaj palëve të treta dhe ngrirja parandaluese e pasurive, të cilat janë thelbësore për të parandaluar humbjen e vlerës ekonomike të tyre.

³⁰ European Commission, *Albania 2025 Report*, SWD(2025) 750 final (Brussels: European Commission, 4 November 2025), https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en?filename=albania-report-2025.pdf
European Commission, *Albania 2024 Report*, SWD(2024) 690 final (Brussels: European Commission, 30 October 2024), https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf

Raportet evidentojnë gjithashtu nevojën për përshtatjen e teknikave hetimore me zhvillimet teknologjike, veçanërisht në drejtim të identifikimit dhe administrimit të provave digjitale, kriptomonedhave dhe aseteve virtuale, për të cilat aktualisht mungojnë kapacitetet dhe infrastruktura e nevojshme (p.sh., mungesa e një portofoli shtetëror digjital për menaxhimin e tyre).

Në nivel më të gjerë institucional, problematika shtrihet edhe përtej SPAK, pasi prokuroritë e rretheve vazhdojnë të kenë mungesa në staf, trajnim dhe burime, duke kufizuar aftësinë për analizë financiare në çështje komplekse, duke krijuar një hendek të dukshëm në qasjen e përgjithshme të sistemit ndaj hetimeve financiare.

Nga ana tjetër, pastrimi i parave përbën një nga mekanizmat më kritikë që mundëson funksionimin dhe zgjerimin e krimit të organizuar, duke shërbyer si ura lidhëse ndërmjet ekonomisë informale dhe asaj formale. Në thelb, ai konsiston në transformimin e të ardhurave të përfituara nga veprimtari kriminale në asete që paraqiten si të ligjshme, duke e bërë të vështirë identifikimin e origjinës së tyre dhe duke krijuar mundësi për riinvestim dhe konsolidim të mëtejshëm të aktiviteteve kriminale.

Në kontekstin e Ballkanit Perëndimor, dhe në mënyrë të veçantë në Shqipëri, pastrimi i parave nuk është një fenomen i izoluar, por një komponent strukturor i ekonomisë kriminale, i lidhur ngushtë me tregjet e paligjshme, korrupsionin dhe ekonominë informale. Rajoni karakterizohet nga një kombinim faktorësh që rrisin ndjeshëm ekspozimin ndaj këtij fenomeni, përfshirë dobësitë institucionale, mbikëqyrjen e kufizuar financiare dhe ndërthurjen e interesave kriminale me ato politike dhe ekonomike.³¹

Flukset financiare të paligjshme gjenerohen kryesisht nga tregje kriminale të konsoliduara, si trafiku i drogës, armëve, qenieve njerëzore dhe kontrabanda e migrantëve, por edhe nga evazioni fiskal dhe korrupsioni në sektorin publik. Shqipëria, për shkak të pozicionit të saj gjeografik dhe rolit si vend tranzit dhe operimi për rrjete ndërkombëtare kriminale, luan një rol të rëndësishëm në këtë arkitekturë. Veçanërisht, aktivitetet e lidhura me trafikun e drogës, përfshirë kanabisin dhe kokainën, gjenerojnë të ardhura të konsiderueshme, të cilat më pas kanalizohen drejt ekonomisë formale përmes mekanizmave të pastrimit të parave. Këto të ardhura shpesh rikthehen në vend për t'u investuar në sektorë strategjikë, duke krijuar një cikël të mbyllur të kriminalitetit dhe kapitalit.

Në nivel konceptual, procesi i pastrimit të parave përshkruhet përmes tre fazave klasike: vendosja (placement), shtresëzimi (layering) dhe integrimi (integration). Megjithatë, në praktikë, këto faza shpesh ndërthuren ose zhvillohen paralelisht, duke reflektuar një nivel të lartë fleksibiliteti dhe adaptimi nga ana e rrjeteve kriminale.³²

³¹ Global Initiative Against Transnational Organized Crime, Anesa Agović, *Washing Away Crime: Money Laundering in the Western Balkans* (Geneva: Global Initiative Against Transnational Organized Crime, July 2025), <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2025/07/Anesa-Agovic-Washing-away-crime-Money-laundering-in-the-Western-Balkans-GI-TOC-July-2025.pdf>

³² Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), *Raporti Vjetor 2025* (Tiranë: SPAK, 2026), https://spak.gov.al/wp-content/uploads/2026/03/Raporti-vjetor-2025_SPAK.pdf

Në rajon, dhe veçanërisht në Shqipëri, janë identifikuar disa tipologji dominante: përdorimi i transaksioneve në cash dhe depozitave të fragmentuara (structuring) për të shmangur raportimin; krijimi i strukturave komplekse korporative (corporate layering) për të fshehur pronësinë reale; përdorimi i faturave dhe kontratave fiktive për të justifikuar lëvizjet financiare; skema të bazuara në kredi dhe hua të rreme (loan-back schemes); manipulimi i tregut të pasurive të paluajtshme, përmes mbivlerësimit, nënvlerësimit ose shitjeve fiktive.³³

Një element i rëndësishëm është se këto metoda nuk operojnë të izoluara, por në kombinim, duke krijuar zinxhirë kompleksë financiarë që e bëjnë shumë të vështirë ndjekjen e origjinës së fondeve. Një nga gjetjet më të rëndësishme lidhet me rolin dominues të sektorëve të ndërtimit dhe pasurive të paluajtshme në pastrimin e parave. Në Shqipëri dhe në rajon, këta sektorë paraqesin një kombinim unik faktorësh që i bëjnë veçanërisht tërheqës: përdorimi i lartë i cash-it; mungesa e kërkesave rigoroze për verifikimin e burimit të kapitalit; mundësia për të manipuluar vlerat e pronave dhe kontratat. Në praktikë, është e mundur që investime të konsiderueshme në ndërtim të realizohen pa prova të qarta mbi burimin e fondeve, ndërsa shitja e mëvonshme e pronave shërben si mekanizëm për “legalizimin” e kapitalit të paligjshëm. Ky fenomen është i lidhur gjithashtu me dyshime për përfshirjen e aktorëve publikë në dhënien e lejeve dhe në favorizimin e projekteve të caktuara.

Një dimension kritik i pastrimit të parave është përfshirja e “facilitatorëve profesionalë”, si avokatë, noterë, kontabilistë dhe aktorë të tjerë financiarë. Këta aktorë, edhe pse jo gjithmonë të përfshirë drejtpërdrejt në aktivitetin kriminal, luajnë një rol kyç në ndërtimin dhe funksionimin e skemave të pastrimit të parave, duke ofruar ekspertizë ligjore dhe financiare për të shmangur zbulimin. Në disa raste, bashkëpunimi i tyre me individë brenda institucioneve financiare ose të zbatimit të ligjit krijon një rrjet të integruar që e vështirëson ndjeshëm ndërhyrjen efektive të autoriteteve.³⁴

Korrupsioni përbën një faktor transversal që ndikon drejtpërdrejt në eficiencën e luftës kundër pastrimit të parave. Në Shqipëri, korrupsioni në nivele të ndryshme të administratës publike dhe sistemit të drejtësisë krijon kushte për: infiltrimin e krimit në institucione; pengimin e hetimeve financiare; uljen e numrit të ndjekjeve penale dhe dënimeve efektive. Kjo situatë minon besimin publik dhe krijon një perceptim të përhapur të pandëshkueshmërisë, duke e bërë pastrimin e parave jo vetëm një problem ekonomik, por edhe një sfidë serioze për shtetin e së drejtës.

Një tjetër faktor kyç është madhësia e konsiderueshme e ekonomisë informale në Shqipëri. Përdorimi i gjerë i cash-it dhe mungesa e dokumentimit të plotë të transaksioneve krijojnë një ambient ideal për integrimin e fondeve të paligjshme në

³³ Global Initiative Against Transnational Organized Crime, Anesa Agović, *Washing Away Crime: Money Laundering in the Western Balkans* (Geneva: Global Initiative Against Transnational Organized Crime, July 2025), <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2025/07/Anesa-Agovic-Washing-away-crime-Money-laundering-in-the-Western-Balkans-GI-TOC-July-2025.pdf>

³⁴ Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG), *Vlerësim Bazë: Qasja administrative kundër krimit të organizuar në Shqipëri: Koordinimi strategjik dhe potenciali i instrumentave administrativë për adresimin e krimit të organizuar* (Tiranë: CSDG, 2026), https://csdgalbania.org/publications/Vleresim_Baze_Qasja_Administrative.pdf

ekonominë formale. Kjo ndërthurje midis ekonomisë informale dhe aktiviteteve kriminale e bën shumë të vështirë dallimin ndërmjet kapitalit të ligjshëm dhe atij të paligjshëm, duke rritur kompleksitetin e hetimeve financiare.

Nga ana tjetër, zhvillimet teknologjike dhe dinamika globale kanë sjellë forma të reja të pastrimit të parave. Përdorimi i kriptomonedhave, komunikimeve të enkriptuara dhe platformave digjitale po rrit ndjeshëm kapacitetin e rrjeteve kriminale për të operuar në mënyrë të fshehtë dhe ndërkufitare, ndërkohë që mungojnë kapacitetet për adresimin e tyre.³⁵

Specifikisht, volumi i hetimeve pasurore ka shënuar një rënie nga 17 procedime në vitin 2024 në 13 në vitin 2025. Megjithatë, interpretimi i këtij treguesi kërkon një lexim përtej dimensionit numerik, duke marrë në konsideratë logjikën ligjore dhe metodologjike mbi të cilën ndërtohet aktivizimi i hetimeve pasurore. Në analizën e kuadrit ligjor që rregullon hetimet pasurore dhe masat e konfiskimit në Shqipëri, një element me rëndësi thelbësore për diskutim është mungesa e një pragu financiar të përcaktuar (threshold) si kriter formal për aktivizimin e këtyre mekanizmave.

Në bazë të Ligji nr. 10192/2009 dhe dispozitave përkatëse të Kodit Penal, ndërhyrja e prokurorisë në drejtim të hetimit pasuror nuk kushtëzohet nga arritja e një vlere të caktuar monetare të pasurisë apo përfitimit kriminal. Sistemi është ndërtuar mbi një logjikë substanciale, e cila mbështetet në identifikimin e lidhjes midis pasurisë dhe aktivitetit kriminal, si dhe në ekzistencën e një disproporcionaliteti të dukshëm ndërmjet pasurisë së deklaruar dhe burimeve të ligjshme të të ardhurave. Në këtë kuptim, aktivizimi i hetimit pasuror nuk është funksion i madhësisë nominale të pasurisë, por i natyrës së dyshimit dhe cilësisë së provave që sugjerojnë origjinën e saj të paligjshme.

Kjo qasje përputhet në mënyrë të konsiderueshme me standardet e përcaktuara në Directive (EU) 2024/1260, e cila nuk imponon një prag financiar të detyrueshëm në nivel të Bashkimit Evropian, por i lë shteteve anëtare hapësirë për të vendosur pragje të tilla ose për të operuar mbi bazën e një vlerësimi rast pas rasti. Megjithatë, direktiva vendos një kriter të rëndësishëm unifikues në lidhje me seriozitetin e veprës penale, duke kufizuar, ndër të tjera, mundësinë e konfiskimit të pasurisë së pajustificuar në kuadër të hetimeve që lidhen me vepra të dënueshme me të paktën katër vite burgim. Kjo nënvizon se, në nivel evropian, fokusi nuk është vendosur mbi një prag financiar, por mbi gravitetin penal dhe impaktin e veprës.

Në praktikë, kjo do të thotë se si në Shqipëri, ashtu edhe në BE, sistemi i hetimeve pasurore funksionon mbi një qasje të bazuar në risk dhe në impakt, ku autoritetet kompetente kanë diskrecion për të vlerësuar nëse një rast i caktuar justifikon ndërhyrje të thelluar, pavarësisht nga vlera absolute e pasurisë së përfshirë.

³⁵ Global Initiative Against Transnational Organized Crime, “Seizing Crime-Related Virtual Assets Remains a Challenge in the Western Balkans,” *Risk Bulletin: Observatory of Illicit Economies in South Eastern Europe*, Issue 21 (May 2025), <https://riskbulletins.globalinitiative.net/see-obs-021/03-seizing-crime-related-virtual-assets-remains-challenge-in-western-balkans.html>

Global Initiative Against Transnational Organized Crime, “Balkan Countries Lack the Tools and Drive to Combat Crypto Fraud,” *Risk Bulletin: Observatory of Illicit Economies in South Eastern Europe*, Issue 22 (December 2025), <https://riskbulletins.globalinitiative.net/see-obs-022/02-balkan-countries-lack-tools-and-drive-to-combat-crypto-fraud.html>

Megjithatë, në nivel operacional, institucionet shpesh aplikojnë në mënyrë implicite pragje orientuese për prioritizimin e rasteve, duke u fokusuar në ato që paraqesin vlera të larta ekonomike, kompleksitet të shtuar dhe potencial më të madh për ndikim në treg dhe në integritetin institucional.

Pikërisht në këtë pikë lind edhe një dimension kritik për diskutim mbi mungesa e një pragu të qartë ligjor krijon fleksibilitet dhe lejon një reagim më të përshtatshëm ndaj formave të ndryshme të kriminalitetit ekonomik, por njëkohësisht rrit rëndësinë e praktikës institucionale dhe të kapaciteteve profesionale të organeve të hetimit në përcaktimin e prioriteteve. Në mungesë të kriterëve të standardizuara, ekziston rreziku që përzgjedhja e rasteve të ndikohet nga faktorë të ndryshëm operacionalë ose subjektivë, duke e bërë transparencën dhe konsistencën e vendimmarrjes një element kyç për llogaridhënien institucionale.

Në këtë kontekst, përfshirja e analizave që përdorin kategori financiare orientuese (si p.sh. ndarja e rasteve sipas niveleve të impaktit ekonomik) duhet kuptuar si një instrument analitik që ndihmon në kuptimin më të qartë të mënyrës se si autoritetet, në praktikë, strukturojnë prioritetet e tyre hetimore. Kjo qasje jo vetëm që është në përputhje me fleksibilitetin e lejuar nga kuadri evropian, por gjithashtu kontribuon në ndërtimin e një analize më të thelluar mbi efektivitetin dhe orientimin strategjik të hetimeve financiare dhe pasurore në Shqipëri.

Në kuadër të ligjit Anti-Mafia, në vitin 2025 evidentohet një nivel më i ulët i konfiskimeve krahasuar me vitin 2024. E njëjta tendencë konfirmohet edhe në kuadër të procesit penal, ku në vitin 2025 evidentohet një rritje e konsiderueshme e volumit dhe diversitetit të pasurive të sekuestruara (pasuri të paluajtshme, llogari bankare, subjekte tregtare), por një nivel relativisht i ulët konfiskimi (1.09 milionë euro). Në kontrast, viti 2024 paraqet një profil të kundërt: më pak sekuestime, por konfiskime shumë më të larta dhe më të konsoliduara financiarisht, duke përfshirë edhe asete të konsiderueshme monetare dhe kriptovaluta.

Ndërkohë, hetimet financiare janë vendosur si një prioritet i mirëfilltë institucional i Prokurorisë së Posaçme, me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale në këtë fushë. Miratimi i Udhëzimit nr. 1093 për hetimet financiare dhe pasurore vendos një kuadër të standardizuar metodologjik dhe institucional për zhvillimin e tyre, formalizuar praktikën e hetimeve paralele dhe forcuar koordinimin ndërmjet strukturave përkatëse.³⁶ Gjithashtu raportohet se fokusi është vendosur në trajnimin dhe ngritjen e ekspertizës në fusha si analiza financiare dhe kriptovalutat, ndërsa evidentohet një zgjerrim i përdorimit të teknologjive të avancuara, përfshirë analizën e të dhënave, instrumentet e inteligjencës së hapur (OSINT), si dhe monitorimin e transaksioneve në blockchain. Raportet vjetore të SPAK raportojnë për një forcim të bashkëpunimit ndërkombëtar, veçanërisht në kuadër të

³⁶ Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), *Udhëzim i përgjithshëm nr. 1093, datë 11.11.2024 "Për masat administrative dhe proceduriale për kryerjen e hetimit financiar dhe pasuror në Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar"* (Tiranë: SPAK, 2024), <https://spak.gov.al/wp-content/uploads/2024/11/Udhëzim-i-pergjithshem-nr-1093-date-11.11.2024-Masat-administrative-dhe-proceduriale-per-kryerjen-e-hetimit-financiar-dhe-pasuror-ne-strukturen-e-Posacme-Kunder-Korrupsionit-dhe-Krimit-te-Organizuar.pdf>

mekanismave si Europol dhe EMPACT, duke mundësuar trajtimin më efektiv të skemave financiare ndërkufitare.

Megjithatë, pavarësisht se raportohet për përdorimin e hetimeve financiare në mënyrë sistematike për të gjitha kategoritë e veprave penale, duke synuar jo thjesht rritjen e volumit të hetimeve, por goditjen e strukturave kriminale përmes analizës së thelluar të flukseve financiare dhe identifikimit të pasurive me vlerë të lartë, analiza e rezultateve tregon një mospërputhje ndërmjet intensitetit të hetimeve financiare dhe rezultateve përfundimtare në rikuperimin e aseteve. Sikurse evidentohet më poshtë, ndërsa në vitin 2024 ka një nivel më të lartë konfiskimesh dhe një vlerë të konsiderueshme asetesh të rikuperuara, në vitin 2025 vihet re një dominim i sekuestrimeve dhe një nivel më i kufizuar i konfiskimeve përfundimtare.

Në aspektin e pastrimit të produkteve të veprës penale, të dhënat tregojnë një rënie të ndjeshme të procedimeve (32 raste në 2025 kundrejt 47 në 2024). Një pjesë e konsiderueshme e rasteve vijon të jetë e lidhur me krimin e organizuar dhe korrupsionin, megjithatë, rënia e peshës relative të rasteve të lidhura me krimin e organizuar (nga 46.5% në 24.3%) sugjeron një fragmentim më të madh të tipologjive të pastrimit të parave, ose një zgjerim të fokusit drejt formave të tjera të kriminalitetit financiar.

Një tregues kyç për të kuptuar efektivitetin e përgjithshëm është vlera totale e aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara. Në vitin 2025 kjo vlerë arrin në rreth 45.4 milionë euro, duke shënuar një rënie krahasuar me 65.5 milionë euro në vitin 2024. Por ajo që është më domethënëse nuk është vetëm rënia në total, por ndryshimi drastik në strukturë: në vitin 2025, 96% e kësaj vlere përbëhet nga sekuestrime dhe vetëm 4% nga konfiskime, ndërsa në vitin 2024 raporti ishte pothuajse i përbysur (56.2% konfiskime).

Nga këndvështrimi i shpërndarjes së aseteve, viti 2025 dominohet qartësisht nga krimi i organizuar, i cili përbën pjesën dërrmuese të vlerës së sekuestruar dhe konfiskuar. Ndërkohë, në vitin 2024 një pjesë shumë më e madhe e aseteve lidhej me zyrtarë të nivelit të lartë.

Në aspektin e bazës ligjore, të dy vitet karakterizohen nga dominimi i instrumenteve të Kodit të Procedurës Penale (rreth 66-68%), duke konfirmuar se qasja mbetet kryesisht penale. Megjithatë, roli i ligjit Anti-Mafia mbetet i rëndësishëm dhe relativisht i qëndrueshëm, duke shërbyer si një instrument plotësues për ndërhyrje më fleksibile në pasuri.

Në tërësi, gjetjet tregojnë se pavarësisht përpjekjeve në drejtim të konsolidimit dhe forcimit të kapaciteteve për identifikimin dhe ndërhyrjen mbi pasuritë me origjinë kriminale, ekziston një hendek në rritje midis fazës së sekuestrimit dhe asaj të konfiskimit. Ky hendek përbën një nga sfidat kryesore në drejtim të efektivitetit të përgjithshëm të sistemit, duke theksuar nevojën për forcimin e mekanizmave që mundësojnë finalizimin e procedurave dhe rikuperimin real të aseteve.

Tabela 1: Krimi ekonomik: Hetimet financiare, pasurore dhe masat ndaj pasurisë / Prokuroria e Posaçme (2025 vs 2024)

Elementi i analizës		Viti 2025	Viti 2024	Gjetje të vlerësimit
Hetimet pasurore	Volumi i hetimeve pasurore	Procedime pasurore: 13	Procedime pasurore: 17	Vërehet rënie e lehtë e procedimeve pasurore në vitin 2025.
	Sekuestrim & konfiskim sipas ligjit Anti-Mafia	Sekuestrim: 14.69 mln € Konfiskim: 0.81 mln €	Sekuestrim: 1.24 mld lekë Konfiskim: 419 mln lekë	Mekanizmat e Ligjit Anti-Mafia vijojnë të përdoren në mënyrë të qëndrueshme, por në vitin 2025 evidentohet një nivel më i ulët i konfiskimeve.
	Sekuestrim & konfiskim në proces penal	Sekuestrim: 16.42 mln € (113 pasuri të paluajtshme, 35 të luajtshme, 13 subjekte, 92 llogari bankare, 1.5 mln €); Konfiskim: 1.09 mln € (15 pasuri të paluajtshme dhe 2 pasuri të luajtshme)	Sekuestrim: 1.17 mld lekë (58 pasuri të paluajtshme, 33 të luajtshme, 8 subjekte tregtare, rreth 5 mln €, 10 mln dollarë kriptovaluta). Konfiskim: 27.2 mln € + 510 mln lekë (17 pasuri të paluajtshme, 2 të luajtshme, 395.000 Lekë, 38.000 €, 7 subjekte tregtare)	Në vitin 2025 vërehet dominim i sekuestrimeve dhe rënie e ndjeshme e konfiskimeve krahasuar me 2024.

Pastrimi i produkteve të veprës penale	Vendimet sipas akteve ligjore (numër)	Anti-Mafia: 4/3; Kodi Penal: 12/5; OFL: 0/0; Total: 16 sekuestrime / 8 konfiskime	Anti-Mafia: 8/3; Kodi Penal: 17/11; OFL: 0/6; Total: 25 sekuestrime / 20 konfiskime	Numri i përgjithshëm i masave pasurore bie ndjeshëm në vitin 2025, veçanërisht për konfiskimet.
	Procedime për pastrim parash (neni 287)	32 procedime (↓ 31.9% krahasuar me vitin 2024; 47 raste në 2024)	47 procedime (↑ 34% krahasuar me vitin 2023; 35 raste në 2023)	Pas rritjes së konsiderueshme në vitin 2024, evidentohet rënie e konsiderueshme në vitin 2025.
	Rrezikshmëria dhe lidhja me krimin/korrupsionin	Rrezik i lartë; 18 raste të lidhura me krimin e organizuar (24.3% e totalit) 11 raste me korrupsion (6% e totalit)	Rrezik i lartë; 47 raste të lidhura me krimin e organizuar (46.5% e totalit) 8 raste me korrupsion (4.3% e totalit)	Pastrimi i parave mbetet fenomen me rrezik të lartë; në vitin 2025 vihet re ulje relative e lidhjes me krimin e organizuar dhe rritje e peshës në korrupsion.
	Asete të sekuestruara dhe konfiskuara	45.4 mln € (43.49 mln € sekuestrim; ³⁷ 1.91 mln € konfiskim)	65.5 mln € (28.7 mln € sekuestrim; 36.8 mln € konfiskim)	Vlera totale bie ndjeshëm në vitin 2025, duke reflektuar një ulje të rezultateve financiare të matshme, pavarësisht vazhdimësisë së hetimeve.

³⁷ Sipas Raportit Vjetor të SPAK për vitin 2025, në vlerën e aseteve të sekuestruara përfshihet dhe sekuestrimi i kriptovalutave të llojit TETHER, USDT, me vlerë ekuivalente prej 14.5 milionë dollarë ose rreth 12.4 milionë euro (Vendimi nr.583, datë 04.09.2025).

Vlera sipas akteve ligjore	Anti-Mafia: 14.7 mln € Kodi Procedurës Penale: 28.8 mln €	Anti-Mafia: 16.7 mln € Kodi Procedurës Penale: 44.0 mln € OFL: 3.9 mln € ³⁸	Në të dy vitet dominon Kodi i Procedurës Penale, ndërsa në vitin 2025 mungon plotësisht kontributi i OFL.
Struktura e asetëve (sekuestrim vs konfiskim)	96% sekuestrim 4% konfiskim	43.8% sekuestrim 56.2% konfiskim	Zhvendosje e konsiderueshme drejt sekuestrimit në vitin 2025 (96%), krahasuar me dominimin e konfiskimit në 2024.
Shpërndarja sipas kategorive	Krimi i organizuar: 42.4 mln € sekuestruar/1.8 mln € konfiskuar; Zyrtarë të lartë: 1.1 mln € sekuestruar/0.1 mln € konfiskuar	30 mln € (45.8%) e totalit sekuestrim/konfiskime lidhet me zyrtarë të lartë	Në vitin 2025 dominon krimi i organizuar si burim i asetëve, ndërsa në vitin 2024 evidentohet një peshë më e lartë e rasteve të lidhura me zyrtarë të nivelit të lartë.
Baza ligjore e sekuestrimëve/konfiskimeve	66% sipas Kodit të Procedurës Penale; 34% sipas Ligjit Anti-Mafia	68% sipas Kodit të Procedurës Penale; 26 % sipas Ligjit Anti-Mafia 6 % sipas OFL ³⁹	Konfirmohet roli dominues i Kodit të Procedurës Penale në të dy vitet, ndërsa në vitin 2025 reduktohet diversiteti i instrumenteve ligjore për shkak të mungesës së OFL.

³⁸ Në bazë të përlogaritjeve të vlerës së kombinuar të sekuestrimëve dhe konfiskimeve sipas akteve ligjore, evidentohet se pjesa më e madhe e asetëve në vitin 2024 lidhet me procedimet sipas Kodit Penal (rreth 44 milionë euro ose 68%), e ndjekur nga Ligji Anti-Mafia (rreth 16.7 milionë euro ose 26%), ndërsa kontributi i Aktit Normativ (OFL) mbetet i kufizuar (rreth 3.9 milionë euro ose 6%).

³⁹ Përqindjet janë llogaritur mbi bazën e të dhënave të detajuara sipas akteve ligjore, të konvertuara në një monedhë të vetme për qëllime krahasimi. Totali i përlogaritur mund të mos përputhet plotësisht me vlerën agregate të raportuar (65.5 milionë euro), për shkak të natyrës së përgjithshme të raportimit dhe ndarjes së pjesshme të të dhënave sipas kategorive.

Megjithëse sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive përbëjnë një komponent të rëndësishëm të politikës penale dhe të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe megjithëse ky mekanizëm përfaqëson një nga instrumentet më të rëndësishëm, ndikimi i tij mbetet i pabarabartë dhe jo gjithmonë proporcional me nivelin e kriminalitetit. SPAK dhe Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, kanë kontribuar në rritjen e numrit të hetimeve dhe të urdhrave për sekuestrim, duke reflektuar një intensifikim të ndërhyrjes shtetërore në këtë drejtim.⁴⁰ Megjithatë, raporti ndërmjet procedimeve të filluara dhe vendimeve përfundimtare të konfiskimit mbetet i ulët, çka evidenton vështirësi të vazhdueshme në sigurimin e provave, kohëzgjatjen e proceseve dhe kufizimet në kapacitetet institucionale.

Një rol qendror në këtë sistem luan Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), e cila është përgjegjëse për administrimin e pasurive gjatë fazës së ndërmjetme deri në vendimmarrjen përfundimtare. Edhe pse kjo agjenci ka zhvilluar kapacitete bazë administrative, ajo vijon të përballet me sfiga të lidhura me burimet njerëzore, ekspertizën teknike dhe koordinimin ndërinstitutional. Në praktikë, vonesat procedurale shpesh sjellin zhvlerësim të pasurive të sekuestruara, duke dobësuar vetë logjikën ekonomike të konfiskimit si instrument për rikuperimin e përfitimeve të paligjshme.

Në aspektin e transparencës, Shqipëria disponon një bazë të dhënash të brendshme për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara, si dhe publikon raporte vjetore. Megjithatë, transparenca mbetet kryesisht formale, pasi të dhënat shpesh nuk janë të plota. Një zhvillim pozitiv në këtë drejtim u shënuar në vitin 2025 me publikimin për herë të parë të një katalogu të detajuar të pasurive të konfiskuara nga AAPSK, i cili përfshin informacion mbi vendimin gjyqësor, llojin, vendndodhjen dhe statusin e secilës pasuri.⁴¹ Gjithashtu, është finalizuar një inventar i plotë dhe publikuar katalogë të përditësuar, si pjesë e një procesi më të gjerë dixhitalizimi dhe krijimi të një regjistri të përditësuar të pasurive, i cili synon të rrisë transparencën dhe mundësinë e monitorimit nga shoqëria civile dhe media.⁴²

Në mungesë të një strategjie gjithëpërfshirëse për përdorimin e pasurive të konfiskuara, vendimmarrja mbi destinacionin e tyre mbetet e fragmentuar dhe jo plotësisht transparente. Aktualisht nuk ekziston një qasje e strukturuar që të lidhë konfiskimin me objektiva më të gjera, si kompensimi i viktimave, investimet sociale apo mbështetja e politikave antikorrupsion.


Perceptimi publik mbetet i ndërmjetëm. Megjithëse është vërejtur një rritje e besimit ndaj këtij mekanizmi, ai ende perceptohet si i kufizuar në efektivitet, për shkak të bashkëpunimit të pamjaftueshëm ndërinstitutional dhe perceptimeve për ndikim politik në raste të caktuara me profil të lartë. Në këtë kuptim, forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve hetimore, përmirësimi i koordinimit ndërinstitutional dhe rritja e transparencës mbeten elemente kyçe për të rritur efektivitetin e këtij instrumenti në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

⁴⁰ Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), *Raporti Vjetor 2025* (Tiranë: SPAK, 2026), https://spak.gov.al/wp-content/uploads/2026/03/Raporti-vjetor-2025_SPAK.pdf

⁴¹ Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), *Katalogu i Pasurive të Sekuestruara* (Tiranë: AAPSK, 2025), <https://aapsk.gov.al/wp-content/uploads/2025/03/KATALOGU-I-PASURIVE-TE-SEKUESTRUARA.pdf>

⁴² Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), *Pasuri të Paluajtshme: Prona të Konfiskuara* (Tiranë: AAPSK, 2025), <https://aapsk.gov.al/wp-content/uploads/2025/02/AAPSK-Pronat-e-Konfiskuara.pdf>

Grafik 13: Vlera e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara në EURO (2019-2025)



Burimi: Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK)

Anekse

Aneks I: Vendimet e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (2025)

- Vendim Nr. 1, datë 08.01.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Vendim Nr. 2, datë 09.01.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Vendim Nr. 3, datë 09.01.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Vendim Nr. 4, datë 10.01.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Vendim Nr. 5, datë 13.01.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Vendim Nr. 6, datë 15.01.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Vendim Nr. 7, datë 25.01.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Vendim Nr. 8, datë 24.01.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Vendim Nr. 9, datë 28.01.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Vendim Nr. 10, datë 31.01.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Vendim Nr. 11, datë 03.02.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Vendim Nr. 12, datë 06.02.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Vendim Nr. 13, datë 06.02.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Vendim Nr. 14, datë 10.02.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Vendim Nr. 15, datë 14.02.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

- **Vendim Nr. 16, datë 25.02.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 17, datë 26.02.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 18, datë 27.02.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 19, datë 04.03.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 20, datë 06.03.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 21, datë 10.03.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 22, datë 11.03.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 23, datë 11.03.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 24, datë 12.03.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 25, datë 13.03.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 26, datë 17.03.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 28, datë 10.04.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 29, datë 15.04.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 30, datë 16.04.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 31, datë 22.04.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 32, datë 25.04.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 33, datë 28.04.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 34, datë 05.05.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**

- **Vendim Nr. 35, datë 09.05.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 36, datë 20.05.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 37, datë 22.05.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 38, datë 28.05.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 39, datë 29.05.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 40, datë 11.06.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 41, datë 17.06.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 42, datë 17.06.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 43, datë 19.06.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 44, datë 23.06.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 45, datë 23.06.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 46, datë 24.06.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 47, datë 01.07.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 48, datë 07.07.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 49, datë 11.07.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 50, datë 14.07.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 52, datë 23.07.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 53, datë 30.07.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**

- **Vendim Nr. 54, datë 30.07.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 55, datë 30.07.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 56, datë 18.09.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 57, datë 19.09.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 58, datë 23.09.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 59, datë 24.09.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 60, datë 29.09.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 61, datë 30.09.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 62, datë 03.10.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 63, datë 08.10.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 64, datë 17.10.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 65, datë 17.10.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 67, datë 28.10.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 68, datë 03.11.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 69, datë 04.11.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 70, datë 11.11.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 72, datë 13.11.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**
- **Vendim Nr. 74, datë 21.11.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;**

- **Vendim Nr. 75, datë 21.11.2025** i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- **Vendim Nr. 77, datë 26.11.2025** i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- **Vendim Nr. 78, datë 27.11.2025** i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- **Vendim Nr. 80, datë 11.12.2025** i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- **Vendim Nr. 81, datë 17.12.2025** i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

Aneks II: Niveli i Përgatitjes dhe Progresit për zbatimin e Grup Kapitullit të Parë “Themeloret” - Cluster 1 (2020-2025)

Fillestar 0	Fillestar/Disi 1	Disi 2	Disi/Moderuar 3	Moderuar 4	Moderuar/mirë 5	Mirë 6
----------------	---------------------	-----------	--------------------	---------------	--------------------	-----------

Kapitujt & fushat		2020	2021	2022	2023	2024	2025
Administrata publike	Niveli i përgatitjes	4	4	4	4	4	4
	Niveli i progresit	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Progres i kufizuar	Progres i kufizuar	Progres i kufizuar	Njëfarë progresi
Prania e një ekonomie tregu funksionale	Niveli i përgatitjes	4	4	4	5	6	4
	Niveli i progresit	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Progres i mirë	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi
Aftësia për të përballuar presionin konkurrues & forcat e tregut brenda BE	Niveli i përgatitjes	2	2	2	2	2	4
	Niveli i progresit	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi
Lufta kundër korrupsionit	Niveli i përgatitjes	2	2	2	2	3	4
	Niveli i progresit	Progres i mirë	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Progres i mirë

Lufta kundër krimit të organizuar	Niveli i përgatitjes	2	2	2	2	3	4
	Niveli i progresit	Progres i mirë	Progres i mirë	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Progres i mirë
Gjyqësori dhe të drejtat themelore	Niveli i përgatitjes	3	3	3	3	4	6
	Niveli i progresit	Progres i mirë	Progres i mirë	Progres i mirë	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi
Drejtësia, liria dhe siguria	Niveli i përgatitjes	3	3	3	3	4	2
	Niveli i progresit	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Progres i kufizuar
Prokurimi publik	Niveli i përgatitjes	4	4	4	4	4	4
	Niveli i progresit	Njëfarë progresi	Progres i mirë	Progres i mirë	Njëfarë progresi	Progres i kufizuar	Progres i kufizuar
Kontrolli financiar	Niveli i përgatitjes	4	4	4	4	4	4
	Niveli i progresit	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Progres i kufizuar	Njëfarë progresi
Statistikat	Niveli i përgatitjes	4	4	4	4	4	4
	Niveli i progresit	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Progres i kufizuar	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Progres i kufizuar

Burimi i të dhënave: Raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë (2020-2025)